

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Evropiane dhe të Sigurisë – 35

ÇËSHTJE EVROPIANE DHE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë tremujore për sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Nr. 35, nëntor 2017

Bordi Shkencor:

PhD. Elona Dhëmbo (kryetare)

MA. Arjan Dyrmishi (anëtar)

PhD. Dalina Jashari (anëtare)

PhD. Cand. Armela Xhaho (anëtare)

Redaktoi:

Besjana Kuçi

Ndihmoi në përgatitje:

Romario Shehu

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të

Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
-------------------------	----------

NDIKIMI I KRIZËS SË EMIGRANTËVE DHE REFUGJATËVE TË VITIT 2015 NË POPULLSITË VENDASE TË BALLKANIT PERËNDIMOR	8
--	----------

ANDRÉS GARCÍA GÓMEZ

NË PORTËN E EVROPËS: RAPORT MBI REFUGJATËT NË RRUGËN E BALLKANIT PERËNDIMOR.....	21
---	-----------

SENADA ŠELO ŠABIĆ DHE SONJA BORIC

NATO DHE BALLKANI: SFIDAT E ARDHSHE TË SIGURISË	69
--	-----------

PREZANTIMET E FORUMIT TË POLITIKAVE ORGANIZUAR NGA INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE
NDËRMJETËSIM (IDM) DHE FRIEDRICH EBERT STIFTUNG ALBANIA, 4 KORRIK 2017

LIDHJA MIDIS TERRORIZMIT DHE EMIGRACIONIT	105
--	------------

ALEX P. SCHMID

ENGLISH ABSTRACTS	202
--------------------------------	------------

PARATHËNIE

Revista për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë është një botim që synon të kontribuojë në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave, mbi reformat dhe performancën e sektorit të sigurisë, prirjet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet e debatueshme dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Nëpërmjet studimeve dhe kontributit të ekspertëve dhe studiuesve të ndryshëm lidhur me sektorin e sigurisë në tërësi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), sjell në vëmendje në numrin e ri të kësaj reviste, hulumtime dhe analiza të kryera së fundmi që fokusohen në këto tematika kryesore si:

- Ndikimi i Krizës së Emigrantëve dhe Refugjatëve të Vitit 2015 në Popullsitë Vendase të Ballkanit Perëndimor
- Lidhja midis terrorizmit dhe emigracionit
- Kriza e emigrantëve dhe roli i Bashkimit Evropian
- NATO dhe Ballkani: Sfidat e Ardhshme të Sigurisë

NDIKIMI I KRIZËS SË EMIGRANTËVE DHE REFUGJATËVE TË VITIT 2015 NË POPULLSITË VENDASE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Andrés García Gómez

Abstrakt

Një numër në rritje refugjatësh nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës sub-sahariane kanë si synim mbërritjen në shtetet e Bashkimit Evropian, të shtyrë nga frika e luftës në shtetet përkatëse dhe nga shpresa për mundësi të reja. Ky udhëtim nga vendet e Lindjes drejt atyre të Perëndimit bëhet zakonisht nëpërmjet rajonit të Ballkanit, i cili që prej vitit 2015 furnizon Evropën me një numër në rritje emigrantësh, refugjatësh dhe azilantësh të cilët kalojnë tranzit nga e ashtuquajtura “rruga Ballkanike”. Pavarësisht se qëllimi i tyre parësor nuk është të qëndrojnë në shtete tranzite, disa prej tyre kanë aplikuar për azil në këto shtete.

Në disa raste, haset një lloj mospranimi ndaj të huajve, çka ka krijuar raste sporadike ksenofobie dhe ekstremizmi kundrejt të huajve. Kjo ndodh edhe në Ballkanin Perëndimor, ku popullsia lokale është mësuar të arsyetojë në mënyrë etnike; që nënkupton identifikimin e vetes me karakteristikat e një grupi etnik dhe kundërshtimin e ndikimeve të jashtme. Qëllimi i këtij artikulli është të shqyrtojë lidhjen mes emigrimit dhe radikalizmit të njerëzve vendas në Evropë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Hyrje

Historia e Evropës Juglindore është komplekse dhe e pasur, ku vetëm disa territore mund të mbështeten në përkatësinë socio-kulturore që rezulton nga zhvillime të tilla historike. Ky sfond historik shpjegon gjithashtu se si disa arsyeime sociologjike janë thellësisht të rrënjosura në shoqëri. Ky artikull nuk kthehet mbrapa në histori; megjithatë e sheh

të nevojshme të analizohet një e kaluar jo shumë e largët në mënyrë që të shohim se si zhvillimet kanë kushtëzuar vendet moderne të Evropës Juglindore.

Gadishulli i Ballkanit ishte pjesë e Perandorisë Osmane që nga shekulli i 15-të deri në shekullin e 19-të kur gjendja e sulltanatit në Kostandinopojë filloi të përkeqësohet, dhe në fund të atij shekulli disa vende si Greqia apo Serbia fituan pavarësinë. Të tjerët duhej të prisnin deri në Luftën e Parë Botërore e cila solli dhe tkurrjen e Turqisë nga Evropa Juglindore. Nga hiri i konfliktit lindën vende të reja, por vitet pasuese ishin sërish shumë të vështira në aspektin politik për këto vende: trazirat socio-politike, konfliktet e armatosura dhe varfëria ekonomike. Një skenar i dobët që bëhet edhe më i dobët me Luftën e Dytë Botërore dhe pushtimin e Gadishullit Ballkanik nga fuqitë e Boshtit. Në këtë kuadër, ekuilibri i konfliktit i besohet formacioneve partiake të ideologjisë komuniste në vend të qeverive vendase marioneta, të cilat ishin shumë të diskredituara, të paafta për të qeverisur dhe jo të gatshme për të ndryshuar situatën¹.

Pas konfliktit Evropa u nda në dy pjesë antagoniste, pjesa perëndimore nën udhëheqjen e SHBA-së, dhe pjesa lindore e cila ndodhej nën sundimin e Moskës, me përjashtim të Jugosllavisë që e eksploron në mënyrë të veçantë rrugën drejt socializmit. Megjithatë, ndikimi i këtyre sistemeve të reja socio-politike pati efekte të rëndësishme për popullatën vendase². Nga ana politike, ndryshimet e luftës nuk sollën qeveri të reja demokratike, por qeveri autoritare; në aspektin ekonomik, rajoni sërish vuajti nga kushtet e këqija të trashëguara nga e kaluara, por udhëheqësit e rinj politikë nxitën despotizëm dhe ekonomi të dominuar nga shteti në vend të lirive në ekonomi dhe promovimin e kulturës sipërmarrëse. Kombinimi i këtyre dy faktorëve pati ndikim edhe në shoqëri, disa arritje u bënë sidomos në sferën e arsimit; megjithatë popullsia u kap nga një ideologji unike në të cilën çdo aspekt i jetës private u vendos nga autoritetet shtetërore, duke mos lënë hapësirë për iniciativa private apo ide alternative. Ajo mund të përkufizohej si një lloj anestezie sociale e

¹ G. Tassinari, *Nascita e dissoluzione della Jugoslavia*. Alpha Test. Milan, 2003.

² Stefano Bianchini, *La questione Jugoslava*. Giunti. Florence, 2003.

cila shmangte çdo përpjekje të organizimit privat dhe formësoi shoqërinë sipas ideve politike të udhëheqësve.

Me rënien e komunizmit gjatë dekadës së fundit të shekullit të njëzetë, filloi prurja e modeleve të reja socio-politike dhe ekonomike në shumicën e vendeve të Evropës Lindore. Fatkeqësisht gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë në shtete të ndryshme të cilat më parë i përkisnin Federatës, situata ishte dramatike, pati një rritje të nacionalizmit dhe gjendja degradoi në luftë. Edhe rasti i Shqipërisë nuk ishte i lehtë, vendi u zhvendos nga regjimi më i ashpër komunist në Evropë në një demokraci çka u karakterizua për një periudhë të gjatë kohore nga kryengritjet, emigracioni masiv dhe praktikat e këqija ekonomike.

Sot, Ballkani i ka tejkaluar konfliktet e armatosura të cilat e kanë penguar atë të arrijë potencialin e tij të vërtetë. Ballkani aktualisht ndodhet në rrugën e paqes, demokratizimit dhe stabilitetit, si dhe në rrugën për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian; disa vende janë bërë pjesë e BE ndërsa disa të tjera po punojnë në këtë aspekt. Megjithatë, është e rëndësishme t'i referohemi zhvillimeve të fundit historike për të kuptuar se si mungesa tradicionale e lirisë dhe ndarja etnike komplekse kanë pasur një ndikim të fortë në shoqëri, duke futur një skemë të thjeshtë të dyfishtë të arsytimit: e mirë apo e keqe, e rritur me dekada të nacionalizmit të përkeqësuar, për të refuzuar disa elementë të huaj dhe për të theksuar karakteristikat e veta.

Kriza e emigrantëve dhe refugjatëve gjatë vitit 2015

Që nga ngjarjet e të ashtuquajturës “Pranvera Arabe” dhe shpërthimit të luftës civile në Siri, numri i refugjatëve, azilkërkuesve dhe emigrantëve që kalojnë nëpër vendet e Evropës Juglindore është rritur në mënyrë dramatike. Emigrantët e tjerë vijnë nga vendet subsahariane, nga vendet e Bririt të Afrikës, madje edhe nga vendet aziatike si: Afganistani, Pakistani ose Bangladeshi. Megjithatë, të gjithë kanë të njëjtin synim për të arritur në vendet e zhvilluara të Evropës Veriore dhe Perëndimore, pra në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Sipas të dhënave³ të ONE (Organizatës Ndërkombëtare të Emigracionit), gjatë kulmit të krizës në tetor të vitit 2015 mbërritjet e regjistruara në Greqi ishin 399.236, ndërsa në vendet e Ballkanit - ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia dhe Kroacia, ishin përkatësisht 102.753, 173.891 dhe 110.641. Vendet e origjinës të emigrantëve ishin kryesisht Siria, Afganistani dhe Iraku.

Si rezultat i kësaj krize, qeveritë lokale, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile kanë zhvilluar dhe zbatuar një larmi të madhe të planeve që synojnë të dëshmojnë mbështetje dhe ndihmë për emigrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit. Organizatat ndërkombëtare si ONE ose UNHCR mbështetën qeveritë e vendeve pritëse për t'u përgatitur për muajt e ardhshëm të dimrit, duke siguruar strehim të përkohshëm dhe pika regjistrimi në kufijtë dhe qytetet kryesore.

Pavarësisht se qëllimi kryesor i emigrantëve është të arrijnë në vendet e Bashkimit Evropian, i cili është destinacioni i tyre final, ata përdorin të ashtuquajturën “Rruga e Ballkanit Perëndimor” përmes Maqedonisë dhe Serbisë, ku ata kryesisht përballen me rrezikun e dhunës, abuzimit dhe aksidenteve gjatë kalimit të kufijve në mënyrë të paligjshme⁴. Prandaj, është e qartë se qëllimi i tyre është të lëvizin drejt BE-së përgjatë rrugës ballkanike, por koha që ata qëndrojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor varet kryesisht nga burimet e tyre financiare, të cilat në shumicën e rasteve nënkuptojnë të ardhurat e marra nga të afërmit dhe miqtë në vendet e tyre, çka u mundëson atyre të vazhdojnë udhëtimin deri në destinacionin e tyre final. Prandaj, planet e ofruara nga autoritetet vendase janë jashtëzakonisht të dobishme për të ofruar ndihmë, dhe për më tepër disa emigrantë vendosën të aplikojnë për azil në Serbi dhe Maqedoni, edhe pse numri i aplikimeve të pranura është shumë i ulët.

Gjatë fundit të verës së vitit 2015 Ministri i Jashtëm i Hungarisë Péter Szijjártó deklaroi se qëllimi i qeverisë ishte të ndërtonte një mur midis territorit hungarez dhe atij serb në mënyrë që të reduktonte hyrjet e

³ ONM – Përgjigja e Evropës dhe Mesdheut për Emigrimin. Raporti i gjendjes, tetor 2015. https://www.iom.int/sites/default/files/situation_reports/file/Europe-Mediterranean-Migration-Crisis-Response-Situation-Report-05-October-2015.pdf

⁴ Aldin Zenovic, *Asylum seekers from Asia and Africa on their way to Western Europe: Position of Serbia and other countries in the region as transit stations*. International Journal of rule of law, transitional justice and human rights. Vëllimi 6.

emigrantëve dhe refugjatëve në Hungari. Ky vendim shkaktoi një tronditje midis vendeve fqinje; për më tepër, vendosja e këtij gardhi u refuzua nga Bashkimi Evropian si mosrespektim i të drejtave të njeriut. Rezultati i kësaj pengese të re në të ashtuquajturën “rruga e Ballkanit Perëndimor” ishte bllokada e daljes në veri që i detyron emigrantët të lëvizin drejt Kroacisë dhe Sllovenisë në rrugën e tyre drejt BE-së. Megjithatë, rezultati kryesor ishte mbajtja e emigrantëve në vendet e tranzitit, të cilat megjithë përpjekjet e autoriteteve kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare nuk ishin të përgatitura për të pranuar dhe mbrojtur kaq shumë njerëz. Në Serbi janë vetëm pesë qendra pritëse që merren me azilkërkesit dhe refugjatët me një kapacitet total prej 770 personash⁵, në Maqedoni kushtet janë edhe më të dobëta. Për këtë arsye, shumë strehime dhe kampe të përkohshme u krijuan në qytetet kryesore, afër stacioneve hekurudhore dhe në zonat kufitare ku vëmendja e ofruar nga OJQ-të dhe banorët lokalë në të shumtën e rasteve ishte e lavdërueshme përkundër kushteve të këtyre vendeve.

Ana tjetër e vendimit hungarez dhe mbajtja për rrjedhojë e emigrantëve dhe refugjatëve në vendet e tranzitit është rritja e rasteve të brutalitetit policor ndaj këtyre refugjatëve. Në momentin që ata kapeshin duke kaluar kufirin ilegalisht, ata dëboheshin drejt vendeve prej nga hynin⁶. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, refugjatët që nuk u dëbuan u mbajtën për kohë të gjatë në qendrat e pritjes si Gazi Baba në Shkup me qasje të kufizuar në objektet dhe furnizimet sanitare. Gjithashtu në këtë vend janë raportuar shumë raste kur policia ka përdorur dhunë brenda strehimeve të tyre⁷.

Paralelisht me kushtet e emigrantëve dhe refugjatëve, prania e këtyre njerëzve në vendet e tranzitit mbolli një lloj ksenofobie tek popullata e përgjithshme por edhe tek autoritetet vendase. Ndoshta rasti më i

⁵ Republic of Serbia, Commissariat for Refugees and Migration, Asylum centres. <https://www.kirs.gov.rs/articles/presentasyl.php?lang=ENG>

⁶ Human Rights Watch, Serbia: Police abusing migrants and refugees. <https://www.hrw.org/news/2015/04/15/serbia-police-abusing-migrants-asylum-seekers>.

⁷ Europe’s borderlands: Violations against refugees and migrants in Macedonia, Serbia and Hungary. http://www.amnestyusa.org/sites/default/files/ser-mac_migration_report_final.compressed.pdf

theksuar është ai grek, ku kriza ekonomike i bëri gjërat edhe më keq për emigrantët që vinin nga Turqia, por edhe në arenën socio-politike vendi regjistroi rritje në sulmet ndaj emigrantëve dhe intolerancën e shprehur ndaj tyre nga një pjesë e popullsisë vendase⁸.

Lidhjet midis emigrimit dhe radikalizmit me shembuj

Siç u theksua më lart, kriza e emigrantëve dhe numri në rritje i mbërritjeve të tyre në Evropë ka pasur ndikim në vendet e ndryshme të Kontinentit të Vjetër të cilat ndikuan në çdo aspekt të jetës së përditshme.

Reagimi politik ndaj krizës së emigrantëve ka ndryshuar nga një vend në tjetrin, është e rëndësishme të theksohet vendimi i guximshëm i Kancelares Merkel për t'i pranuar emigrantët si një detyrë humanitare në kundërshtim me masat kufizuese të miratuara nga vendet e tjera. Por përsëri kriza ka pasur një kosto të lartë politike me rritjen e partive politike ekstremiste, pamundësinë e shteteve anëtare të BE-së për të arritur një marrëveshje për përditësimin e Rregullores së Dublinit, si dhe miratimin nga shumë qeveri evropiane të politikave kufizuese mbi emigracionin dhe azilin.

Partitë e reja ekstremiste janë shfaqur në të gjithë Evropën si lëvizje të tërthorta e të afta për të kanalizuar urrejtjet dhe frustrimet e evropianëve dhe t'i transformojnë ato në mënyrë shumë të thjeshtë në armë kundër Bashkimit Evropian dhe politikave të tij, duke përfshirë menaxhimin e krizës së emigrantëve. Rritja e këtyre lëvizjeve është një faktor i përbashkët i të gjitha zgjedhjeve evropiane në pesë vitet e fundit, edhe nëse ato nuk kanë qenë në gjendje të mposhtin partitë tradicionale ato kanë qenë të afta të sigurojnë disa vende në parlament. Nuk është e thjeshtë të tregosh dallimin midis partive të orientuara nga e majta dhe atyre të orientuara nga e djathta, pasi, edhe nëse objektivi i kritikëve të tyre është i ndryshëm, ato ndajnë disa rrënjë populiste dhe fajësojnë globalizimin e situatës aktuale.

⁸ ABC. *La sombra de la xenofobia se alarga ante la crisis migratoria*. Madrid 10/08/2015:
<http://www.abc.es/internacional/20150810/abci-xenofobia-crisis-migratoria-201508081937.html>

Në Evropë, grupet e djathta populiste akuzojnë emigrantët dhe refugjatët për çdo problem të shoqërisë. Kërkesat e populistëve për të penguar emigrantët dhe në veçanti refuzimi i tyre ndaj myslimanëve që vijnë në Evropë, rezonojnë me një pjesë gjithnjë e në rritje të popullsisë. Në një klimë gjithnjë e më të rrezikshme, gjuha e urrejtjes dhe sulmet kundër emigrantëve janë në rritje⁹. Stefan Lehne, analist i Carnegie Centre, fokusohet në ndikimin e krizës së emigrantëve në Evropë dhe krahason qëndrimet dhe politikat evropiane me përvojën në Shtetet e Bashkuara, të cilat pavarësisht politikave të Trump, kanë një histori të gjatë dhe të suksesshme në menaxhimin e emigracionit. Ndërkohë që në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një komb i bazuar në emigrim, politikat aktuale të miratuara nga Presidenti Trump kundër emigrantëve kanë gjasa të jenë një lajthitje e përkohshme, në rastin e Evropës, ksenofobia dhe islamofobia paraqesin rreziqe edhe më të mëdha. Ato mund të destabilizojnë shoqëritë që tashmë kanë komunitete të mëdha të paintegruara mjaftueshëm. Ato mund të pengojnë përpjekjet për të stabilizuar lagjen problematike të Evropës, dhe mund të rrezikojnë edhe vetë mbijetesën e Bashkimit Evropian¹⁰.

Prandaj, qeveritë duhet të jenë të gatshme për të ndryshuar situatën, megjithatë, kjo kërkon investim, durim, partneritet dhe shqetësim humanitar. Gjeografia e Evropës e bën kontrollimin e refugjatëve më të vështirë se në vendet e tjera, zona Shengen për lëvizjen e lirë është *per se* një arritje e madhe e Bashkimit Evropian, por sërish përbën problem në kuadër të kontrollit. Brenda kësaj zone ka lidhje të ngushta ekonomike, pabarazi të mëdha demografike dhe të ardhurash në krahasim me rajonet fqinje; megjithatë, zona e Shengenit ka një kufi të jashtëm toke prej gati 8000 kilometrash, si dhe një kufi të madh detar. Çështjet e karakteristikave gjeografike dhe politike sipas të cilave BE ka krijuar një hapësirë të lëvizjes së lirë, por ka lënë fuqitë dhe burimet në lidhje me emigracionin dhe kontrollin në kompetencë të shteteve anëtare individuale, ka bërë që kontrolli i kufijve të ngelet një çështje e

⁹ Stefan Lehne, *Will Europe follow Trump on migration?* Carnegie Europe.
<http://carnegieeurope.eu/2017/03/07/will-europe-follow-trump-on-migration-pub-68197>

¹⁰ Po aty.

komplikuar pavarësisht përpjekjeve të shteteve individuale dhe institucioneve komunitare.

Nga ana sociale, emigrimi ka pasur një ndikim të rëndësishëm në opinionin publik. Kur bëhet fjalë për emigrimin, popullsia ka qenë prej kohësh e ndarë dhe ka një polarizim të opinionit. Në Evropë studimet kanë zbuluar dallimet midis qëndrimeve ndaj emigracionit midis vendeve të BE-së dhe pikëpamjeve mbi emigracionin nga jashtë BE-së. Emigrimi brenda BE-së shihet si një gjë pozitive nga 61% dhe negative nga 33%. Nga ana tjetër, emigrimi nga jashtë BE-së, perceptohet në mënyrë negative nga 56% e të anketuarve dhe pozitivisht vetëm nga 37%. Kriza e emigrantëve gjatë periudhës 2015-2016 përfshin grupin e emigrimit nga jashtë BE-së dhe ata emigrantë dhe refugjatë që vijnë nga vendet aziatike dhe afrikane ku Islami është feja mbizotëruese. Kështu hyn në lojë edhe faktori fetar. Sipas një sondazhi të Chatham House të kryer në dhjetë vende të BE-së rreth ndikimit të emigracionit musliman, 55% e të anketuarve prireshin të pranonin se të gjitha këto emigrime duhet të ndaleshin, 20% nuk ishin dakord dhe 25% as nuk ranë dakord dhe as nuk kundërshtuan¹¹.

Nëse të dhënat dhe pikëpamjet në Bashkimin Evropian janë mikluere, situata në Ballkanin Perëndimor është edhe më kritike; kjo për shkak të mungesës së institucioneve solide nga njëra anë dhe për arsye historike dhe sociale nga ana tjetër. Flukset masive të emigracionit ndikuan në vendet e Ballkanit gjatë vitit 2015. Vendet e rajonit nuk ishin të gatshme dhe të përgatitura për të menaxhuar një krizë të tillë. Kufijtë rajonalë në Ballkan kanë qenë tradicionalisht porozë dhe në shumicën e rasteve kufijtë janë në zona të largëta dhe malore larg kontrollit të qeverisë, dhe kjo situatë është shfrytëzuar nga grupe me qëllime jo gjithmonë të ligjshme si: kontrabanda, trafikimi i qenieve njerëzore, armëve, drogës, etj. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk janë një vatër për këto aktivitete, por sigurisht ngelen një pikë e nxehtë në Evropë.

Me zhvillimet e vitit 2015, vendet u tejmbushën nga mijëra refugjatë, emigrantë dhe azilkërkues të cilët kalonin përgjatë rrugës në Ballkan ku

¹¹ Chatham House. The Royal Institute of International Affairs. *What do Europeans think about Muslim immigration?*

<https://www.chathamhouse.org/expert/comment/what-do-europeans-think-about-muslim-immigration>

u kushtohej fare pak vëmendje nga autoritetet vendase. Kjo hapësirë u shfrytëzua gjithashtu nga mafia lokale e vendosur mirë në rajon, e cila përfitoi nga emigrantët e dëshpëruar. Në një periudhë shumë të shkurtër kohe u organizua një rrjet efektiv për të transportuar emigrantë nga Greqia drejt vendeve të tjera të BE-së, si Austria dhe Hungaria krejtësisht jashtë ligjit dhe pa garanci mbrojtjeje të përcaktuara nga rregullat ndërkombëtare¹².

Veprimi i qeverisë ishte i kufizuar, pjesërisht për shkak se vendet e Evropës Juglindore kanë aftësi dhe burime të kufizuara, me siguri inferiore për shkak të madhësisë së kësaj krize humanitare. Komuniteti ndërkombëtar mbështeti vendet e Ballkanit, kryesisht Maqedoninë dhe Serbinë, duke ofruar strehime të përkohshme dhe pika regjistrimi, si dhe duke lehtësuar planet e tjera të paparashikuara. Qeveritë lokale janë të përqendruara tek anëtarësimi në Bashkimin Evropian, për këtë arsye ato përqendrojnë burimet në nevojat kyçe për të përmbushur këtë objektiv si: miratimin e legjislacionit (*acquis communautaire*), i cili kërkon investime në sektorë strategjikë si: drejtësia, arsimi, bujqësia, shëndetësia, transporti, energjia etj.; po ashtu pagesa e borxhit publik ose kostoja e strukturave politike në disa raste jashtëzakonisht të shtrenjta dhe joefikase (si në Bosnjë Hercegovinë). Kështu, ndikimi i krizës së emigrantëve kishte një kosto të madhe për autoritetet kombëtare në aspektin administrativ dhe ekonomik, por edhe në atë shoqëror.

Rezultati i parë dhe më i rëndësishëm i krizës ishte kontakti i popullatës lokale me të huajt; refugjatët, emigrantët dhe azilkërkuesit nga Siria, Iraku, Afganistani, Eritrea, etj. Kjo supozohet në shumicën e rasteve si problematike, ku ke të bësh me njerëz të huaj, të cilët kanë gjuhë, fe apo ngjyrë të ndryshme; dhe për këtë studimet psikologjike kanë treguar se mosbesimi ndaj të huajve është thellësisht i rrënjësuar në vetëdijen njerëzore.

Prandaj, mbrojtja e identitetit, territorit dhe interesave të një klani apo fisi, duke i mbajtur të huajt jashtë, ka kuptim në terma evolucionarë dhe ka qenë gjithmonë prioritet në të gjitha shoqëritë. Megjithatë, historia

¹² El Mundo. *Así operan las mafias del tráfico de refugiados*, Madrid 28/08/2015
<http://www.elmundo.es/internacional/2015/08/28/55df319d268e3e261e8b458b.html>

ndryshon dhe shoqëritë evoluojnë përballë sfidave të reja dhe prandaj miratojnë zgjidhje dhe përdorin burime të reja sipas kuadrit historik. Historia shpesh përsëritet dhe është e rëndësishme për ta analizuar atë në një mënyrë të kujdesshme pasi ajo jep disa çelësa për të parashikuar reagimet e ardhshme.

Përshkrimi i një kombi është një çështje e ndërlikuar në të cilën është e nevojshme të merren parasysh elementë të ndryshëm si toka, historia, gjuha, feja, kuzhina, veshja dhe sidomos vetëdija kolektive e përkatësisë në të njëjtin grup¹³. Kjo vetëdije e ndjenjës merret me konventat e brendshme dhe private sesa elemente të jetës së përditshme; megjithatë disa nga këto elemente të një natyre kulturore që shërbejnë për t'i dalluar popujt janë veçanërisht feja dhe gjuha. Prandaj, është një çështje delikate me kufizime ndonjëherë të paqarta, por të ashtuquajturat teori sociale primordialiste, të frymëzuara nga studimet e Edward Schils, bien dakord kur theksojnë rëndësinë e elementeve “primordiale” atje¹⁴.

Në Evropën Juglindore, si në pjesët e tjera të botës, feja, gjuha dhe përkatësia etnike kanë qenë elementët thelbësorë për të ndërtuar historinë e tyre si komb. Për më tepër, ajo daton në kohën e Perandorisë Osmane, zakoni i arsyetimit në lidhje me përkatësinë e komuniteteve fetare, me emrin *millet* në kohën e Sulltanatit.

Ekzistenca e një *dhimmi* brenda shtetit mysliman, një statut që mbronte komunitetet jomyslimane në këmbim të pagimit të taksave dhe pranimit të autoritetit të sulltanit, u ofroi komuniteteve ortodokse lokale në Gadishullin Ballkanik një liri të vërtetë fetare që nuk ekzistonte në atë kohë në monarkitë e tjera të rajonit si Perandoria Austro-Hungareze. Kjo tolerancë osmane ka ruajtur kulturat lokale, siç ka lejuar periudha të zhvillimit dhe shkëlqimit të madh.

Megjithatë, ajo gjithashtu ka mësuar komunitetet lokale që të arsyetojnë në mënyrë fetare për të përcaktuar armiq të dhe aleatë¹⁵. Ky sfond historik vjen deri në ditët tona, i formuar nga periudha e konfliktit, nacionalizmit dhe komunizmit, duke zvogëluar ose rritur këtë arsyetim të dyfishtë sipas nevojës. Ky lloj arsyetimi përshtatet në mënyrë të

¹³ B. Azkin. *State and nation*. Hutchinson. London, 1964

¹⁴ Anthony D. Smith, *The ethnic origins of nations*.

¹⁵ Miguel Ángel Rodríguez Andreu. *Anatomía serbia*.

përkryer me idenë e mbrojtjes së identitetit të vet dhe elementeve të huaja të grupit dhe përputhet me vizionin e grupeve kombëtare të njëri-tjetrit në Ballkan. Për shembull, sipas kësaj pikëpamje, armiqtë e serbëve janë kryesisht komunitetet myslimane fqinje, si: shqiptarët, kosovarët dhe boshnjakët, por edhe kroatët katolikë¹⁶.

Megjithëse ky lloj arsyetimi është plotësisht i ankoruar në thelbin e vetëdijes njerëzore, gjatë rrjedhës së historisë, shoqëritë u bënë më komplekse dhe më të hapura, si pasojë, ky refuzim i të huajve u tërhoq gradualisht. Ndërsa në shumicën e kombeve evropiane dhe sigurisht në Shtetet e Bashkuara, shoqëritë u zhvilluan duke qenë në kontakt me emigrantët e tjerë që lëvizën nga një vend në tjetrin duke sjellë gjithashtu kulturën e tyre, në Ballkanin Perëndimor ky fenomen akoma nuk është shumë i rëndësishëm. Kontakti me njerëz të tjerë ka krijuar multikulturalizmin; megjithatë progresi drejt tolerancës më të madhe të emigrantëve dhe kulturës së ndryshme është ndërprerë shpesh nga raste të ksenofobisë dhe dhunës. Në Ballkanin Perëndimor prania e komuniteteve të huaja të tërhequra nga mundësitë më të mira socio-ekonomike është pothuajse e pavlefshme, por duhet të përmendim praninë historike të komuniteteve të ndryshme në zonën që gjatë shekujve të fundit kanë jetuar në të njëjtin territor, ndonjëherë të detyruar të jetojnë së bashku nën domenin e një komuniteti të caktuar që lejoi prezencën e tjetrit dhe garantoj disa të drejta. Konflikti i armatosur dhe nacionalizmi i dekadës së fundit të shekullit të 20-të e prishën përfundimisht situatën e të shkuarës dhe thelluan ndarjet e grupeve etnike.

Pavarësisht përkrahjes formale të disa arritjeve historike, si Epoka e Iluminizmit dhe njohja e të gjithë njerëzve, pavarësisht nga raca ose feja, me të drejtat dhe liritë u shpërndanë në mbarë botën dhe përfundimisht u kodifikuan nga konventat ndërkombëtare; në situatat e stresit ekonomik, konfuzionit ose shqetësimeve të sigurisë, demagogjia dhe populizmi mund të zgjojnë lehtësisht djajtë ksenofobikë dhe t'i lëshojnë ato kundër standardeve qytetëruese moderne¹⁷.

¹⁶ Catherine Lutard. *Géopolitique de la Serbie-Monténégro*.

¹⁷ Stefan Lehne, *Will Europe follow Trump on migration?* Carnegie Europe.

Përfundime

Kriza e emigrantëve në vitin 2015 pati një ndikim të madh dhe Ballkani Perëndimor u gjend në çdo aspekt i papërgatitur përballë këtij fluksi duke hasur shumë vështirësi në menaxhimin e kësaj krize.

Kjo ngjarje mund të shërbejë për të kuptuar rëndësinë e bashkëpunimit midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Ky rajon përfaqëson për Evropën një realitet gjeopolitik në rrugën e integritit i cili nuk mund të nënvlerësohet, ashtu si Bashkimi Evropian ka qenë i aftë të sjellë paqe dhe zhvillim ekonomik për qytetarët e shteteve anëtare, është e rëndësishme që sot të kryejë një proces të njëjtë duke e transformuar këtë rajon historikisht kompleks në një rajon me prosperitet duke zgjidhur njëherë e mirë konfliktet e ngrira të cilat e kanë penguar Ballkanin Perëndimor të arritur potencialin e tij të vërtetë.

Ky proces është në zhvillim e sipër dhe ne duhet ta ruajmë atë dhe të sigurojmë zbatimin e plotë dhe të suksesshëm, pavarësisht zërave që flasin kundër këtij integriti, përfshirë edhe ata brenda Bashkimit Evropian. Në rajon janë bërë disa arritje duke harmonizuar legjislacionin kombëtar me standardet evropiane, duke promovuar praktikën më të mira, duke reformuar drejtësinë dhe administratën, duke forcuar sundimin e ligjit dhe demokracinë, duke zhvilluar transportin, sektorin e energjisë apo atë të shëndetësisë. Megjithatë, shumë përpjekje do të nevojiten në fushën e arsimit, në këtë kuptim nxitja e shkëmbimit kulturor, dhënia më e madhe e aksesit në arsim dhe përforsimi i mundësive për të rinjtë janë thelbësore për të mbrojtur lulëzimin e rajonit. Vetëm duke punuar me brezat e rinj ne do të kemi garanci se fantazmat e vjetra të nacionalizmit, përjashtimit dhe urrejtjes i përkasin të kaluarës, e nuk do të ketë më hapësirë për ta në të ardhmen.

Bibliografia

B. Azkin. *State and nation*. Hutchinson. London, 1964

Stefano Bianchini, *La questione Jugoslava*. Giunti. Florence, 2003

Stefan Lehne, *Will Europe follow Trump on migration?* Carnegie Europe

Catherine Lutard. *Géopolitique de la Serbie-Monténégro*

Miguel Ángel Rodríguez Andreu. *Anatomía serbia*

Anthony D. Smith, *The ethnic origins of nations*

G. Tassinari, Nascita e dissoluzione della Jugoslavia. Alpha Test. Milan, 2003

Aldin Zenovic, *Asylum seekers from Asia and Africa on their way to Western Europe: Position of Serbia and other countries in the region as transit stations*. International Journal of rule of law, transitional justice and human rights. Volume

Technical reports from: IOM, Human Rights Watch, Government of Serbia, Chatham House.

NË PORTËN E EVROPËS: RAPORT MBI REFUGJATËT NË RRUGËN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Senada Šelo Šabić dhe Sonja Borić

- Mes muajit shtator 2015 dhe mars 2016, rreth 700,000 emigrantë të drejtuar drejt Evropës Perëndimore hynë në territoret e Maqedonisë, Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë. Të katër vendet shërbyen si rrugë tranziti për emigrantët në rrugën e tyre drejt Austrisë, Gjermanisë dhe Suedisë. Një numër i parëndësishëm i refugjatëve kërkuar azil në të katër vendet.
- Sfidat e brendshme ekonomike dhe politike, të përkeqësuar nga çështjet bilaterale akoma të pazgjidhura dhe trashëgimia e luftërave në vitet 1990, vazhdojnë të kërcënojnë stabilitetin rajonal. Kriza e fundit e emigracionit vetëm sa i është shtuar këtyre tensioneve. Këto tensione në rritje kanë çuar në spekulime rreth një ripërtëritje të konfliktit midis këtyre fqinjëve, disa prej të cilave tashmë janë shtete anëtare të BE; dhe të tjerat janë vende kandidatë për në BE.
- Afërsia e tyre e përbashkët gjeografike përgjatë rrugës së refugjatëve ka rëndësi më shumë se marrëdhëniet para-ekzistuese me BE-në. Të gjithë ndanë të njëjtin shqetësim se Gjermania dhe Austria mund të mbyllin kufijtë e tyre ndaj emigrantëve. Asnjë nga vendet nuk dëshiron të bëjë një pikë e nxehtë për refugjatët apo t'i mirëpresë ata për një periudhë më të gjatë kohore.
- Pas vendosjes së limiteve hyrëse ditore të refugjatëve në shkurt, Austria njoftoi ndryshim të kursit në lidhje me krizën e emigracionit. Rrjedhimisht, ajo koordinoi një sërë takimesh që në mënyrë efektive e mbyllën rrugën e Ballkanit Perëndimor më 9 mars 2016.
- Ndërsa vendet përgjatë rrugës ballkanike u përpoqën të organizonin regjistrim, strehim, transport dhe mbështetje të përshtatshme për ata që hyjnë në territoret e tyre, u ngritën shqetësime ndaj valëve ditore të emigrantëve që hyjnë drejt BE-së-dhe me to erdhën akuza të ndërsjellta.

Rruga e Ballkanit



Kohështirja e ngjarjeve më të rëndësishme

Bashkimi Evropian	Ballkani Perëndimor
14.09.2015 Këshilli i Jashtëzakonshëm i Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme - Nuk ka	15.09.2015

marrëveshje për një skemë detyrimi të zhvendosjes. Miratimi formal i skemës së jashtëzakonshme të zhvendosjes të përkohshme dhe për 40 000 persona (bazuar në propozimin e parë të zhvendosjes së jashtëzakonshme të Komisionit) dhe marrëveshjes për vendosjen ushtarake në Med dhe aktivizimin e pikave të nxehta në Itali dhe Greqi	HU mbyll kufirin me RS, aktivizohet rruga përmes HR dhe SI
22.09.2015 Këshilli i Jashtëzakonshëm i Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme - Miratimi i vendimit për të zhvendosur 120000 persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nga Italia dhe Greqia	
23.09.2015 Mbledhje e Jashtëzakonshme e Këshillit të BE-së	
08.10.2015 Konferencë e nivelit të lartë mbi rrugën e Mesdheut Lindor – Ballkanit Perëndimor	
15.10.2015 Këshilli Evropian - Udhëheqësit e BE-së rishikuan masat e zbatuara deri më tani dhe ranë dakord për orientime të mëtejshme	25.10.2015 Mbledhje mbi Rrugën e Emigrimit të Ballkanit Perëndimor (AL, AT, BG, HR, MK, DE, GR, HU, RO, RS dhe SI u takuan për të rritur bashkëpunimin operacional e të gjithëve për rrugën e

	emigrantëve – plan veprim me 17 pika
11/12.11.2015 Samiti Valletta për emigrimin - Krerët e shteteve dhe qeverive evropiane dhe afrikane	18.11.2015 Sllovenia kërkoi një ri-hyrje të njerëzve nga vendet e pa prekura nga lufta
	20.11.2015 HR, MK, RS lejojnë të kalojnë vetëm sirianët, irakenët dhe afganët
	05.01.2016 Që prej kësaj kohe, SI po kërkon një listë të emigrantëve të transportuar në kufi nga HR. Pa listën, emigrantët nuk do të lejohen. Gjithashtu, filluan kontrolle të mëtejshme në kufi.
14/15.01.2016 AT bashkohet me DE për t'i kthyer mbrapsht refugjatët; vetëm ata që duan të kërkojnë azil në AT dhe DE mund të kalojnë	
20/21.01.2016 AT tejkalon fluksin e refugjatëve: 37.500 kërkesa azili në vitin 2016, 130.000 kërkesa azili brenda vitit 2019 DE të zgjerojë kontrollet kufitare për një kohë të pacaktuar	20.01.2016 SI njofton se do ndjekë masat e AT; MK mbyll kufirin me GR; HR njofton se do ndjekë masat ndaluese të AT, HR do miratojë gjithashtu rregulla të reja; informacione shtesë do

Ministri i Brendshëm i DE thotë se ai dëshiron të zvogëlojë në mënyrë drastike numrin e refugjatëve; kushdo pa dokumente të vlefshme i cili nuk kërkon azil në DE do të kthehet mbrapsht	të nevojiten nëse azilkërkuesit duan të kërkojnë azil në AT dhe DE
31.01.2016 Merkel thotë se refugjatët pritet të shkojnë në shtëpi pas përfundimit të konfliktit / shumë prej emigrantëve afganë do të kthehen gjatë muajve të ardhshëm (1.2.2016.) AT ka në plan të riatdhesojë 50000 azilkërkues brenda tre vjetësh DE njofton se refugjatët me rekorde kriminalë duhet të deportohen drejt vendeve të treta, ndërsa AT planifikon kontrolle më të rrepta kufitare dhe rrethime të reja përgjatë kufirit me SI	
	01.02.2016 Maqedonia mbyll kufirin (kjo ndodh periodikisht - MPJ e MK thotë se vendi është disa javë larg nga ndalimi i i plotë i hyrjeve nga GR)
	08.02.2016 Maqedonia fillon të ndërtojë një rrethim të dytë në kufi me Greqinë
	12.02.2016 AT paralajmëron MK se po bëhet gati për të mbyllur

	kufirin nëse AT plotëson kuotat e saj
	14.02.2016 Nga java e ardhshme, AT merr emigrantë vetëm nga shtetet e shkatërruara nga lufta, masë për të cilën e ka njoftuar SI-në, e cila do të zbatojë të njëjtën masë si AT për të cilën ajo ka njoftuar pjesën tjetër të vendeve përgjatë rrugës
15.02.2016 Grupi i Vishegradit mund ta ndihmojë Maqedoninë të mbyllë kufijtë e saj / ata sugjerojnë mbylljen e rrugës ballkanike AT zgjeron listën e vendeve të sigurta të origjinës me: Algjeri, Gjeorgji, Ganë, Marok, Mongoli, Tunizi	
	18.02.2016 Samiti i Zagrebit
19.02.2016 AT paraqet rregulla të reja për emigrantët: 80 aplikime për azil në një ditë + 3200 persona lejohet të kalojnë në DE para ditës	
	21.02. 2016 MK kalon kufizime të reja: Afganët nuk lejohen më të kalojnë (Policia maqedonase thotë se kjo është për shkak

	se Serbia, Kroacia dhe Sllovenia kanë vendosur të ulin numrin e tyre)
	22.02.2016 AT dërgon shtatë oficerë policie në MK; SI vendos ushtrinë në kufi me HR
24.02.2016 Deklarata e Samitit të Vienës 'Të Menaxhojmë Emigrimin së bashku' bën thirrje për standarde të përbashkëta për regjistrimin dhe aplikimin strikt të kritereve të hyrjes Greqia tërheq ambasadorin nga Austria HU shpall referendumin mbi kuotat Parlamenti i DE miraton rregulla më strikte azili	
25.02.2016 Ministrat e Brendshëm të BE-së takohen në Bruksel për të diskutuar rreth krizës Komisioneri i Emigracionit në BE deklaron 'BE ka edhe 10 ditë kohë për të reduktuar numrin e emigrantëve përndryshe ekziston rreziku që i gjithë sistemi të shkatërrohet'	
	26.02.2016 Sllovenia vendos të lejojë hyrjen e 580 emigrantëve në ditë, Kroacia e ndjek, Serbia thotë se do të ndjekë

	shembullin (pavarësisht njoftimit, më 27.2. vetëm 220 ishin pranuar në Maqedoni, më 28.2. vetëm 305 dhe më 29.2. vetëm 50)
	29.02.2016 protesta në kufirin greko-maqedonas (barrikada thyhet, policia maqedonase përdor gaz lotsjellës) Gjatë dy ditëve të ardhshme, askush nuk është lejuar të kalojë
01.03.2016 Tusk bën thirrje për rivendosjen e Shengenit Tusk i bën thirrje emigrantëve ekonomikë të mos vijnë në Evropë	
07.03.2016 Samiti BE – Turqi Këshilli i BE harton ‘rruga e Ballkanit është e mbyllur’; Merkel dhe Juncker e kundërshtojnë	
08.03.2016 Arritja e Marrëveshjes Parlamenti Evropian kritik i marrëveshjes	08.03.2016 Vendet e BP mbyllin kufijtë (zbatimi i Kodit Shengen); rivendosen rrugët hekurudhore midis HR dhe HU

Parathënie

Ky raport ofron një përmbledhje të krizës aktuale të refugjatëve që ndodhi në Ballkanin Perëndimor midis shtatorit 2015, kur vala e parë e refugjatëve mbërriti në Kroaci në vijim të vendimit të Hungarisë për të mbyllur kufirin me Serbinë, dhe marsit 2016, kur Maqedonia mbylli kufirin me Greqinë, duke bllokuar efektivisht rrugën e Ballkanit Perëndimor. Ndoshta për herë të parë që nga vitet 1990, raportoheshin çdo ditë lajme nga ky rajon, si tregimet personale, reagimet institucionale dhe llogaritë e medias mbushën hapësirën publike.

Ndërsa ngjarjet e përditshme kanë marrë një vëmendje të konsiderueshme, qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë më kolektivisht dhe në tërësi gjashtë muajt e fundit si një e tërë për të kuptuar se çfarë ka ndodhur, çfarë mësimi është nxjerrë dhe cili do të jetë ndikimi i krizës . Ky raport përshkruan kushtet dhe procedurat për emigrantët në rrugën e BP, dhe si këto kushte dhe procedura kanë evoluar me kalimin e kohës. Për më tepër, ai përpiqet të kapë dinamikën e diskursit politik dhe raportimin e medias mbi emigracionin në secilin vend, marrëdhëniet midis shteteve fqinjë dhe ndërveprimet e tyre me Komisionin Evropian dhe kryeqytetet evropiane. Qëllimi është të kontribuojë në një debat të informuar mbi emigracionin, integrimin e refugjatëve dhe efektet e krizës së refugjatëve për shoqëritë në Evropën Juglindore si dhe për Bashkimin Evropian.

Hyrje

Në shtator të vitit 2015, rruga e Ballkanit Perëndimor, e përbërë nga Maqedonia, Serbia, Kroacia dhe Sllovenia u bënë shtegu primar i tranzitit për emigrantët që drejtoheshin drejt Evropës Perëndimore. Ndërsa vendet përgjatë rrugës ballkanike hasën vështirësi në organizimin e regjistrimit, strehimit, transportit apo mbështetjes së duhur për ata që hyjnë në territoret e tyre, u ngritën shqetësime mbi valën e përditshme të emigrantëve që hynin në BE - dhe me të erdhën akuza të ndërsjellta. Marrëveshja mbi një zgjidhje të përbashkët të BE-së u pengua më tej nga

qëndrimi i Grupit të Vishegradit¹, i cili refuzoi të merrte pjesë në ndonjë mekanizëm të zhvendosjes dhe gjithashtu advokoi për një ndalim të plotë për hyrjen e mëtejshme të emigrantëve në Evropë.

Një sërë masash në dukje të pakoordinuara dhe të njëanshme të adoptuara nga shtetet individuale morën formën e dy qasjeve të kundërta mbi mënyrën e trajtimit të krizës. Propozimi i Gjermanisë, i mbështetur nga shumica e shteteve anëtare të BE-së dhe KE-së, duke bërë thirrje për emigrim të menaxhuar nëpërmjet një marrëveshjeje me Turqinë, u kundërshtua nga propozimi i Grupit të Vishegradit për të mbyllur tërësisht kufijtë përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor. Në fillim të vitit 2016, kufizimet u shtuan vetëm për hyrjen e emigrantëve, veçanërisht pasi shtetet evropiane rivendosën kontrollet kufitare, të cilat për herë të parë kërcënuan dhe dëmtuan Zonën Shengen.

Përfundimisht, Austria dhe Sllovenia u bashkuan me bllokun që mbështeste mbylljen e kufijve përgjatë rrugës së BP dhe kishte mbështetjen e Presidentit të Këshillit Evropian Donald Tusk, i cili vazhdimisht bënte thirrje për rivendosjen e rregullave gjatë Zonës Shengen. Më 18 mars 2016, Samiti BE-Turqi rezultoi në një marrëveshje të gjerë që synonte të frenonte hyrjen e emigrantëve në Evropë. Megjithatë, pavarësisht vendimit të Angela Merkel për të mos përfshirë mbylljen e rrugës së BP në marrëveshje, Sllovenia njoftoi se do të mbyllte kufirin e saj ditën e ardhshme (në përputhje të plotë me Kodin Kufitar të Shengenit). Ashtu si efekti domino, tre vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor i ndoqën shpejt.

Jo shumë vonë, pasi po afrohej dimri, vendet e BP në mënyrë të vazhdueshme koordinuan politikat dhe veprimet për emigrantët, si nga ana logjistike dhe ajo politike. Në nëntor të vitit 2015, Kroacia, Maqedonia dhe Serbia ndërmorën masa të përbashkëta ndaluese; ato filluan të lejonin kalimin tranzit vetëm për emigrantët nga Siria, Afganistani dhe Iraku. Kjo erdhi si rezultat i kërkesës së Sllovenisë për t'i rikthyer emigrantët nga vendet që nuk janë prekur nga lufta drejt Kroacisë. Gjatë fillimit të vitit 2016, Austria dhe Gjermania filluan të kufizojnë numrin e emigrantëve duke deklaruar se vetëm ata që kërkojnë

¹ Grupi i Vishegradit (i njohur gjithashtu si Vishegrad Katër ose thjesht V4) është një aleancë e Republikës Çeke, Sllovakisë, Polonisë dhe Hungarisë.

azil në Austri dhe Gjermani do të lejohen të hyjnë. Sllovenia dhe Kroacia alternuan respektivisht politikat e tyre.

Një javë më vonë, Austria shpalli se do të kufizonte numrin e kërkesave për azil me 37,500 në vitin 2016 (dhe 130,000 deri në vitin 2019). Menjëherë pas kësaj, ajo paraqiti një numër planesh që do të kufizonin numrin e të sapo ardhurve, do të riatdhesonte 50,000 azilkërkues gjatë tre viteve të ardhshme, do të zgjeronte listën e vendeve të sigurta të origjinës dhe do të ndërtonte rrethime të reja përgjatë kufirit me Slloveninë.

Në fund, më 17 shkurt 2015, Austria paraqiti masa të reja kufizuese të cilat ulën numrin e aplikimeve për azil deri në 80 për një ditë dhe numrin e tranziteve në Gjermani deri në 3,200 në ditë. Kjo masë hyri në fuqi një ditë pas një takimi midis krerëve të policisë austriake, sllovene, kroate, serbe dhe maqedonase në Zagreb, ku u arrit bashkëpunimi për të ulur ndjeshëm fluksin e emigrantëve. Përveç kësaj, ata ranë dakord për disa masa konkrete, duke përfshirë standardizimin e regjistrimit të emigrantëve², dhe hyrjen në baza humanitare (p.sh. për emigrantët që vijnë nga Iraku dhe Siria).

Pas këtyre vendimeve, Maqedonia kaloi kontrolle të reja të cilat nuk i lejonin refugjatët afganë të kalonin kufirin e saj. Po ashtu, irakianët dhe sirianët tani do të jenë subjekt i rregullave të mëtejshme, të cilat përfshijnë kontrollet e plota të trupit, testet gjuhësore dhe shqyrtimin e plotë e të gjithë dokumentacionit³. Maqedonia shpjegoi se këto masa të shtuara janë si një përgjigje ndaj vendimeve të marra nga vendet e tjera përgjatë rrugës. Hyrja e vazhdueshme e emigrantëve dhe pakënaqësia në rritje midis disa shteteve anëtare të BE-së mbi trajtimin e krizës nga ana e Greqisë, nxitën thirrjet për të forcuar sigurinë përgjatë kufirit greko-maqedonas.

Vendimi i Maqedonisë për të ndërtuar një rrethim të dytë përgjatë kufirit grek më 8 shkurt 2016, jo vetëm që u mbështet fuqimisht nga Grupi i

² Hyrja e parë do të lejohet vetëm për personat që plotësojnë kushtet e hyrjes të përcaktuara në Kodin Kufitar të Shengenit dhe legjislacionin përkatës kombëtar.

³ Këshilli Evropian për Refugjatët dhe Azilin. Ballkani Perëndimor Lajme Shkurt Shkurt 16-29, 2016. E disponueshme në: <http://us1.campaign-archive2.com/?u=8e3ebd297b1510becc6d6d690&id=8fac50c411>

Vishegradit, por për më tepër sinjalizoi gatishmërinë e grupit për të mbështetur Maqedoninë gjatë krizës. Grupi i Vishegradit kishte dërguar më parë njësi policore shtesë në Maqedoni në dhjetor të vitit 2015. Po ashtu, Serbia bëri të njëjtën gjë edhe në kuadrin e Konventës për Bashkëpunimin Policor në Evropën Juglindore. Më 9 dhe 22 shkurt, Kroacia dhe Austria dërguan përkrahje policore shtesë në kufirin maqedonas. Më 24 shkurt, Austria mbajti një takim në Vjenë të ministrave të punëve të jashtme dhe të brendshme të Austrisë, Sllovenisë, Kroacisë dhe Gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor⁴.

Samiti konfirmoi masat e dakordësuara më parë të krerëve të shërbimeve të policisë, dhe bëri thirrje për standarde të përbashkëta dhe aplikim më të rreptë të kritereve të hyrjes. Të nesërmen, ministrat e brendshëm të BE u takuan në Bruksel për të diskutuar krizën, në të cilën komisioneri i BE për emigracionin paralajmëroi se “BE-ja ka edhe dhjetë ditë kohë për të zvogëluar numrin e emigrantëve përndryshe ekziston rreziku që i gjithë sistemi të shkatërrohet tërësisht.”⁵

Të nesërmen, Sllovenia kufizoi numrin e emigrantëve të lejuar për të hyrë në vend në 580. Kroacia dhe Serbia miratuan kuota të ngjashme. Gjatë tri ditëve të ardhshme, vetëm 220, 305 dhe 50 emigrantë hynë respektivisht në Maqedoni. Këto kufizime të reja të hyrjes e rënduan edhe më shumë situatën tashmë të tensionuar në kufirin greko-maqedonas, e cila kulmoi me protesta më 29 shkurt.

Emigrantët e bllokuar në anën greke të kufirit thyen barrikadën dhe u sulmuan me gaz lotsjellës nga policia maqedonase. Për dy ditët e ardhshme, kufiri u mbyll plotësisht, duke i dhënë shtysë takimit BE-Turqi, i cili në mënyrë efektive e mbylli rrugën e Ballkanit Perëndimor.

⁴ I referohet Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë

⁵ Reuters. BE ka edhe dhjetë ditë kohë për të parë progresin rreth krizës së emigrantëve përndryshe Shengeni shkatërrohet. 2 shkurt 2016. E disponueshme tek <http://www.reuters.com/article/us-europe-migrants-avramopoulos-idUSKCN0VY22T>

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë⁶



Të dhënat e përgjithshme

Rruga nga Greqia drejt Evropës Perëndimore fillon në qytetin e Idomenit, i cili ndodhet afër kufirit jugor të Maqedonisë⁷. Pas kalimit me sukses të kufirit, emigrantët u pranuan në Maqedoni në kampin Vinojug në Gjevgjeli. Prej aty, ata udhëtuan në veri të Tabanovcit, ku ata prisnin të kalonin në qytetin kufitar serb, Miratovac. Në vitin 2015 dhe në fillim të vitit 2016, disa qindra mijë emigrantë kaluan nëpër Maqedoni. Për fat të keq, numri i saktë nuk mund të konfigurohet, pasi Maqedonia filloi të regjistrojë emigrantët në qershor të vitit 2015. UNHCR-ja filloi monitorimin e Gjevgjelisë më 1 korrik 2015 dhe ka vlerësuar se që prej asaj kohe 697,228 emigrantë kanë kaluar nëpër këtë vendndodhje. Sipas zyrës së Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së, rreth 750,000

⁶ Pranimi zyrtar në OKB u bë me kuptimin se Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ishte një emër i përkohshëm për vendin në pritje të zgjidhjes përfundimtare të mosmarrëveshjes së emrit, 8 prill 1993, <http://www.un.org/documents/ga/res/47/a47r225.htm>

⁷ Në këtë raport, ne përdorim emrin Maqedoni pa ndonjë konkluzion të mëtejshëm, por duke theksuar se tre vendet e tjera të analizuar në këtë raport (dhe Austria, për shembull) e njohin Republikën e Maqedonisë si emrin zyrtar të vendit.

emigrantë hynë në vend në vitin 2015.⁸ Arritjet e përafërta të përditshme shkonin në mes 10,000 (tetor)⁹ dhe 5,000 (nëntor)¹⁰.

Kuadri Ligjor

Themeli i sistemit të azilit të Maqedonisë është Ligji për Azilin dhe Mbrojtjen e Përkohshme, i cili u përmirësua ndjeshëm me ndryshimet e vitit 2012. Më tej, dhe si përgjigje ndaj krizës së menjëhershme të refugjatëve, ligji u ndryshua më 16 qershor 2015 për të lehtësuar rregullat e mëparshme kufizuese që i kishte vënë emigrantët në rrezik të paraburgimit arbitrar dhe reagimeve negative në kufi. Domethënë, emigrantëve iu është dhënë tani mundësia të shprehnin një vendin e dëshiruar për të paraqitur kërkesën për azil në kufi, gjë që u lejoi atyre të hynin ligjërisht në vend për një periudhë deri në 72 orë, përpara se ata të kërkonin formalisht dorëzimin e një kërkesë. Në qershor të vitit 2015, qeveria filloi një procedurë për të hartuar një ligj të ri të azilit që do të përputhej me instrumentet e azilit të BE-së deri në vitin 2016. Pavarësisht përmirësimeve në kuadrin ligjor, UNHCR bëri një shqyrtim të sistemit të azilit të Maqedonisë në gusht 2015 dhe arriti në përfundimin se vendi nuk mund të rekomandohej si vend i tretë i sigurt për shkak të vështirësive në zbatim.

Kohështrirja

Kriza e emigracionit në Maqedoni u përshkallëzua në mënyrë dramatike në pranverën e vitit 2015, kur Amnesty International dokumentoi keqpërdorimin e rëndë të emigrantëve në duart e autoriteteve. Për më tepër, të paktën tridhjetë emigrantë vdiqën në fillim të vitit 2015, pasi u goditën nga trenat duke ecur përgjatë linjave hekurudhore (si ilegalë,

⁸ Numrat dhe trendet e refugjatëve dhe emigrantëve në IRJM, Serbi dhe Kroaci.

Përditësimi nga Zyra e Koordinatorit Rezident të OKB-së, Shkup. 9 dhjetor 2015

⁹ Velina Lylianova. Briefing January 2016. European Parliamentary Research Service. PE 573.949

¹⁰ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. January – December 2016, fq. 49

emigrantëve nuk u lejohej të përdornin transportin publik¹¹). Më 24 prill, në një incident të vetëm, katërmëdhjetë emigrantë u vranë nga një tren, i cili nxiti nevojën për ndryshimet legjislative e lartpërmendura.¹² Ndërsa presionet e emigracionit u rritën, Maqedonia shpalli gjendjen e jashtëzakonshme më 21 gusht në kufijtë e saj veriorë dhe jugorë ; ajo vendosi ushtrinë, e cila sulmonte emigrantët me gaz lotsjellës dhe granata shurdhuese.

Maqedonia shpresonte se duke i bërë thirrje forcave të saj të armatosura do të ushtronte presion mbi Brukselin për t'i ardhur në ndihmë,¹³ me idenë se fondet evropiane me siguri do të mbulonin kostot e krizës.¹⁴ Megjithatë, në realitet, Maqedonia nuk ka pasur ndonjë kosto të konsiderueshme, pasi refugjatët në përgjithësi paguanin vetë për transportin e tyre drejt kufirit serb, pasi u lejuan të përdorin transportin publik.

Vlen të theksohet se çmimi i biletës së kësaj rruge hekurudhore u rrit nga 7 në 25 euro gjatë këtyre muajve kontestues, duke lejuar që kompania hekurudhore maqedonase të ketë miliona fitime.¹⁵ Bizneset e tjera, duke përfshirë shërbimet e taksive dhe autobusëve, shitësit dhe pronarët e

¹¹ Francesca Rolandi. Macedonia, the Refugee Emergency. Osservatorio Balcani e Caucaso. 23 shtator 2015. E disponueshme tek: <http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/Macedonia-the-Refugee-Emergency-164182>

¹² Zoran Arbutina. Death along the Balkan route. 30 prill 2015. E disponueshme tek: <http://www.dw.com/en/death-along-the-balkanroute/a-18421868>

¹³ Zoran Jordanovski. Humanitarna tragedija u Makedoniji. Deutsche Welle. 21 gusht, 2015. E disponueshme tek: <http://www.dw.com/hr/komentar-humanitarna-tragedija-u-makedoniji/a-18664679>

¹⁴ Presidenti maqedonas Ivanov shpjegoi se Maqedonia nuk është anëtare e BE, Shengenit, apo NATO, por megjithatë është detyruar të mbrojë BE-në nga një shtet anëtar i saj (Greqia), e cila nuk po përmbush detyrimet e saj. <http://www.blic.rs/vesti/svet/ivanov-makedonija-placagreske-evropske-unije/g4df3pe>

¹⁵ Gjatë verës dhe dimrit të vitit 2015, hekurudhat e Maqedonisë fitonin afërsisht 100,000 euro në ditë për transportimin e refugjatëve. http://www.b92.net/biz/vesti/svet.php?yyyy=2016&mm=02&dd=18&nav_id=10982

dyqaneve gjithashtu patën përfitime.¹⁶ Për më tepër, kryesisht organizatat joqeveritare paguan shpenzimet për të drejtuar qendrat e grumbullimit.

Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm mbetet se emigrantët nuk përbëjnë vetëm një kërcënim për sigurinë por gjithashtu paraqesin një detyrim të madh financiar ndaj ekonomive tashmë të tendosura. Gjendja e emergjencës u zgjat edhe përgjatë shtatorit mbas një vote parlamentare në qershor të vitit 2016. Sipas Ministrisë së Brendshme, midis qershorit dhe korrikut të vitit 2015, 52,757 persona u regjistruan në kufi. Kjo ishte një rritje e madhe nga periudha e njëjtë e vitit 2014, kur numri i personave të regjistruar ishte 1,750.¹⁷ Pasi mijëra refugjatë të tjerë po mbërrinin në dyert e Evropës, Maqedonia, ashtu si vendet e tjera përgjatë rrugës ballkanike, prezantoi një program kombëtar ekzaminimi më 18 nëntor 2015.

Sic u theksua më lart, vetëm ata që vijnë nga Siria, Afganistani dhe Iraku u lejuan të kalonin kufirin e saj. Më 28 nëntor, Maqedonia filloi të ngrejë një rrethim përgjatë kufirit me Greqinë, në një përpjekje për të kufizuar fluksin. Më 18 shkurt 2016 u arrit një marrëveshje midis krerëve të shërbimeve policore të pesë vendeve përgjatë rrugës (Maqedoni, Serbi, Kroaci, Slloveni dhe Austri) për të lejuar hyrjen vetëm në bazë të arsyeve humanitare; kjo përfshinte një kërkesë për të paraqitur një ID me foto në kufi. Kufizimet e reja shkaktuan një mbipopullim të madh përgjatë anës greke të kufirit dhe çuan në disa konflikte midis emigrantëve dhe policisë maqedonase.

¹⁶ Në shkurt të vitit 2016, shoferët e taksive në Maqedoni organizuan një bllokim pesë-ditor të shërbimeve të transportit hekurudhor, duke kërkuar pjesën e tyre të rregullt të biznesit të transportit. Bllokada u ndal vetëm pasi u arrit një marrëveshje me qeverinë.

<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/11/Region/2197111/Taksisti+u+Makedoniji+okoncali+štrajk,+slobodan+prolaz+za+izbeglice.html>

¹⁷ IOM Emergency Response Plan for Serbia and the Former Yugoslav Republic of Macedonia. shtator – dhjetor 2015. fq. 1 E disponueshme tek:

https://www.iom.int/sites/default/files/country_appeal/file/IOMEuropean-Migration-Crisis-WB-Response-Plan-Appeal.pdf

Regjistrimi

Maqedonia filloi regjistrimin e emigrantëve të parregullt dhe personave të zhvendosur më 19 qershor 2015. Fillimisht, policia ishte në gjendje të regjistrojë vetëm një të tretën deri në gjysmën e të gjithë emigrantëve që mbërrinin; megjithatë, në dhjetor të vitit 2015, sistemi u bë plotësisht funksional dhe të gjithë ata që hynë që prej asaj kohë u regjistruan.¹⁸ Regjistrimi është bërë në kampin e hyrjes në Gjevgjeli, ku u sigurua strehimi dhe mbështetja humanitare bazë.

Numri i përgjithshëm i regjistrimeve të policisë ndërmjet 19 qershorit dhe 7 dhjetorit 2015 ishte 317,507. Siç u përmend më lart, ndryshimi i Ligjit për Azil teknikisht nënkuptonte se ata që regjistrohen, në fakt shprehin synimin e tyre për të kërkuar azil në Maqedoni. Megjithatë, nga 317,507 regjistrime, janë paraqitur vetëm 83 aplikime formale. Kështu, Maqedonia ishte dhe ka qenë thjesht një vend tranzit; të gjithë ata që hynin largoheshin me të njëjtën shpejtësi.

Akomodimi

Kampi në Gjevgjeli mund të strehojë deri në 1,920 njerëz në çdo moment, ose 596 persona për një qëndrim 24 orësh. Me numrin e strehimeve që janë premtuar, ky numër duhet të rritet deri në 812. Kampi ka vende për të pushuar, tualete dhe çezma uji. Ushqimi sigurohet rregullisht nga organizatat humanitare, ndërsa Kryqi i Kuq administron ndihmën e parë.¹⁹ Qendra e përkohshme Vinojug në Gjevgjeli është e pajisur me shërbime që përfshijnë: aksesin në informacion (Wi-Fi, bordet e informacionit, kutitë e vërejtjes dhe një sistem altoparlant); shërbimet e mbrojtjes (këshillim dhe informim ligjor, hapësira miqësore për fëmijët, mbështetje psikosociale dhe shërbime të ribashkimit familjar); shërbime mjekësore (ndihma e parë dhe kujdesi parësor, një kamion i

¹⁸ Në atë kohë, më shumë se gjysma e emigrantëve ishin gra dhe fëmijë. Numrat dhe tendencat e refugjatëve dhe emigrantëve në IRJM, Serbi dhe Kroaci. Përditësuar nga zyra e koordinatorit rezident të OKB, Shkup. 9 dhjetor 2015

¹⁹ Welcome 2 Europe, E disponueshme tek:

<http://w2eu.info/macedonia.en/articles/macedonia-living.en.html>

lëvizshëm me shërbime gjinekologjike, transport i ambulancës në spitalet e afërta); ndihma materiale (ushqime dhe sende të tjera si batanije, çanta për fjetje, rroba dimri dhe kuti dinjiteti); Lehtësimet higjienike (dushet me ujë të ngrohtë, tualetet e ndara sipas gjinisë, si dhe ato të rregulluara për personat me aftësi të kufizuara dhe pajisjet e foshnjave). Të gjitha këto shërbime u ofrohen pa kosto refugjatëve.²⁰

Kampi në Tabanovcë ka një kapacitet maksimal prej 991 personash në tranzit, ose 356 persona nëse strehohen për një periudhë 24 orësh (me strehime të premtuara, numri duhet të rritet deri në 510). Është e pajisur me shërbime të ngjashme me ato të ofruara në Vinojug. Për ta përmbledhur, vendi aktualisht nuk është i përgatitur për të akomoduar njerëzit për periudha më të gjata. Pas mbylljes së rrugës së Ballkanit Perëndimor, 1.171 persona ishin ende të bllokuar në Maqedoni.²¹

Rruga e Emigrantëve

Rruga nga qendra e tranzitit të Idomenit në Greqi, deri në kufirin me Serbinë mund të përshkruhet si më poshtë: Emigrantët ecin nga Idomeni për të kaluar në Maqedoni, ku ata përfundimisht arrijnë në qendrën e tranzitit Vinojug në Gjevgjeli. Distanca është më pak se 1 kilometër. Në Gjevgjeli, emigrantët presin deri në pesë orë për transport në Tabanovcë. Transporti në Tabanovcë organizohet ose me tren (4-5 orë), autobus (3 orë) ose taksi (2.5 orë). Trenat mund të strehojnë deri në 400 persona. Çmimi i transportit është 25 euro për të tre mënyrat e transportit.

Për fëmijët nën moshën dhjetë vjeç, treni është falas, ndërsa shërbimet e autobusëve dhe taksive ofrojnë gjysmë çmimi për fëmijët nën shtatë vjeç. Emigrantët zakonisht qëndrojnë disa orë në Tabanovcë, përpara se të vazhdojnë udhëtimin e tyre. Emigrantët e kombësive të ndaluara për të kaluar kufirin zakonisht qëndrojnë në qendër për një periudhë prej 2-3 ditësh. Më vonë, emigrantët ecin dy kilometra në Miratovac, i cili zgjat

²⁰ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016, fq. 49

²¹ IOM Weekly Flows Compilation Report No. 10 E disponueshme tek: <http://doe.iom.int/docs/Weekly%20Flows%20Combilation%20No%2010%2017%20Mar%20Final.pdf>

rreth 40 minuta përgjatë një rruge me baltë me dy përrenj pa ura²² (për grupet vulnerabël, transporti ofrohet nga të dy vendet).²³

Debati Politik

Duke marrë në konsideratë trazirat politike të Maqedonisë që nuk lidhen me krizën e emigrantëve, kjo çështje e veçantë nuk u regjistrua në rend të ditës për politikanët dhe, rrjedhimisht, mediat. Në përgjithësi, reagimi i qeverisë VMRO-DMPNE ndaj krizës së refugjatëve mund të karakterizohet si indiferent, nëse jo haptazi armiqësor. Kriza kryesore politike në Maqedoni, e cila vazhdoi për disa vjet, arriti kulmin në pranverën e vitit 2015 me nxjerrjen e përgjimeve nga partia opozitare, e cila inkriminonte zyrtarët qeveritarë për shkelje të rëndë të ligjit brenda një numri skandalesh korrupsioni. Gjendja politike u përkeqësua më tej në maj të vitit 2015, kur një milici shqiptare, në një incident të paqartë, infiltroi qytetin e Kumanovës i cili supozohej të kryente sulme terroriste. Protestat masive kundër-qeveritare u zhvilluan pak pas kësaj kohe.

Paqëndrueshmëria në rritje në Maqedoni mobilizoi BE-në për të ndërmjetësuar një marrëveshje midis qeverisë dhe opozitës. Gjatë verës, komisioneri i BE Johannes Hahn, zëvendës sekretarja e shtetit Victoria Nuland dhe zyrtarë të tjerë evropianë udhëtuan në Shkup për të negociuar paqen mes dy kampeve.

Një marrëveshje, e arritur në shtator të vitit 2015, bëri thirrje për zgjedhjen e një prokurori të posaçëm për të hetuar pretendimet e mbikëqyrjes ilegale, dorëheqjen e kryeministrit Nikola Gruevski në janar 2016 dhe zgjedhjet e reja në pranverë të vitit 2016. Pas pengimeve fillestare, prokurorja speciale dhe ekipi i saj më në fund filluan hetimet e tyre dhe kryeministri dha dorëheqjen më 15 janar 2016. Megjithatë, për

²² Në mars të vitit 2016, Maqedonia filloi të ngrinte një rrethim me një gjatësi prej tre metrash të siguruar me tela me gjemba në kampin e Tabanovcit, ku në atë kohë mbetën të bllokuar rreth 1.300 emigrantë.

²³ IOM Weekly Flows Compilation Report No. 4. E disponueshme tek: <http://doe.iom.int/docs/WEEKLY%20Flows%20Compilation%20No4%204%20Feb%202016.pdf>

shkak të problemeve të vazhdueshme me lirinë e medias, listat e votuesve dhe çështje të tjera, data e zgjedhjeve të reja u shty për në qershor 2016.

Siç u përmend më lart, kriza e refugjatëve mori pak vëmendje, me përjashtim të vendimit të Maqedonisë për të mbyllur kufijtë e saj në gusht 2015 dhe përsëri në mars të vitit 2016, kur filluan përplasjet midis refugjatëve dhe rojeve kufitare. Fakti që Maqedonia ishte pika e hyrjes në rrugën e Ballkanit Perëndimor, politikanët e shprehur në lidhje me ngadalësimin e rrjedhës së emigrantëve ose mbylljen e kufirit tërësisht, ishin në gjendje të dallonin popullaritetin e tyre. Si i tillë, kapaciteti veprues i qeverisë maqedonase për të kontrolluar kufirin dhe për të vepruar në mënyrë efektive mbi marrëveshjet e ndërmjetësuara me organet ndërkombëtare, shtoi legjitimitetin e qeverisë së Gruevskit.

Ndërkohë që kriza e refugjatëve nuk ndihmoi në debatin e brendshëm politik në Maqedoni, ajo i ofroi qeverisë së tanishme mundësinë për të shënuar disa përkrahës të tjerë në mesin e publikut dhe jashtë saj, pavarësisht kritikave të veprimeve të saj.²⁴

Media

Në përgjithësi, mediat maqedonase, duke reflektuar qeverinë dhe pamjen relativisht negative të publikut ndaj emigrantëve, nuk ishin të ndjeshme ndaj kauzës së tyre. Mbulimi i ekuilibruar ishte i mirë-organizuar, sidomos kur fokusi primar iu kushtua shqetësimeve të sigurisë, p.sh. numri i të ardhurve të përditshëm, spekulimet se Gjermania dhe Austria duhet të mbyllin kufijtë e tyre dhe frikën e terroristëve të mundshëm që përdorin krizën e refugjatëve për të hyrë në Evropë. Po ashtu, mediat ngritën haptazi pyetjen se pse Maqedonia duhet të luajë rolin e partnerit konstruktiv evropian brenda krizës së refugjatëve, duke pasur parasysh faktin se BE-ja për vite me radhë ka bllokuar përpjekjet e aderimit të Maqedonisë.²⁵ Megjithatë, këto tregime u anashkaluan nga media,

²⁴ Florian Bieber. Gruevski Does Not Deserve Any More Chances. Balkan Insight. 23 qershor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.balkaninsight.com/en/blog/gruevski-does-not-deserve-any-more-chances>

²⁵ Gjorge Ivanov, President of Macedonia. Macedonia is defending Europe from itself. Comment, The Telegraph. 6 mars, 2016. E disponueshme tek:

kryesisht për shkak të mbulimit të përditshëm të grindjeve ndërpartiake dhe përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për të ndërmjetësuar krizën e brendshme të Maqedonisë.

Shoqëria Civile

OJQ-të lokale si Kryqi i Kuq, El-Hilali, Legis, Nun dhe Iniciativa Qytetare ishin midis të parëve që trajtuan gjendjen e refugjatëve që kalonin nëpër Maqedoni në rrugën e tyre drejt BE-së. Ata ishin vendosur në kufirin me Greqinë dhe Serbinë, dhe ofruan asistencë të menjëhershme. Vëmendja e mediave sociale u përqendrua në një grup në Facebook të quajtur: “Ndihamoni emigrantët në Maqedoni”. Qytetarët dhuruan ushqime, veshje dhe plotësuan nevoja të tjera. Organizatat fetare, duke përfshirë Kishën Ortodokse, Bashkësinë Islame, Kishat Katolike dhe Protestante, gjithashtu u bashkuan me këto përpjekje. Bizneset lokale ofruan donacione, si dhe KNKK dhe UNHCR. Pavarësisht këtij vullneti të mirë, frika mbetet se nëse vazhdon të vijë një numër i madh i refugjatëve, ose nëse ata janë të detyruar të qëndrojnë në Maqedoni, dhembshuria e këtyre nismave nuk do të mjaftonte.²⁶

<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/macedonia/12185464/Macedonia-is-defending-Europe-from-itself.html>

²⁶ Sveto Toevski. Humanitarna kriza u Makedoniji. Deutsche Welle. August 22, 2015. E disponueshme tek: <http://www.dw.com/hr/humanitarnakriza-u-makedoniji/a-18665534>

Serbia



Të dhënat e përgjithshme

Ashtu si Maqedonia, numri i saktë i tranzitëve nëpër Serbi është i variueshëm. Ndërsa Parlamenti European vlerësoi rreth 596,000 hyrje në vitin 2015,²⁷ UNHCR numëronte 815,000.²⁸ Sipas ONE, gjithsej 639,152 emigrantë kalonin nëpër vend, duke filluar nga fillimi i vitit

²⁷ Velina Lylianova. Briefing January 2016. European Parliamentary Research Service. PE 573.949.

²⁸ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. January – December 2016.

2015 deri në shkurt 2016.²⁹ Në tetor dhe nëntor 2015, Serbia mesatarisht kishte 6,500 hyrje ditore.³⁰ Ndërmjet 1 janarit dhe 3 marsit 2016, 89,180 kalonin tranzit nëpër vend.³¹

Kuadri ligjor

Legjislacioni përkatës në Serbi lidhur me refugjatët përbëhet nga Ligjet e vitit 2008 mbi Azilin, të huajt dhe Mbrojtjen Shtetërore të Kufirit, Ligji i vitit 2012 mbi Menaxhimin e Emigracionit dhe Ligji i vitit 2014 për Punësimin e të Huajve. Si pjesë e kuadrit të Serbisë për pranimin në BE, legjislacioni i azilit është identifikuar si pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së. Në vitin 2013, Ministria e Punëve të Brendshme filloi formulimin e një projekt-propozimi për një ligj të ri të azilit. Miratimi i tij pritet në gjysmën e parë të vitit 2016.³² Megjithatë, UNHCR ende nuk rekomandon që Serbia të konsiderohet një vend i tretë i sigurt.³³ Ligji i vitit 2008 për azil u lejon refugjatëve të shprehin synimin e tyre për të aplikuar për azil, qoftë në kufi ose brenda territorit serb. Kjo u siguron atyre të drejtën për të qëndruar ligjërisht në vend për një periudhë kohe të kufizuar. Shprehja e qëllimit lidhet me shpresën se do të dorëzohet një aplikim për azil. Ngjashëm me Maqedoninë, pak emigrantë në të vërtetë kanë ndjekur një kërkesë për azil. Nga ata që kanë paraqitur kërkesën, shumica e tyre u larguan para se të merrej një vendim. Që nga kufiri i mbyllur, megjithatë, numri i aplikimeve për azil është rritur, duke arritur në 693 në mars të vitit 2016 (vetëm në 30 mars

²⁹ IOM Weekly Flows Compilation Report Nr. 4. E disponueshme tek: <http://doe.iom.int/docs/WEEKLY%20Flows%20Compilation%20No4%204%20Feb%202016.pdf>

³⁰ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016

³¹ IOM Weekly Flows Compilation Report Nr. 8. E disponueshme tek: <http://doe.iom.int/docs/WEEKLY%20Flows%20Compilation%20No8%2003%20Mar%202016.pdf> Accessed on: 30.3.2016.

³² Velina Lylianova. Briefing January 2016. European Parliamentary Research Service. PE 573.949

³³ Vëzhgime mbi situatën e Mbrojtjes së Azilantëve dhe Përfituesve të Mbrojtjes Ndërkombëtare në Serbi. UNHCR. gusht 2012. E disponueshme tek: <http://www.unhcr.rs/media/UNHCRSerbia-CountryofAsylumScreen.pdf>

ishin 19 aplikime). Numri i vlerësuar i refugjatëve në Serbi gjatë këtij muaji ishte 1,700.³⁴

Kohështrirja

Në maj të vitit 2015, Serbia filloi të hasë një numër në rritje të emigrantëve që kalojnë nëpër territorin e saj. Rruga fillestare ishte ndalesa e ardhshme logjike pas Greqisë dhe Maqedonisë; emigrantët do të hynin në Serbi dhe prej aty do të vazhdonin udhëtimin në veri drejt zonës Shengen, pra, Hungarisë. Megjithatë, në korrik 2015, Hungaria filloi ndërtimin e një rrethimi përgjatë kufirit me Serbinë dhe gjithashtu paraqiti dënime më të rrepta penale për kalimet e paligjshme të kufirit. Gjatë verës, disa incidente u raportuan në zonën kufitare midis emigrantëve dhe policisë hungareze.

Në një rast, forcat e policisë përdorën gaz lotsjellës dhe kanone uji kundër emigrantëve pavarësisht nga fakti se ata ishin në anën serbe të kufirit, duke shkaktuar tensionim midis dy vendeve. Rrethimi përfundoi më 15 shtator, pikë në të cilën, rruga e emigrimit u ridrejtu nga Hungaria në Kroaci. Në fund të shkurtit të vitit 2016, me trazirat në rritje përgjatë kufijve të BP, Serbia bëri thirrje që të gjitha forcat e sigurisë të jenë në gatishmëri të lartë, duke përfshirë ushtrinë e saj. Nëse situata do ta kërkonte, Këshilli për Sigurinë Kombëtare, së bashku me Presidentin e Republikës, do të merrte vendimin nëse do të vendoste ushtrinë. Ministri i Drejtësisë deklaroi se të gjitha forcat e sigurisë ishin përgjegjëse për mbrojtjen e kufijve shtetërorë.³⁵

Regjistrimi

Regjistrimet e refugjatëve u trajtuan në qendrën e Preshevës pranë kufirit me Maqedoninë, ku u raportuan edhe disa probleme. Në një shembull,

³⁴ UNHCR. Serbia Daily Update. 30 mars, 2016. E disponueshme tek: <http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/UNHCRSerbiaDailyUpdate30March2016.pdf>

³⁵ Kurir. Pripravnost na granicama: Srbija šalje vojsku na migrante. 25 shkurt, 2016. E disponueshme tek: <http://www.kurir.rs/vesti/drustvo/pripravnost-na-granicama-srbija-salje-vojsku-na-migrante-clanak-2149007>

Këshilli Evropian për Refugjatët dhe Azilin njoftoi se midis 30 shtatorit dhe 1 tetorit, 2,600 emigrantë u regjistruan në Preshevë, pavarësisht faktit që në këto ditë në qytet kishin arritur 5,000 vetë. Ata raportuan se hendeuku qëndroi përkundër përmirësimit të kapaciteteve të regjistrimit.³⁶ Duhet theksuar se me kalimin e kohës, kapacitetet e regjistrimit janë përmirësuar dhe rreth 8,000 refugjatë mund të regjistrohen në një ditë të vetme.³⁷

Akomodimi

Në Serbi ekzistojnë gjashtë qendra operative që mund të strehojnë emigrantë gjatë tranzitit. Pika hyrëse e tranzitit në Miratovac ndodhet në kufirin me Maqedoninë, dhe mund të strehojë nga 300 deri në 500 persona. Qendra e regjistrimit ‘one-stop’ në Preshevë ndodhet afërsisht trembëdhjetë kilometra nga kufiri maqedonas dhe mund të strehojë deri në 1.500 persona. Në të kundërt, qendra e regjistrimit në Dimitrovgrad pranë kufirit me Bullgarinë ka një kapacitet maksimal prej 140 personash. Ekzistojnë edhe tre qendra të tjera në kufirin kroat: qendra ‘one-stop’ në Pikën Šid (800 persona), Qendra Pritëse e Tranzitit Principovac (250-300 persona), dhe qendra ‘one-stop’ Adaševci (500 persona).³⁸ Serbia aktualisht mund të sigurojë strehim të përkohshëm për 3.000-6.000 persona.³⁹ Sipas Ministrit serb të Punës dhe Politikës Sociale, Serbia nuk u përgatit për t’i mikpritur emigrantët për periudha më të gjata të qëndrimit në vend.⁴⁰

³⁶ European Council on Refugees and Exiles, Western Balkans News Brief: 28 shtator –2 tetor. E disponueshme tek: <http://ecre.org/component/downloads/downloads/1049.html>

³⁷ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016

³⁸ IOM Weekly Flows Compilation Report Nr. 4. E disponueshme tek: <http://doe.iom.int/docs/WEEKLY%20Flows%20Compilation%20No4%204%20Feb%202016.pdf>

³⁹ UNHCR. The Balkan Migrant Crisis: an Introduction, fq. 6 E disponueshme tek: <http://data.unhcr.org/mediterranean/download.php?id=510>

⁴⁰ <http://www.nacional.hr/novi-podaci-povecava-se-broj-migranata-na-sjeveru-vojvodine/>

Rruga e ndjekur nga emigrantët

Siç u përmend edhe më lart, emigrantët kaluan në Serbi midis Tabanovcit (Maqedoni) dhe Miratovcit (Serbi). Ka dy pika të tjera të hyrjes në kufirin me Bullgarinë: Dimirovgrad dhe Zaječar (pas së cilës ata udhëtojnë në Beograd). Nga Miratovac, emigrantët u drejtuan drejt Preshevës, qoftë me këmbë, furgon, ose me autobus, i cili zgjat nga 15 deri në 30 minuta. Nga Presheva, ata mund të shkojnë në Beograd ose në qytetin Šid përgjatë kufirit kroat. Emigrantët që udhëtonin për në Beograd, udhëtuan ose me tren (11 orë / 10 euro) ose me autobus (5 orë / 25 euro). Prej Preshevës deri në Šid, ata mund të marrin një udhëtim 12 orë me tren për 12 euro, ose një udhëtim me autobus prej 6 orësh për 20-30 euro.

Megjithatë, vetëm ata të regjistruar mund të merrnin autobusin për në Šid. Për ata që presin regjistrimin, taksitë e paligjshme ofruan shërbimet e tyre me një vlerë prej 1,000 euro.⁴¹ Pasi arritën në Šid, u organizua një transport i lirë treni për t'i çuar ata në qendrën e pritjes në Slavonski Brod të Kroacisë. Në Šid, njësitë policore serbe dhe kroate kryen procese të veçanta të ekzaminimit; ata që kaluan u lejuan të hipnin në tren në Slavonski Brod.⁴² Para se të organizohej ky transport më 3 nëntor 2015, emigrantët kaluan kufirin me këmbë në kalimin kufitar të Berkasovës / Bapska.

Debati Politik

Mes të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor të vlerësuara në këtë raport, qeveria serbe ka ofruar retorikën më pozitive ndaj refugjatëve. Diskursi i refugjatëve përqendrohej në koncepte si ndjeshmëria, solidariteti njerëzor, përvoja e përbashkët nga luftërat në ish-Jugosllavi

⁴¹ European Council on Refugees and Exiles, Western Balkans News Brief: 28 shtator –2 tetor. E disponueshme tek: <http://ecre.org/component/downloads/downloads/1049.html>

⁴² Intervistë, UNHCR Kroaci. Mars 2016.

dhe përgjegjësitë që shtetet funksionale dhe shoqëritë e zhvilluara duhet të mbajnë. Megjithatë, pati gjithashtu një mesazh të qartë se Serbia nuk do të pranonte asnjë barrë e vetme; ka pasur thirrje të vazhdueshme për një zgjidhje të përbashkët evropiane.⁴³

Një çështje tjetër mund të ketë kontribuar edhe në dashamirësinë e përgjithshme të qeverisë serbe ndaj krizës së refugjatëve. Serbia u shpall kandidat për anëtarësim në BE në vitin 2012 dhe negociatat janë në vazhdim që prej vitit 2013. Konferenca e parë ndërqeveritare e Serbisë dhe BE-së u mbajt në janar të vitit 2014. Megjithatë, me hapjen e kapitujve të parë të BE-së që ndodhën në kohën e krizës së refugjatëve, Serbia, duke shfaqur një vetë-interesim legjitim, në mënyrë inteligjente miratoi një qasje konstruktive dhe të sofistikuar.⁴⁴

Zgjedhjet e parakohshme në Serbi u vendosën për në prill 2016 dhe me mbylljen e rrugës së Ballkanit Perëndimor, çështja e emigracionit ka dalë nga axhenda politike.

Media

Në dallim nga Maqedonia, mediat serbe në përgjithësi nënvizuan karakterin humanitar të krizës së refugjatëve, me fokusim të shpeshtë në tregimet personale të gjendjes së vështirë të emigrantëve. Po ashtu, një numër i gazetave publikuan histori me kushtet çnjerëzore në kufi, veçanërisht kur mbyllen pikat kufitare, si dhe raste të neveritshme të kontrabandistëve dhe kriminelëve që përfitojnë nga refugjatët.⁴⁵

⁴³ Kryeministri serb Vučić shpjegoi se Serbia nuk do të bëhet një pikë e nxehtë për emigrantët, por do të trajtojë në mënyrë humane ata që nuk ishin në gjendje të largoheshin nga territori serb pas mbylljes së rrugës së BP, 9 mars 2016, <http://www.blic.rs/vesti/politika/zatvaranje-balkanske-rute-vucic-srbija-nece-bitiparking-za-migrante/j7hkxkl>

⁴⁴ Serbia hapi dy kapitujt e parë – 32 dhe 35 – në 14 dhjetor, 2015.

⁴⁵ Blic. Literally stuck in the mud, thousands of refugees went freezing in a camp in Greece, and in massive numbers, children were sick. 10 mars, 2016. E disponueshme tek: <http://www.blic.rs/vesti/svet/zaglavljani-u-blatu-hiljade-izbeglica-se-smrzava-u-kampu-u-grckoj-decamasovno/1edskyq>

Në përgjithësi, media serbe në masë të madhe u përqendrua në njerëzit që iknin nga atdheu i tyre në kërkim të sigurisë dhe përmirësimit të kushteve të jetesës. Duke e balancuar ndjeshmërinë, pati një mbulim të gjerë të gjendjes së keqe të brendshme në Serbi. Debati rezultoi në idenë se Serbia po lufton shumë nga problemet e veta dhe nuk është në gjendje të kujdeset për qindra mijëra emigrantë të ardhur.

Shoqëria Civile

Në fillimin e krizës, OJQ-të në Serbi ofruan menjëherë ndihmë për refugjatët kalimtarë. Sa i përket publikut në përgjithësi, ka pasur solidaritet të gjerë me fatkeqësinë e emigrantëve. Donacionet ishin të shumta nga qytetarët, bizneset dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Qendra për Mbrojtjen e Azilit në Serbi zgjeroi punën e saj dhe mobilizoi qindra vullnetarë për të ofruar ndihmë ligjore, mbështetje psikologjike dhe mbrojtje të këtij grupi vulnerabël.

Gjithashtu është e angazhuar në luftën kundër paragjytimeve, ksenofobisë dhe formave të tjera të diskriminimit kundër azilkërkuesve. Grupi 484, Qendra Humanitare e Novi Sadit (QHNS), Forumi Demokratik Serb i Beogradit (FDS), Rrjeti Ndërkombëtar i Ndhmës (RrNN), Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile Protecta, si dhe shumë të tjera (edhe para pranverës së vitit 2015) u angazhuan në punën për çështjet që lidhen me refugjatët dhe emigrantët. Organizata ndërkombëtare si UNHCR, Kryqi i Kuq, ONE, CRS, MSF dhe shumë të tjera ishin gjithashtu në terren.

Kroacia



Të dhënat e përgjithshme

Gjatë 16 shtator 2015 dhe 5 mars 2016, rreth 658,068 emigrantë⁴⁶ kanë hyrë në territorin e Kroacisë. Mesatarisht kanë hyrë rreth 5,500 emigrantë në ditë, numri më i madh i të cilëve ka qenë 11,000 më 17 shtator⁴⁷. 47 Gjatë janar 2016, numri mesatar i emigrantëve që hyri në Kroaci ishte rreth 500 dhe 2,000 persona, dhe disa dite arrinte 3,000 vetë.

Kuadri ligjor

⁴⁶ UNHCR Croatia. Intervistë. Mars 2016

⁴⁷ Të dhënat e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kroacisë. E disponueshme tek: <http://www.mup.hr/main.aspx?id=230152> (të dhënat e fundit të disponueshme).

Në Kroaci, deri më 2 korrik 2015, e drejta për azil rregullohej me Ligjin për Azilin. Për shkak të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë Evropian, hyri në fuqi një ligj i ri mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme më 2 korrik 2015 dhe aktualisht është baza për procedurat e azilit në Kroaci. Kuadri ligjor për azilin në Kroaci përfshin: Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative, Ligjin për Mosmarrëveshjet Administrative, Ligjin për të Huajt, Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor dhe Kujdesin Shëndetësor për të Huajt në Republikën e Kroacisë, dhe Ligjin për Ndhimë Juridike Falas.

Megjithatë, pavarësisht se ekziston kuadri ligjor përkatës, Kroacia mbetet një vend tranzit, pasi më shumë se 80 për qind e azilkërkuesve largohen nga vendi përpara se të shqyrtohen aplikimet e tyre.⁴⁸ Deri më 24 mars 2016 janë regjistruar vetëm 178 aplikime për azil gjatë krizës gjashtë mujore.⁴⁹ Marrja e masave me natyrë kufizuese në mes të shkurtit kontribuoi në rritjen e numrit të aplikimeve për azil.

Gjatë fillimit të krizës deri më 16 shkurt 2016, janë regjistruar 29 kërkesa; midis 16 shkurtit dhe 14 marsit, janë regjistruar edhe 83 kërkesa të tjera. Në mars, qeveria e re kroate propozoi ndryshime që do të lejonin Forcat e Armatosura Kroate të mbështesin policinë në mbrojtjen e kufirit. Sipas ndryshimeve, vendimi për vendosjen e Forcave të Armatosura do të merrej nga qeveria me rekomandimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe me pëlqimin paraprak të Presidentit të Republikës.⁵⁰ Emigrantët që hyjnë në Kroaci kanë të drejtë të kërkojnë azil. Nëse ata zgjedhin këtë opsion, i merren shenjat e gishtave të tyre dhe transferohen në qendra në Kutinë ose në Porin. Ata që nuk kërkojnë azil i lëshohet një ‘vendim rikthimi’ dhe, sa kohë rruga u mbyll, arrinin të vazhdonin udhëtimin e tyre në perëndim.

Kohështrirja

⁴⁸ Jasna Barberić. Asylum in the Republic of Croatia. UNHCR (të dhënat i referohen periudhës para fillimit të krizës).

⁴⁹ UNHCR Croatia. Intervistë. Mars 2016

⁵⁰ Projekt propozim i amendamenteve të Ligjit mbi Mbrojtjen. E disponueshme tek: <https://vlada.gov.hr/UserDocImages//Sjednice/2016/6%20sjednica%20Vlade//6%20-%201b.pdf>

Kriza e emigracionit në Kroaci filloi më 16 shtator, një ditë pasi Hungaria mbylli kufirin e saj me Serbinë. Në pamundësi për të menaxhuar hyrjet masive, Kroacia mbylli të gjitha pikat kufitare me Serbinë më 20 shtator dhe gjatë kësaj kohe, ndaloi të gjithë trafikun e ngarkesave. Serbia iu përgjigj duke mbyllur kufirin e saj për mallrat kroate. Kroacia iu përgjigj duke mbyllur kufirin e saj për makinat me targa serbe dhe për qytetarët serbë. Kjo përplasje zgjati disa ditë, më pas kufizimet u hoqën dhe marrëdhëniet u normalizuan. Në fillimin e krizës, Kroacia i drejttoi emigrantët për në kufirin hungarez, duke shkaktuar një incident ku një tren i mbushur me emigrantë dhe oficerë të policisë kroate të armatosur kaluan kufirin hungarez pa paralajmërim (sipas Hungarisë).

Më 16 tetor, Hungaria ngriti një rrethim përgjatë kufirit me Kroacinë, duke bllokuar hyrjen e emigrantëve përgjatë rrugëtimit të tyre përmes Kroacisë. Prej aty, emigrantët u drejtuan për në Slloveni. Në nëntor u ndërtua një qendër e re pritjeje dimërore dhe u arrit një marrëveshje mes Serbisë dhe Kroacisë për të transportuar emigrantë drejtpërdrejt nga Šid (Serbi) në Slavonski Brod (Kroaci) me tren.

Më 10 dhjetor, Komisioni European miratoi një masë për shkelje për dështimin e plotë në transferimin dhe zbatimin e Sistemit të Përbashkët European të Azilit, kundër Kroacisë (si dhe Greqisë, Italisë, Maltës dhe Hungarisë). Më konkretisht, Komisioni i kërkoi Kroacisë, Greqisë dhe Italisë që të zbatojnë në mënyrë korrekte rregulloren e Eurodac, e cila siguron gjurmimin efektiv të azilkërkuesve dhe transmetimin e të dhënave të nevojshme tek Sistemi Qendror Eurodac brenda 72 orëve.⁵¹ Më 18 nëntor, qeveria e Sllovenisë kërkoi rikthimin e refugjatëve në Kroaci. Qeveria kroate kundërshtoi duke njoftuar homologët e tyre në Beograd dhe Shkup se nuk do të marrë më emigrantë nga vende të tjera përveç Sirisë, Irakut dhe Afganistanit. Më pas, numri hyrjeve ditore në kufirin kroat pësoi rënie nën 3.000 personash.⁵²

⁵¹ European Commission Press Release. 10 dhjetor, 2015. E disponueshme tek: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6276_en.htm

⁵² UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar–Dhjetor 2016

Regjistrimi

Në fillim të krizës, emigrantët u pritën në qendrën e regjistrimit në Ježevo pranë Zagrebit. Megjithatë, për shkak të numrit të madh, policia mbylli regjistrimin e hyrjes së emigrantëve në zonën e Tovarnikut dhe transporti u organizua në qendrat e regjistrimit në Čepin, Ježevo, Beli Manastir, Luç, Torjanci, Sisak dhe Zagreb.⁵³ Më 20 shtator, filloi ndërtimi i një qendre të përkohshme pritjeje në Opatovac, ku regjistrimet u zhvilluan derisa WRTC në Slavonski Brod u bë operative.

Akomodimi

Në ditët e para të krizës, të ardhurit u vendosën në baza *ad hoc* në qendrat për azilkërkuesit në Zagreb dhe Kutina. Për disa orë, qendrat u mbushën dhe qyteti i Tovarnikut u mbushu me emigrantë të ulur në tokë, duke pritur që një tren t'i transportonte më tej. Një qendër e përkohshme pritjeje u hap më 20 shtator në Opatovac, e cila mund të strehonte përkohësisht 40005000 persona. Më 3 nëntor, në Slavonski Brod hapet Qendra Dimërore e Pritjes dhe Tranzitit, e cila mund të strehonte 5000 emigrantë, si dhe të ofronte kujdes të organizuar për emigrantët në tranzit. Shërbimet përfshinin rivendosjen e lidhjeve familjare, kujdesin shëndetësor dhe trajtimin e urgjencave, si dhe mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë nga familjet.

Përveç kësaj, u ofrua siguri, depo për sendet dhe mirëmbajtje e rregullt e qendrës. Fokusi ishte identifikimi dhe ndihmua për individët më vulnerabël, si dhe ata me nevoja specifike. Kryqi i Kuq Kroat siguroi një shërbim gjurmues 24 orësh, së bashku me praninë e përhershme të një punonjësi social të trajnuar. Shërbimet mjekësore u ofruan nga sistemi shëndetësor kombëtar dhe UNICEF hapi një hapësirë miqësore për fëmijët.⁵⁴ Kur rruga e Ballkanit Perëndimor u mbyll më 9 mars, nuk

⁵³ Ministria e Brendshme e Republikës së Kroacisë. Prezantimi i krizës së emigrantëve në Kroaci. E disponueshme tek: http://www.mup.hr/UserDocsImages/topvijesti/2015/listopad/MIGRATION_CRISIS_CRO_OVERVIEW.pdf

⁵⁴ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016

mbërritën më emigrantët të rinj nga Serbia, por u kthyen 270 persona nga Sllovenia.

Disa kërkuan azil në Kroaci. Numri i aplikimeve për azil u rrit gjatë dy javëve të ardhshme, dhe më 30 mars 2016, në Slavonski Brod ishin 161 persona. Shumë nga aplikantët tashmë e lënë Kroacinë pasi aplikimi i tyre i lejoi ata të kalonin në një qendër të hapur pritëse, ku ata mund të lëvizin lirshëm në vende të tjera.

Rruga e ndjekur nga emigrantët

Kur vala e parë masive e emigrantëve mbërriti në shtator, pati një sërë vështirësish në organizimin e transportit dhe akomodimit. Emigrantët kryesisht kalonin kufirin në këmbë në Tovarnik dhe Bapska, dhe pastaj transportoheshin me trena ose autobusë në pikat e ndryshme të pritjes në vend. Nga Kroacia, emigrantët u drejtuan fillimisht në Hungari dhe më pas në Slloveni. Situata u stabilizua në nëntor, pasi emigrantët merrnin trenin pa pagesë për në Šid, Serbi, i cili i çonte ata direkt në ĚRTC në Slavonski Brod. Një distancë prej 120 kilometrash, udhëtimi zgjat rreth 2 dhe 3 orë. Me një fluks ditor mesatar prej 1,700 refugjatësh, periudhat e regjistrimit në përgjithësi zgjasnin deri në 3 orë. Qendra mund të strehojë emigrantë për periudha 24-48 orë. Nga Slavonski Brod, emigrantët u dërguan në Sibir, ku morën trena ose autobusë pa pagesë për udhëtimin prej 230 kilometrash (4-6 orë) në Dobovë ose Mursko Središće (të dy në Slloveni).⁵⁵

Debati politik

Në të njëjtën kohë me fillimin e krizës, Kroacia po përgatitej për zgjedhjet parlamentare në nëntor të vitit 2015. Qeveria e Social Demokratëve, e kryesuar nga kryeministri i atëhershëm Zoran Milanović, e inkadroi krizën brenda nevojës për një qasje humane dhe duke mbrojtur gjithashtu interesat e sigurisë kombëtare të vendit. Ministri i Brendshëm Ostojić udhëtoi rregullisht në terren në vjeshtë dhe

⁵⁵ IOM Weekly Flows Compilation Report Nr. 4. E disponueshme tek: <http://doe.iom.int/docs/WEEKLY%20Flows%20Compilation%20No4%204%20Feb%202016.pdf>

dimër të vitit 2015, duke mbikëqyrur situatën dhe informoi gazetarët dhe zyrtarët e huaj çdo ditë.

Me afrimin e zgjedhjeve, qeveria duhet të tregonte se ishte në gjendje të kontrollonte krizën; çdo dështim mund të shfrytëzohej lehtësisht nga opozita. Çështja e migracionit filloi të dominonte shpejt agjendën politike dhe u trajtua si më poshtë: Kroacia do të bënte pjesën e saj, do të kontribuonte në tranzitimin e rregullt dhe human të emigrantëve në të gjithë territorin e saj, por nuk do të lejonte që vendi të bëhej një parajsë për emigrantët, një perspektivë të cilës i druhej dhe u kritikua fuqishëm nga opozita. Ndryshe nga parlamenti, Presidenti Grabar-Kitarović, foli kryesisht për sa i përket shqetësimeve të sigurisë të krijuara nga fluksi i madh i emigrantëve në vend. Ai vazhdimisht bëri thirrje për përdorimin e ushtrisë për të mbrojtur kufijtë e vendit, propozim ky që u refuzua në mënyrë të përsëritur nga Kryeministri.⁵⁶

Prioritet i Kroacisë ishte organizimi i tranzitit të qetë të emigrantëve në të gjithë territorin e saj. Ishte e para që organizoi transportin e financuar nga shteti. Me anë të kësaj, qeveria donte të tregonte se Kroacia kishte si përgjegjësinë edhe kapacitetin për të ndihmuar refugjatët, që të mund t'i siguronte personave ushqim, strehim të përkohshëm dhe ndihmë mjekësore.

Megjithatë, në të vërtetë u kuptua që transportimi pa pagesë i refugjatëve do t'u linte atyre pak mundësi për të t'u larguar nga qendrat e pritjes. Me përjashtim të atyre që jetonin pranë këtyre qendrave, kishte pak kontakt midis qytetarëve dhe refugjatëve. Kështu, për shumicën e kroatëve, refugjatët ishin të dukshëm vetëm në televizion dhe media të tjera. Opozita e kritikoi ashpër qeverinë duke pretenduar për dështimin e saj për gjetjen e një marrëveshje me Slloveninë dhe Hungarinë fqinje, e cila dëmtoi marrëdhëniet dhe pengoi mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët.

Në fund, qeveria e Milanović-it i humbi zgjedhjet; megjithatë, ndjenja e përgjithshme ishte se rezultati i zgjedhjeve nuk u vendos nga kriza e

⁵⁶ Debati vazhdoi edhe pas zgjedhjeve. Në mars 2016 qeveria e re konservatore propozoi ndryshime në Ligjin për Mbrojtjen duke hapur një mundësi për vendosjen e ushtrisë në kufi dhe përdorimin e saj në situata të tjera emergjente. Opozita dhe aktivistët kritikuan ashpër projekt propozimet.

refugjatëve. Qeveria e re e koalicionit, e udhëhequr nga kryeministri Orešković, mbajti një diskutim të ngjashëm të përgjegjësisë dhe humanizmit në trajtimin e krizës së refugjatëve; megjithatë, ka qenë më e zëshme në lidhje me nevojën që Kroacia të mbrojë në radhë të parë veten, një mesazh ky në linjë me atë të Zyrës së Presidentit.

Media

Në përgjithësi, mediat kroate iu përgjigjën pozitivisht refugjatëve dhe emigrantëve. Pothuajse çdo ditë, gazetatat dhe televizionet raportonin hollësisht për refugjatët, për fatkeqësinë dhe përvojat e tyre përgjatë rrugës drejt Evropës. Gjithashtu, mediat u fokusuan nga rrëfimet rreth mënyrës se si u trajtuan refugjatët në Kroaci, me ndjenja që iu rikthyen përvojave të shumë kroatëve në vitet 1990. Pas sulmeve terroriste në Paris në nëntor 2015, dhe raportimeve për ngacmime nga emigrantët në Këln në prag të Vitit të Ri, disa media filluan të theksojnë shqetësimet për sigurinë që solli përmytja e refugjatëve. Megjithatë, ka pasur një përpjekje të qartë për të treguar se jo të gjithë emigrantët janë terroristë dhe ngacmues seksualë. Megjithatë, në përgjithësi, është ulur toni i përgjithshëm pozitiv që karakterizoi ditët e para të krizës.

Shoqëria civile

Një sërë OJQ-sh lokale kanë qenë aktive në ndihmë të refugjatëve para se të mbërrinin në Kroaci. Donacionet u grumbulluan për refugjatët në Serbi dhe Maqedoni. Këto përpjekje u rritën sapo hynë në Kroaci. Qytetarët prireshin të tregonin solidaritet duke ofruar ushqime, veshje, batanije dhe gjëra të tjera të nevojshme. Disa u ofruan që të transportonin refugjatët pa pagesë për në kufirin slloven përpara se qeveria të marrte kontrollin e plotë të transportit të tyre. Qendra për Studimet e Paqes, së bashku me një numër organizatash qytetare, filloi Nismën Mirësevini!, një platformë advokuese, si dhe një rrjet për të dhënë informacion dhe ndihmë për refugjatët dhe vullnetarët. Informacioni është dhënë në

gjuhën kroate, angleze, gjermane dhe arabe dhe përditësohej rregullisht.⁵⁷

Organizatat e shoqërisë civile i paralajmëruan kroatët dhe refugjatët për shkelje të ndryshme të të drejtave të njeriut që mund të ndodhnin përgjatë rrugës. Për më tepër, ata sollën në vëmendjen vendimet arbitrare për emigrantët që u lejuan të vazhdonin udhëtimin dhe ata që u rikthyen në Kroaci. Gjithashtu, ata theksuan shkeljen e të drejtave ndaj jo-sirianëve, afganëve dhe irakianëve. Ata paralajmëruan më tej për shkeljet që kishin ndodhur rregullisht kundër të burgosurve në Slavonski Brod, për të cilët u mor vendimi për të lënë zonën ekonomike evropiane. Në fund, ata trajtuan çështjen e fatit ende të padekluaruar të atyre që u bllokuan në Slavonski Brod pas mbylljes së rrugëtimit.⁵⁸ Në mars të vitit 2016, kur u njoftuan ndryshimet për Ligjin për Mbrojtjen, Nisma Mirësevini! Qendra për Paqe, Jo Dhunës dhe të Drejtat e Njeriut në Osijek, Miramida dhe organizata të tjera protestuan nën sloganin: “Ndaloni luftën, e jo njerëzit që ikin nga lufta.”⁵⁹

⁵⁷ Për të mësuar më shumë rreth Nismës Mirësevini! vizitoni:

<http://welcome.cms.hr/index.php/en/about/>

⁵⁸ Are You Serious, Welcome Initiative. ‘Report on Systemic Human Rights Violations by the Croatian Authorities in the Closed Parts of the Winter and Transit Reception Centre in Slavonski Brod. Available at:

http://cms.hr/system/article_document/doc/261/Report_on_Systemic_Human_Rights_Violations_in_the_Winter_Reception_and_Transit_Centre_in_Slavonski_Brod.pdf; Report on Systemic Police Violence and Push-Backs against non-SIA People Conducted by Croatian Authorities. E disponueshme tek: http://cms.hr/system/article_document/doc/242/Report-Police-Violence-and-Push-Backs.pdf

⁵⁹ Për më shumë vizitoni: <http://welcome.cms.hr/index.php/en/2016/03/03/due-to-announcement-on-amending-the-law-on-state-border-control-stop-the-wars-not-the-people-who-are-fleeing-wars/>

Slovenia



Të dhënat e përgjithshme

Kur Hungaria mbylli kufirin e saj me Kroacinë, fluksi masiv i emigrantëve u ri-drejtua në Slloveni. Ministria e Punëve të Brendshme filloi regjistrimin e emigrantëve më 16 tetor dhe deri në fund të vitit 2015 janë regjistruar mbi 378,000 persona tranzitë.⁶⁰ Parlamenti Evropian deklaroi se deri në mes të janarit 2016 rreth 408,000 persona kaluan përmes Sllovenisë.⁶¹ Ashtu si vendet e tjera përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor, pak refugjatë e shihnin Slloveninë si diçka më shumë se një qendër tranziti. Që nga shtatori i vitit 2015, vetëm 144 persona kanë aplikuar për azil.

Në ditët e para të krizës, ka pasur mospërputhje të mëdha ndërmjet numrit të mbërritjeve dhe daljeve nga vendi. Policia sllovene shpjegoi se nuk mbahen të dhëna për numrin e emigrantëve që largohen për në Austri; disa u larguan nga qendrat e tyre, dhe ata që ishin në tranzit në

⁶⁰ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016

⁶¹ Velina Lylianova. Briefing January 2016. European Parliamentary Research Service. PE 573.949

qendra në kohën e mbledhjes së të dhënave, nuk u shtuan në këto të dhëna.⁶²

Kuadri Ligjor

Më 20 tetor 2015, Qeveria e Sllovenisë miratoi ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen, i cili përcaktoi detyra të reja për forcat e armatosura sllovene në kushte të përcaktuara saktësisht.⁶³ Ligji u miratua nga Parlamenti të nesërmen përmes një votimi 66:5. Ai i lejoi Forcat e Armatosura të angazhohen në mbrojtjen e kufirit shtetëror përmes dhënies së autoritetit për të kufizuar lëvizjen e emigrantëve deri në mbërritjen e policisë si dhe të menaxhimit të turmës. Këto mund të kryhen në zonën kufitare në mënyrë të pavarur dhe pa praninë e policisë, por në përputhje me planet e policisë.⁶⁴

Qeveria argumentoi se ndryshimi u miratua në kontekstin e hyrjes masive përmes kufirit slloven në ditët e mëparshme, si një masë parandaluese. Më 19 tetor 8.000 emigrantë hynë në Slloveni dhe vetëm 2.000 u larguan për në Austri. Në mes të nëntorit, kur kriza e migracionit po arrinte kulmin në Slloveni, sindikata e policisë nisi një grevë, duke kërkuar rritje pagash dhe përfitime të tjera.⁶⁵

⁶² Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë. E disponueshme tek: <http://www.policija.si/eng/index.php/component/content/article/13-news/1753-police-work-during-the-intensified-security-situationcaused-by-the-escalating-migrant-crisis-in-recent-weeks-explanations-and-answers>

⁶³ Deklaratë për shtyp, Qeveria e Republikës së Sllovenisë. E disponueshme tek: http://www.vlada.si/en/media_room/government_press_releases/press_release/article/government_adopts_urgent_measures_to_control_and_limit_the_migration_influx_56590/

⁶⁴ Deklaratë për shtyp, Qeveria e Republikës së Sllovenisë. E disponueshme tek: http://www.vlada.si/en/media_room/government_press_releases/press_release/article/government_adopts_urgent_measures_to_control_and_limit_the_migration_influx_56590/

⁶⁵ STA. Police start general strike. The Slovenia Times. 18 nëntor, 2015, <http://www.sloveniatimes.com/police-start-general-strike>

Kryeministri Cerar i kritikoi sindikatat si të papërgjegjshme; domethënë se ata zgjodhën të organizonin një grevë në një kohë kur tensionet ishin tepër të larta në të gjithë Evropën dhe kishte një frikë të dukshme se një grevë e policisë mund të pasqyronte negativisht situatën e përgjithshme të sigurisë në vend, veçanërisht në kufijtë e saj.⁶⁶ Ligjet ekzistuese që rregullojnë policinë kufizojnë aktivitetet e grevës dhe detyrojnë oficerët e policisë që të kryejnë të gjitha detyrat urgjente të sigurisë. Greva vazhdoi edhe në muajt e ardhshëm, pavarësisht nga pamundësia për gjetur zgjidhje me qeverinë; megjithatë, duhet theksuar se kjo nuk pati efekt të menjëhershëm në situatën e sigurisë të krijuar nga kriza e refugjatëve.

Kohështirja

Emigrantët filluan të hyjnë në Slloveni pasi Hungaria mbylli kufirin e saj me Serbinë dhe e gjithë rruga e Ballkanit Perëndimor u ridrejtua përmes Kroacisë. Megjithatë, në dy javët e para të krizës, Kroacia i drejtoi emigrantët përsëri në Hungari. Hyrja masive në Slloveni filloi vetëm pasi Hungaria ngriti një rrethim përgjatë kufirit të saj kroat, në momentin që Sllovenia i referohet si ‘vala e dytë e migrimit’. Trafiku i udhëtarëve të trenave me Kroacinë u pezullua një ditë më pas. Pas një jave në valën e dytë, Sllovenia kërkoi ndihmë materiale dhe teknike nga bashkësia ndërkombëtare, si në mënyrë bilaterale ashtu edhe përmes Mekanizmit të Mbrotjes Civile të Bashkimit Evropian.⁶⁷ Duke e pasur të pamundur përballjen me hyrjen e vazhdueshme të personave, Sllovenia filloi ndërtimin e një rrjeti teli në kufirin me Kroacinë më 11 nëntor 2015.⁶⁸ Ky vendim acaroi më tej marrëdhëniet tashmë të tensionuara midis dy

⁶⁶ Marija Novak. Slovenia says police strike won't affect security. Reuters. 18 nëntor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.reuters.com/article/us-slovenia-strike-idUSKCN0T719820151118>

⁶⁷ Government of the Republic of Slovenia. Report on the activities related to the acceptance of migrants from 15.10.2015 deri më 8.12.2015. E disponueshme tek: http://www.vlada.si/fileadmin/dokumenti/si/sklepi/seje_vlade_gradiva/VRS-migrant2-3_20.68mnz.pdf

⁶⁸ Reuters. Slovenia starts building fence to control flow of refugees. 11 nëntor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.theguardian.com/world/2015/nov/11/slovenia-fence-refugees-veliki-obrez>

vendeve. Kroacia pretendonte se rrethimi i Sllovenisë ishte ngritur pjesërisht në territorin kroat, duke rindezur mosmarrëveshjen e gjatë dhe të ndjeshme të kufirit midis dy vendeve.

Me kalimin e kohës, me uljen fluksit të hyrjeve, marrëdhëniet u përmirësuan. Më 27 nëntor, Austria filloi të vendoste pengesa fizike përgjatë kufirit të saj me Slloveninë. Në fund të nëntorit, vendet përgjatë rrugës filluan të kufizojnë numrin e emigrantëve që hynin në territorin e tyre duke lejuar kalimin vetëm të sirianëve, irakianëve dhe afganëve.

Regjistrimi

Gjatë fazës fillestare të krizës janë përdorur pika hyrëse të shumëfishta; megjithatë, që nga nëntori i vitit 2015, hyrja dhe regjistrimi u organizua rreth një pike të vetme në Dobovë, ku emigrantët u ndihmuan nga Administrata për Mbrojtjen Civile dhe Ndihmën ndaj Fatkeqësive. Procesi i regjistrimit përfshinte një ekzaminim të sigurisë dhe një procedurë identifikimi. Nëse një emigrant kishte një dokument, të dhënat hidheshin në regjistrat zyrtarë të policisë. Në rastet e mungesës së dokumentacionit, të dhënat e regjistruara u bazuan në atë që u tha nga emigranti.

Emigrantët u verifikuan përmes të dhënave të policisë, që përfshin verifikimin nga Sistemi Informativ i Shengenit. Më pas, emigrantët u fotografuan, dhe ata me moshë mbi gjashtëmbëdhjetë vjeç iu morën gjurmët e gishtërinjve. Në rastet kur shumë emigrantë hynin në të njëjtën kohë, u aplikua një procedurë e thjeshtëzuar regjistrimi; informacioni u grumbullua manualisht dhe më pas hyri në sistemin kompjuterik pa fotografi dhe gjurmë të gishtërinjve.⁶⁹ Pas regjistrimit, emigrantëve iu dha leja për të qëndruar në përputhje me Ligjin për të huajt.⁷⁰

⁶⁹ Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë. E disponueshme tek: <http://www.policija.si/eng/index.php/component/content/article/13-news/1753-police-work-during-the-intensified-security-situationcaused-by-the-escalating-migrant-crisis-in-recent-weeks-explanations-and-answers>

⁷⁰ Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë. E disponueshme tek: <http://www.policija.si/eng/index.php/component/content/article/13-news/1753-police-work-during-the-intensified-security-situationcaused-by-the-escalating-migrant-crisis-in-recent-weeks-explanations-and-answers>

Akomodimi

Në javët e para të krizës, emigrantët u transportuan nga policia në autobusë në qendra të ndryshme pritëse në vend (Brežice, Dobova, Livarna dhe Gruškovje). Që nga tetori, të gjitha trenat që mbërritën në Slloveni në Rigonce u drejtuan në Jesenice ose Šentilj përgjatë kufirit austriak. Nëse numri i të ardhurve ishte më i lartë se kapacitetet e sistemit dhe regjistrimi nuk mund të bëhej në Dobovë, emigrantët do të transportoheshin në objektet e tranzitit në Gruškovje, Gornja Radgona ose Šentilj për regjistrim dhe marrjen e shërbimeve, kryesisht kujdesit mjekësor, përpara nisjes për në Austri.⁷¹ Aktualisht, Sllovenia mund të strehojë 7,000 persona për periudha të shkurtra dhe 2,000 persona për periudha më të gjata.⁷² Në qendrat e regjistrimit, lëvizja nuk është e kufizuar në përgjithësi dhe emigrantëve u sigurohet një kujdes i përgjithshëm, domethënë ushqim, veshmbathje dhe kujdes mjekësor. Forcat e Armatosura të Sllovenisë përgatisnin dhe gatuanin ushqimin e përditshëm, dhe paketa ushqimore shtesë shpërndaheshin nga organizatat humanitare.⁷³

Kryqi i Kuq ishte përgjegjës për dhënien e ndihmës për ribashkimin e familjeve.⁷⁴ Qendrat shëndetësore nga rajonet më të afërta me qendrat e pritjes ishin përgjegjëse për ofrimin e trajtimit mjekësor. Qendrat e akomodimit përfshinin parkun e kampit në ish-vendkalimin kufitar Šentilj, hapësirat në Gornja Radgona, kampin në ish-parkimin e Lendava, Panairin e Çelikut, kazermat e mbyllura më 26 tetor në Vrhnikë, objektin Logatec dhe Qendrën për të Huajt në Postojna.

⁷¹ UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016

⁷² UNHCR. Regional Refugee and Migrant Response Plan for Europe: Eastern Mediterranean and Western Balkans Route. Janar – Dhjetor 2016

⁷³ Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë. E disponueshme tek: <http://www.policija.si/eng/index.php/component/content/article/13-news/1753-police-work-during-the-intensified-security-situation-caused-by-the-escalating-migrant-crisis-in-recent-weeks-explanations-and-answers>

⁷⁴ Qeveria e Republikës së Sllovenisë. Broshurë për emigrantët. E disponueshme tek: http://www.vlada.si/fileadmin/dokumenti/si/projekti/2015/begunci/dokumenti/letak_begunci_ANG_ARAB.pdf

Rruga e ndjekur nga emigrantët

Emigrantët hynë në Dobova me tren ose autobus nga Slavonski Brod, Kroaci, ku u vendos një strukturë e përkohshme regjistrimi. Koha mesatare e regjistrimit (nga fundi i shkurtit deri në fillim të marsit) ishte gjashtë orë. Transporti, siç u tha më sipër, ishte i lirë dhe zgjaste rreth 4-5 orë. Me të mbërritur në Dobovë, emigrantët drejtoheshin direkt në zonën e pritjes, ku regjistroheshin dhe pajiseshin me ndihmën e nevojshme. Që nga fundi i tetorit, emigrantët merrnin një tren të dytë pas procesit të regjistrimit, i cili i çonte ata në qendrat e përkohshme të akomodimit.⁷⁵ Nga tetori, të gjithë trenat që hynin në Slloveni në Rigonce largoheshin nga vendi në Jesenice ose Šentilj përgjatë rrugës për në Austri në Spielfeld ose Villach.⁷⁶ Edhe këtu përsëri, transporti ishte i lirë.

Debatimi politik

Në ndryshim nga Serbia dhe Kroacia, politikanët sllovenë u përqendruan kryesisht në dimensionin e sigurisë dhe çështjet organizative që lidhen me migracionin. Gjithashtu, dhe përkundër diskutimit në Maqedoni, çështja e migracionit nuk u injorua, por ishte në krye të agjendës ditore edhe para se vala e parë e emigrantëve të mbërrinte në Slloveni. Diskursi u përqendrua në kërcënimin ndaj Sllovenisë nëse Austria dhe Gjermania zgjedhin të mbyllnin kufijtë e tyre, gjë që do të kishte lënë mijëra emigrantë të bllokuar në Slloveni.

Për një vend të vogël prej vetëm dy milionë banorësh, Sllovenia kishte frikë të pranonte një barrë jo proporcionale. Për më tepër, si anëtar i Zonës së Shengenit, Sllovenia vazhdimisht u kujtoi të tjerëve të respektojnë rregullat e Shengenit dhe të vendosin kontrollin e cilësisë

⁷⁵ Nacional. Novi sustav registracija migranata u Sloveniji – Ljubljana hvali suradnju s Hrvatskom. E disponueshme tek: <http://www.nacional.hr/novi-sustav-registracija-migranata-u-sloveniji-ljubljana-hvali-suradnjus-hrvatskom/>

⁷⁶ Deklaratë për Shtyp, Ministria e Brendshme e Republikës së Sllovenisë, 28 tetor 2015. E disponueshme tek http://www.mnz.gov.si/en/media_room/news/article/12137/9459/bac18c8edd426dd5b83f194734a6655c/

përgjatë kufijve të tyre. Ajo kritikoi Kroacinë që veproi pa u konsultuar dhe duke injoruar kërkesat e Sllovenisë për vendosjen e një kuote ditore të hyrjes së refugjatëve. Sllovenët pohuan se Kroacia thjesht i “hodhi” refugjatët në kufirin slloven.⁷⁷ Sllovenia kërkoi një maksimum prej 2,500 refugjatësh në ditë që të kalonin në vend, ndërsa Kroacia propozoi 5,000.⁷⁸ Ndërsa valët e emigrantëve vazhduan të shtoheshin, Sllovenia miratoi masa që lejonin ushtrinë e saj për t’u vendosur në kufi,⁷⁹ njoftoi se do të angazhonte kompani private të sigurisë për të ndihmuar në menaxhimin e fluksit të refugjatëve,⁸⁰ dhe kërkoi asistencë nga BE.⁸¹

Duke u përballur me atë që konsiderohej si një situatë e pakontrollueshme që nuk mund të menaxhohej më, Kryeministri Cerar, me një ton dramatik, nisi një takim urgjent më 25 tetor 2015, duke cituar atë, “Nëse sot nuk gjejmë një zgjidhje, nëse nuk bëjmë gjithçka që mundemi sot, atëherë është fundi i Bashkimit Evropian si i tillë.”⁸²

⁷⁷ Kryeministri slloven Cerar shpjegoi se tensioni në kufirin slloveno- kroat rezultoi nga numri i lartë i refugjatëve të cilët Sllovenia nuk mundej t’i pranonte. 19 tetor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.jutarnji.hr/dramaticna-situacija-s-izbjeglicama--kako-dalje--slovenija- -prestala-prihvacati-izbjeglice--tisuće-pred--granicama--pale-deke-dase- ugriju/1440773/>

⁷⁸ Jess McHugh. Refugee Crisis Europe Update 2015: Balkans Route Continues To Narrow in Slovenia. International Business Times. 18 tetor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.ibtimes.com/refugeecrisis- europe-update-2015-balkans-route-continues-narrow-slovenia- 2145555>

⁷⁹ AFP. Refugee crisis: Slovenia calls in army to help patrol borders. 21 tetor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.theguardian.com/ world/2015/oct/21/slovenia-calls-in-army-refugee-crisis-borders-europe>

⁸⁰ Reuters. Slovenia to hire private security firms to manage migrants flows. 26 tetor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.theguardian.com/ world/2015/oct/26/slovenia-private-security-firms-manage-migrantflows- refugees>

⁸¹ Deutsche Welle. Slovenia asks for EU help to tackle refugee crisis. 22 tetor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.dw.com/en/slovenia-asksfor- eu-help-to-tackle-refugee-crisis/a-18798930>

⁸² Reuters. Slovenia Prime Minister Warns Refugee Crisis Could Tear Apart European Union. 25 tetor, 2015. E disponueshme tek: <http://www.newsweek.com/slovenia-premier-refugee-crisis-threatens-eu-387122>

Media

Ashtu si politikanët, mediat sllovene u përqendruan kryesisht në dimensionin e sigurisë të krizës së migracionit. Një numër i madh raportesh tregojnë se emigrantët mund të jenë një kërcënim i madh për stabilitetin dhe prosperitetin e një vendi të vogël si Sllovenia. Gjithashtu, mediat kanë diskutuar mbi sfidat, kostot dhe rezultatet e paqarta të integritimit të emigrantëve në shoqërinë evropiane. Një autor e cilësoi raportimin e medias si: “gjuha raciste e urrejtjes (e cila përhapet në diskursin publik duke çuar në një gjendje ku mbizotëron paranoja”).⁸³ Paralelisht me diskutimin mediatik mbi lejimin e qindra mijëra refugjatëve në Evropë, shumë prej tyre theksuan nevojën për të gjetur një zgjidhje të përbashkët evropiane, ku Sllovenia mund të jetë një aktor konstruktiv dhe të marrë përsipër pjesën që i takon.

Shoqëria Civile

Njësoj si në vendet e tjera përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor, OJQ-të në Slloveni u organizuan shpejt dhe shpërndanë punonjës në këtë fushë. Ata krijuan një faqe në Facebook, “Refugjatë, Mirësevini në Slloveni” me informacion për refugjatët dhe vullnetarët.⁸⁴ Donacionet u mbledhën dhe u mbështetën aktivitetet e advokimit. Instituti i Paqes në Lubjanë, një institucion i rëndësishëm për çështjet e migracionit, vazhdon të jetë një pikë qendrore për informacionin lidhur me migracionin. Jo vetëm që informacioni i shpërndahet refugjatëve dhe sllovenëve, por institucioni shqyrton edhe diskursin mbi racizmin, populizmin dhe diskriminimin.⁸⁵

⁸³ Klemen Ploštajner. Long Sceptical of Foreigners, Slovenia Struggles to Navigate the Refugee Crisis. Open Society Foundations. 18 dhjetor, 2015. E disponueshme tek: <https://www.opensocietyfoundations.org/voices/long-skeptical-foreigners-slovenia-struggles-navigate-refugee-crisis>

⁸⁴ Shiko tek: <https://www.facebook.com/refugees.slovenia/>

⁸⁵ Për më shumë kontrolllo: <http://www.mirovni-institut.si/en/about-the-peace-institute/>

Marrëdhëniet ndërmjet vendeve të BP

Megjithëse çdo vend përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor u prek individualisht, kriza e refugjatëve ndikoi në mënyrë dramatike në marrëdhëniet mes tyre. Fillimisht, kriza zgjoi frikën se mungesa e bashkëpunimit do të shkaktonte tashmë marrëdhënie të pasigurta midis fqinjëve. Rajoni, në tërësi, vazhdon të luftojë me trashëgiminë e viteve 1990. Për më tepër, ka një mungesë të përbashkët besimi për një sërë çështjesh të hapura bilaterale, si dhe sfidat që lidhen me zhvillimin e brendshëm ekonomik dhe përmirësimin e standardeve demokratike.

Ndër të katër vendet, Sllovenia është anëtare e zonës Shengen, si Sllovenia dhe Kroacia janë vende anëtare të BE, ndërsa Serbia dhe Maqedonia janë vende candidate për në BE. Kjo pabarazi e statusit ka patur ndikim në hartimin e politikave. Megjithë këto dallime, faktori më i rëndësishëm që ndikoi në marrëdhëniet e tyre ishte afërsia gjeografike me krizën. Shkurtimisht, të gjithë ishin në të njëjtën situatë: qindra mijëra refugjatë po kalonin territoret e tyre për në Evropën Perëndimore. Asnjë numër me relevancë statistikore i refugjatëve nuk kishte për qëllim të qëndronte në ndonjë prej territoreve të tyre, BE ose jo, dhe asnjë nga këto vende nuk dëshironte që emigrantët të qëndronin.

Ky fakt që të gjithë ishin thjesht një pikë tranziti përgjatë një rruge shumë më të gjatë, krijoi një ndjenjë mirëkuptimi të përbashkët. Kjo, megjithatë, nuk e ndryshoi faktin se (në fillim) ka pasur akuza ndërkufitare, interpretime të ndryshme, kritika dhe mosbesim. Secili prej tyre ka pasur frikë nga skenari më i keq: mbyllja e kufijve të Gjermanisë dhe Austrisë që do t'i linte atyre barrën e kujdesit për qindra mijëra refugjatë. Maqedonia, si pika hyrëse e itinerarit të Ballkanit Perëndimor, u ankua se nuk ishte në kushtet që të kujdesej për kërkesat e politikës së BE-së, veçanërisht pasi anëtarësimi maqedonas në BE është bllokuar prej vitesh. Qeveria e VMRO-DPMNE-së, duke luftuar betejën e saj të brendshme për mbijetesë politike, pragmatikisht e përdori pozitën e Maqedonisë në krizën e migracionit për të gjeneruar asistencë financiare dhe politike nga BE.

Më tej, një sërë kritikash akuzuan BE-në se po shqetësohej më shumë për stabilitetin sesa demokracinë.⁸⁶ Në anën tjetër të gardhit, Greqia kritikoi mbylljen e kufijve, veçanërisht ato të fundit që ndodhën më 9 mars 2016, të cilat e vendosën atë në pozitë të vështirë për t'u kujdesur për dhjetëra mijëra emigrantë në kushte mjaft të papërshtatshme. Në një episod tjetër, ministri grek i emigracionit i referohej Maqedonisë me emrin “Maqedoni”, në vend të FYROM, gjë e cila krijoi trazirë të madhe në Greqi; një anëtar i koalicionit qeverisës madje bëri thirrje për dorëheqjen e tij për këtë gafë.⁸⁷ Greqia dhe Gjermania, në një akt të rrallë uniteti, kritikuan planet për të frenuar fluksin e emigracionit.

Në fund, kur vendimi u mor më 24 shkurt në Vjenë nga Austria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor për të mbyllur kufijtë e tyre; Greqia nuk u ftua.⁸⁸ E zemëruar, Greqia tërhoqi ambasadorin e saj nga Vjena të nesërmen dhe kërcënoi të bllokonte vendimet e Këshillit të BE nëse shtetet anëtare nuk lejohen të marrin pjesë proporcionalisht në zhvendosjen dhe rivendosjen e refugjatëve.⁸⁹

Austria në mënyrë dramatike e konsideroi krizën e refugjatëve si një sfidë e drejtpërdrejtë për mbijetesën e BE-së, ndërsa Greqia u fokusua në kritikën e padrejta ndaj të rolit të saj në vijën e parë për përballimin e krizës. Në mungesë të një zgjidhjeje evropiane, vendet përgjatë rrugës së BP, së bashku me Austrinë, vendosën të mbyllnin kufijtë e tyre. Duke ndikuar politikisht Ballkanin Perëndimor, Austria mbajti një takim ku u

⁸⁶ Edit Herzog. Europe can't afford to be blackmailed by Macedonia. Politico. 21 March 2016, <http://www.politico.eu/article/europe-blackmailed-macedonia-refugee-crisis-balkan-route-greece/>

⁸⁷ Reuters. Greek migration minister urged to resign over 'Macedonia' blunder. 16 March 2016, <http://www.reuters.com/article/usgreece-minister-macedonia-idUSKCN0WIOZY>

⁸⁸ Nikolaj Nielsen. Austria plans Western Balkan meeting on migrant caps. EU Observer. 22 February 2016, <https://euobserver.com/migration/132377>

⁸⁹ Helena Smith and Ian Traynor. Greece recalls ambassador from Austria over EU refugees flow. The Guardian. 25 February 2016, <http://www.theguardian.com/world/2016/feb/25/greece-wont-belebanon-of-europe-yannis-mouzalas-refugees-eu>

miratua një deklaratë e përbashkët mbi një qasje gjithëpërfshirëse.⁹⁰ Austri dhe të tjerët hodhën poshtë kritikën gjermane mbi këtë rishikim të politikave, duke vënë në dukje se presionet e emigracionit mbi Gjermaninë do të ulëshin gjithashtu.⁹¹

Marrëveshja ndërmjet BE dhe Turqisë e nënshkruar më 18 mars 2016 premtoi për një zgjidhje gjithëpërfshirëse,⁹² megjithëse një sërë politikanësh kanë shprehur rezerva lidhur me zbatimin e saj eventual. Gjithashtu, organizatat për të drejtat e njeriut kanë shprehur shqetësime se masat mbrojtëse për mbrojtjen e azilkërkuesve nuk do të mund të respektohen plotësisht.⁹³ Rivendosja e marrëdhënieve miqësore midis fqinjëve Kroaci dhe Serbi ishte nën presion të vërtetë në ditët e para të krizës.

Ndryshimi i rrugës së emigrimit nga Serbia në Kroaci në shtator 2015 krijoi tensione të reja dhe për herë të parë që nga përfundimi i luftës në vitin 1995, kufiri midis dy vendeve u mbyll. Kroacia fajësoi Serbinë (dhe Hungarinë) për drejtimin e emigrantëve vetëm në Kroaci, pas së cilës Kroacia bllokoi trafikun e mallrave dhe ndaloi hyrjen e të gjitha automjeteve të regjistruara në Serbi. Më pas, Serbia paraqiti kundërmasat që bllokuan hyrjen e të gjitha mallrave kroate. Mediat në të dyja anët e mbuluan gjerësisht situatën.

Tabloidët serbë vinin tituj sensacionalë si: “Kryeministri kroat është një idiot” dhe “Një i çmendur po udhëheq kroatët në luftë”.⁹⁴ Kancelari

⁹⁰ Federal Ministry for Europe, Integration and Foreign Affairs, Republic of Austria. 24 February 2016, <http://www.bmi.gv.at/cms/cs-03documentsbmi/1813.pdf>

⁹¹ Giogos Christidis et al. Refugee Crisis Disunity: A De Facto Solution Takes Shape in the Balkans. Spiegel Online. 26 February 2016, <http://www.spiegel.de/international/europe/european-response-to-refugeecrisis-fracturing-a-1079547.html>

⁹² Press Release. EU and Turkey agree on European response to refugee crisis. European Commission. 19 March 2016, http://ec.europa.eu/news/2016/03/20160319_en.htm

⁹³ Jennifer Rankin. EU-Turkey deal to return refugees from Greece comes into force. The Guardian. 20 March 2016, <http://www.theguardian.com/world/2016/mar/18/refugees-will-be-sent-backacross-aegean-in-eu-turkey-deal>

⁹⁴ N1 TV. September 24, 2015. Available at: <http://hr.n1info.com/a74462/Svijet/Regija/Srpski-tabloidi-Banda-ustaska-Milanovic-je-ludidiot.html>

gjerman paralajmëroi nxitjen e mundshme të një reaksioni zinxhir dhune dhe lufte në Ballkan nëse kriza e refugjatëve nuk menaxhohej mirë.⁹⁵ Megjithatë, kriza e refugjatëve nuk krijoi fërkime vetëm në Ballkanin Perëndimor. E njëjta krizë ka sinjalizuar përçarje të thella brenda BE-së. Tensionet dhe mosbesimi shënuan takimin e Këshillit të BE të marsit 2016, ku u miratua marrëveshja BE-Turqi.

Gjermania, arkitekti kryesor pas planit me Turqinë, shpejt u gjend pa shumë aleatë, pasi një sërë shtetesh anëtare filluan të gravitojnë drejt përgjigjes së Evropës Lindore ndaj krizës së refugjatëve.⁹⁶ Marrëdhëniet janë përmirësuar midis katër vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë disa muajve, veçanërisht pasi filluan të ndajnë informacion, hapën rrugët e komunikimit dhe, në përgjithësi, koordinuan më mirë planet dhe politikat për emigrantët. Megjithatë, tensionet mbetën të larta për sa kohë që një numër i madh i emigrantëve vazhdonin të kalonin tranzit nëpër rajon. Në mars të vitit 2016, ministri i jashtëm maqedonas paralajmëroi se kriza e refugjatëve mund të çonte fqinjët në konflikte të dhunshme.⁹⁷ Mbyllja e kufijve më 9 mars 2016, në pritje të marrëveshjes BE-Turqi,⁹⁸ mund të ketë zbutur përkohësisht fërkime midis fqinjëve; megjithatë, nëse rruga e emigrimit do të rihapet në Ballkanin Perëndimor, po kështu do të ndodhë edhe me plagët historike të rajonit.⁹⁹

⁹⁵ Adam Withnall. Refugee influx could spark 'military conflict' in Balkans, Angela Merkel warns. Independent. November 3, 2015, <http://www.independent.co.uk/news/world/europe/refugee-influx-couldspark-military-conflict-in-balkans-angela-merkel-warns-a6719521.html>

⁹⁶ Spiegel Staff. Alone in Berlin: How Merkel Has Gambled Away Her EU Power. Spiegel Online. 11 March 2016, <http://www.spiegel.de/international/europe/refugee-crisis-policies-have-merkel-on-defensivein-europe-a-1081820.html>

⁹⁷ Blic. March 1, 2016, <http://www.blic.rs/vesti/svet/makedonskiministar-upozorava-zbog-izbeglica-moze-doci-do-sukoba-medususedima/mpcgqrd>

⁹⁸ Stelios Bouras. Balkan Countries Completely Seal Off Migrant Trail as Part of EU Plan. The Wall Street Journal. 9 March 2016, <http://www.wsj.com/articles/macedonia-completely-closes-border-withgreece-to-migrants-1457521754>

⁹⁹ http://rmrp-europe.unhcr.org/2016_RMRP_Europe.pdf

NATO DHE BALLKANI: SFIDAT E ARDHSHEME TË SIGURISË

**Prezantimet e Forumit të Politikave organizuar nga Instituti për
Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Friedrich Ebert
Stiftung Albania, 4 Korrik 2017**

Konteksti

Gjatë Samitit të Lisbonës në vitin 2010, NATO miratoi një Koncept të ri Strategjik, duke u fokusuar në tri detyra kryesore: mbrojtja e përbashkët, menaxhimi i krizave dhe siguria bashkëpunuese. Parimi themelues i NATO-s për mbrojtjen e përbashkët do të thotë që anëtarët e saj do të ndihmojnë gjithmonë njëri-tjetrin në rast sulmimi, në përputhje me nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit. Detyra e menaxhimit të krizës nënkupton përdorimin nga NATO të mjeteve politike dhe ushtarake për të menaxhuar kriza në zhvillim, të cilat kanë potencial të ndikojnë në sigurinë e Aleancës, para se të përshkallëzohen në konflikte. Së fundmi, siguria bashkëpunuese nënkupton angazhimin aktiv të Aleancës në rritjen e sigurisë ndërkombëtare, nëpërmjet partneritetit me vendet përkatëse dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Koncepti gjithashtu thekson se shtetet anëtare të NATO-s formojnë një bashkësi vlerash unike, të përkushtuar ndaj parimeve të lirisë individuale, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Për më tepër, ai thekson rëndësinë strategjike të bashkëpunimit NATO-Rusi si një kontribut që krijon një hapësirë të përbashkët për paqen, stabilitetin dhe sigurinë si dhe në një Bashkim Evropian aktiv dhe me prosperitet i cili kontribuon në sigurinë e përgjithshme të zonës Euro-Atlantike.

Kur shikon përsëri Konceptin Strategjik të vitit 2010, vërehet se ka pasur shumë ndryshime. Rusia është tërhequr nga partneriteti me NATO-n, ndërsa përfshirja e saj në Ukrainë, Ballkan, Siri dhe në Lindjen e Mesme shpesh shihet në kundërshtim me interesat e NATO-s. Rëndësia dhe besueshmëria e BE-së ka rënë si pasojë e krizës financiare, krizës së refugjatëve, rritjes të së djathtës populiste dhe së fundmi Brexit. Në samitin e NATO-s në Bruksel Trump dha sinjalin se SHBA mund të mos

jetë gati të zbatojë nenin 5 të NATO-s, ndërsa Kancelarja e Gjermanisë bëri thirrje për të mos ia besuar më SHBA-së dhe Britanisë sigurinë e Bashkimit Evropian.

Nga pikëpamja e Ballkanit, NATO vazhdon të konsiderohet si garanti kryesor i sigurisë dhe anëtarësimi në NATO është i lidhur me një siguri më të madhe të brendshme dhe rajonale siç rikonfirmohet nga ndikimi i pranimit të Malit të Zi në diskursin e sigurisë të rajonit.

Duke pasur parasysh këto zhvillime globale dhe rajonale, qëllimi i këtij forumi politik ishte që të trajtohen sfidat me të cilat përballlet NATO dhe të ofrojë njohuri të pavarura se cila qasje duhet pasur për trajtimin e tyre. Forumi u nda në tri pjesë duke u përqendruar në sfidat globale me të cilat përballlet NATO, perspektivat e Shqipërisë, sfidat, roli dhe kontributi i saj në NATO, si dhe pasiguritë rajonale dhe ndikimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky Forum Politikash mbledhi përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Jashtme, shoqërisë civile, si dhe akademikë e gazetarë. Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime relevante dhe produktive pas çdo paneli.

Fjala hyrëse dhe panelistët kryesorë

Z. Arjan Dyrmishi, (Ekspert i Lartë, IDM) bëri një prezantim të shkurtër të rendit të ditës dhe preku çështjet kryesore që do të adresoheshin nga forumi i politikave. Më tej, ai prezantoi folësit kryesorë të eventit, Prof. Dr. Wulf Lapins, Përfaqësuesi i FES në Shqipëri dhe ekspertët ndërkombëtarë të sigurisë që do të hidhnin bazat për reflektimet dhe diskutimet.

Z. Lapins hapi fjalimin e tij duke përshëndetur pjesëmarrësit dhe theksoi rëndësinë e këtij forumi në funksion të zhvillimeve të fundit të sigurisë globale dhe rajonale si dhe rolin e NATO-s në këtë kontekst. Ai deklaroi se “fryma e shenjtë” e NATO-s është në ujëra të trazuara. Në kohën e themelimit të NATO-s, misionet e saj ishin të qarta. Synimi ishte të mbante rusët larg Evropës, amerikanët në Evropë dhe gjermanët nën kontroll, siç theksonte dhe sekretari i parë i përgjithshëm Lord Hastings në vitin 1962.

Tani 65 vjet më vonë, mbeten dy shqetësime, deklaroi Z. Lapins. Shqetësimi për vazhdimin e detyrimit të sigurisë së SHBA-së, tani edhe më e theksuar për shkak të presidencës së Trump dhe shqetësimin në disa shtete anëtare të NATO-s rreth politikës së jashtme neo-liberale mashtruese ruse. Për Gjermaninë, nga ana tjetër, ajo është bërë spiranca e stabilitetit në Evropë. Z. Lapins shtoi se Gjermania duhet të bëjë më shumë për sigurinë evropiane, duke u fokusuar në kërkesat e Uashingtonit, si dhe në shtetet baltike. Në të vërtetë, kjo nënkupton që të rritet buxheti i mbrojtjes, por shumica e Gjermanisë do të donte të shpenzonte më tepër para në infrastrukturën sociale sesa në armatim.

Nëse rezultati në zgjedhjet e Bundestagut gjerman në shtator do të krijonte vetëm një koalicion të madh të konservatorëve dhe socialdemokratëve, do të jetë emocionuese se si do të duket marrëveshja e koalicionit lidhur me shpenzimet e mbrojtjes, tha Z. Lapins. Bëhet fjalë për ekuilibrin e duhur që Gjermania, fuqia më e fuqishme ekonomikisht në Evropë, nuk do të jetë edhe forca më e fuqishme ushtarake në Evropë. Për më tepër, Z. Lapins argumentoi se do të ishte kundërproduktive për stabilitetin evropian dhe deri më tani nuk kishte asnjë përgjigje të arsyeshme për pyetjen “për cilat aftësi ushtarake duhet që Gjermania dhe vendet e tjera evropiane të investojnë miliarda euro?”.

Përveç kësaj, Z. Lapins elaboroi tre prej shumë problemeve të pazgjidhura.

Problemi i parë: Në lidhje me zgjerimin e ushtrisë si dhe pajisjet e mëdha luftarake, NATO është qartësisht më i zhvilluar se Rusia. Disa vende të Evropës Jugore nuk i ndajnë këto perceptime kërcënuese. Sa i përket Rusisë, pikëpamjet brenda NATO-s janë të ndryshme - a është Moska ende një partner problematik apo tashmë është një kundërshtar? Më shumë dialog apo më shumë deterencë? Kompromisi është diçka nga të dyja.

Në këtë kontekst, politikanët, diplomatët, vëzhguesit, si dhe komuniteti inteligjent pohojnë se Rusia do të ndjekë axhendën e vet gjeopolitike, e cila është e vështirë të kuptohet në objektivat dhe qëllimet e saj. Kjo është arsyeja pse, në këtë mënyrë, Rusia do të jetë një aktor në Evropë për një kohë të gjatë dhe një arsye shqetësimi dhe kompleksiteti. Në këtë kontekst, shqetësimi i kërcënimit është rritur në kryeqytetet e NATO-s të cilat shohin një paparashikueshmëri të presidentit Trump. A janë

anëtarët evropianë të vetëm në shtëpinë evropiane? Në filmin e famshëm “I vetëm në shtëpi”, Kevin është i zgjuar, dinak dhe dredharak. Por a janë këto cilësi të mjaftueshme për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetërimeve në Evropë?

Problemi i dytë: 28 nga 29 shtetet anëtare të NATO-s janë pjesë e koalicionit anti-ISIS, por NATO si organizatë nuk është pjesë e këtij koalicioni. Samiti i NATO-s në Bruksel vendosi që NATO të merrte pjesë në aleancën ndërkombëtare kundër Shtetit terrorist Islamik. Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg me këtë nënkuptonte më shumë se thjesht një hap simbolik. Aleanca do jetë tani në gjendje të shërbejë si një platformë koordinuese për luftën ndaj ISIS. Por ekziston rreziku që NATO të ngecet në luftën kundër ISIS.

Problemi i tretë: ambicia e Turqisë për t’u bërë një fuqi e fortë dhe e pavarur rajonale. Përveç kësaj, mbrojtja turko-gjermane. Slogani i NATO-s është ‘një bashkësi vlerash’. Duke u përballur me shkeljet strukturore të njerëzve dhe të drejtave civile në Turqi, theksi i komunitetit po shndërrohet thjesht në një frazë.

Në sfondin e këtyre çështjeve, a duhet që evropianët të marrin më shumë përgjegjësi dhe fatin e sigurisë në duart e tyre? Në të njëjtën kohë, do të na duhet të heqim pak dorë nga sovraniteti për më shumë bashkëpunim. Nevojitet që të hiqet dorë edhe nga doktrinat dhe vendimet kombëtare, por vullneti për ta bërë këtë ekziston vetëm në tituj, tha z. Lapins. Duke kujtuar një prej këngëve më të famshme të Bob Dylan, e cila titullohet “The Times They Are a-Changin’”, zoti Lapins thotë se për një politikë dhe diplomaci racionale, titulli nuk është i përshtatshëm, por është një parim udhërrëfyes i perspektivës.

Z. Lapins përfundoi fjalimin e tij duke theksuar se forumi do të flasë rreth sigurive të humbura, paqartësitë e ardhshme dhe parimet dhe perspektivat e politikës së sigurisë. Do të jetë një dialog midis ekspertëve shqiptarë dhe gjermanë. Në këtë drejtim, Gjermania ka ofruar dy ekspertë të sigurisë dhe ekspertizës së sigurisë, Dr. Detlef Puhl, i cili deri në pensionimin e tij vitin e kaluar ishte këshilltar për komunikimin strategjik të asistentit të sekretarit të përgjithshëm për sfidat e reja të sigurisë dhe gjeneral brigade në pension Helmut Ganser.

SESIONI I – Luftimi i kërcënimeve dhe paqartësive globale duke adresuar sfidat me të cilat NATO përballlet nga brenda

Moderator: Arjan Dyrmishi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Panelistë: BG (R) Helmut Ganser – Ekspert i Lartë i Sigurisë, Dr Detlef Puhl – Ekspert i Lartë i Sigurisë

Z. Ganser mbuloi temat e luftimit të kërcënimeve dhe paqartësive globale të sigurisë duke adresuar sfidat me të cilat NATO përballlet nga brenda. Fjalimi i tij ishte i ndarë në pesë pika kryesore të NATO-s të cilat ishin: 1) Kuptimi i NATO-s, që është një organizatë ndërqeveritare për mbrojtjen kolektive në bazë të vlerave të përbashkëta. Ka një paqartësi nëse ajo është një organizatë politike apo ushtarake, dhe ne mendojmë se ajo është politike, tha Z. Ganser.

NATO ka edhe një proces vendimmarrës shumëpalësh dhe konsensual, 2) Për sa i përket Mjedisit të Ardhshëm të Sigurisë së NATO-s, ai argumentoi se ka një rëndësi në rritje të mbrojtjes së përbashkët për shkak të veprimeve të Rusisë, si dhe një ulje e rëndësisë së menaxhimit të krizave, 3) Kohezioni Transatlantik dhe ndarja e barrës, Z. Ganser argumentoi se kohezioni i saj është rrezikuar (nga Turqia) dhe ndarja e barrës transatlantike ku SHBA shpenzon 604.5 miliardë dollarë, dhe për më tepër në shumë shtete anëtare është dhe problemi i normës 2%, por për kohezionin transatlantik ai vë në dukje garancitë e sigurisë së SHBA si të domosdoshme për Evropën dhe ideologjia “Amerika e Para” nuk mund të neglizhojë interesat e mëdha gjeopolitike dhe ekonomike të SHBA-së në Evropë. 4) duhet gjithashtu të ketë një qasje gjithëpërfshirëse për sigurinë, domethënë të zhvillohen politika tregtare dhe ndërhyrje të ardhshme ushtarake; dhe 5) rolet dhe mundësitë e shteteve jo aq të mëdha në NATO, ku Z. Ganser shtoi se duhet të ketë një përdorim të zgjuar të rregullit të konsensusit në komitetet e NATO-s, iniciativa inteligjente në organet e NATO-s, staf të mirë arsimuar dhe të trajnuar në ministritë relevante - personelin e përgjithshëm - strukturat e komandës së NATO-s etj., dhe së fundmi, të ofrojnë aftësi / ekspertë të rëndësishëm specialë për NATO-n

Ai theksoi qasjen 360° të NATO-s për sfidat e saj në lindje, jug dhe ato kibernetike. Qasja Gjithëpërfshirëse, siç theksoi ai, u krijua zyrtarisht në vitin 2006 gjatë Këshillit të NATO-s, sidoqoftë, pritet akoma për zbatimin serioz të tij. Në fund, ai sugjeroi që politikanët nuk duhet të harrojnë përfundimin e fortë të politikës së sigurisë.

Z. Puhl u përqendrua në temën “Sfidat e Ardhshme të Sigurisë”. Prezantimi i tij u përqendrua më shumë në ngritjen e pyetjeve sesa në dhënien e argumenteve dhe krijimin e tezës. Z. Puhl theksoi se aktualisht terrorizmi ndërkombëtar po na kërcënon, por cila do të jetë lëvizja e ardhshme? A është NATO një bashkësi vlerash; a kemi vlera të brendshme? A është aleanca një mbrojtje ushtarake? A është ende i vlefshëm koncepti strategjik? Si do të merret me sigurinë kibernetike, terrorizmin? A do të përfshihet NATO kryesisht në operacione ushtarake, apo do të jetë një aleancë e kombeve që ndajnë vlera të përbashkëta? Traktati thekson vlerat e brendshme, por a ndajnë udhëheqësit tanë autoritarë e nacionalistë vlerat tona të brendshme?

Aleanca është midis sfidave të Lindjes dhe Jugut, argumentoi Z. Puhl, duke shtuar se gjatë viteve të fundit NATO ka qenë në dy teatro konflikti:

- 1) Sfidat nga Lindja (bota ruse dhe pakicat e saj, lufta hibride, që nga lufta e vitit 2008 në Gjeorgji, ajo po përpiket të krijojë një imazh të fuqishëm të pushtetit dhe shohim edhe një Kaukaz dhe Ukrainë të pasigurt)
- 2) Sfidat nga Jugu (lufta në Irak, Siri, Afganistan, shtetet e dështuara të Afrikës së Veriut, ndërhyrja në Libi, refugjatët, Pranvera Arabe)

Pas paraqitjes së këtyre dy sferave, ai ngriti pyetjen nëse NATO është organizata e duhur për t’u marrë me këto çështje, më tej i kushtoi rëndësi rolit të Turqisë dhe Rusisë, të cilat janë të angazhuara në të dyja teatrot.

Pjesa e fundit e prezantimit të Z. Puhl ishte në lidhje me NATO-n dhe Ballkanin, ku ai parashtroi disa pyetje të ndryshme lidhur me rolin e shteteve të Ballkanit: Si përputhet Ballkani në këtë situatë, a shikojnë ata drejt Perëndimit apo Lindjes, cili është roli i SHBA-së në Ballkan, ku do të jetë Ballkani mbas 10 vjetësh? Në fund të prezantimit të tij Z. Puhl vuri në dukje se Ballkani është beteja e fuqive të mëdha.

SESIONI II – Perspektiva shqiptare mbi rolin dhe kontributin e saj ndaj NATO-s dhe sfidat me të cilat ballafaqohet

Moderator: Redion Qirjazi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Think Tank Fellow)

Panelistë: BG (R) Sander Lleshi – Këshilltar për Sigurinë pranë Kryeministrit, Dastid Koreshi – Drejtori i Departmentit të Politikave të Sigurisë pranë MPJ, Igli Hasani – Drejtorja e Planifikimit Strategjik (NATO, BE dhe Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë)

Gjeneral Brigade Sander Lleshi hapi panelin e trete duke theksuar se që nga dita e anëtarësimit në NATO, siguria kombëtare e Shqipërisë përballet me të njëjtat sfida, rreziqe e kërcënime si dhe gjithë Aleanca. Por krahas sfidave të përbashkëta, vendit i duhet të përgatitet edhe për një kategori tjetër sfidash, kryesisht të karakterit të brendshëm dhe rajonal, ku kërkohet një angazhim disi më specifik se sa ndaj sfidave të përbashkëta të NATO-s.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë, e miratuar në vitin 2014 nga Kuvendi, paraqet një qasje të re të bazuar më shumë në mundësitë, por pa harruar as rreziqet dhe kërcënimet. Ky dokument shënon një përpjekje të re për ta orientuar sigurinë kombëtare të vendit më shumë drejt shfrytëzimit të mundësive që paraqet mjedisi aktual i sigurisë dhe e ardhmja e tij. Kjo qasje është një ndryshim i rëndësishëm në krahasim me qasjet e mëparshme, të cilat kanë synuar kryesisht të gjejnë përgjigjet adekuate për rreziqet dhe kërcënimet e identifikuar.¹

Si vend anëtar në NATO, Shqipëria përballet me të gjithë spektrin e sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve që preokupojnë Aleancën.

“Një hark pasigurie dhe destabiliteti shtrihet përgjatë periferisë së NATO-s e më tej” thuhet në deklaratën e miratuar nga kryetarët e


¹ Ligj nr. 103/2014 datë 31.7.2014 Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Gjendet në:


http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf

shteteve dhe të qeverive në përfundim të Samitit të Varshavës në vitin 2016.

Ky hark i madh i pasigurie dhe destabiliteti shtrihet përgjatë Afrikës Veriore, kalon nëpër Lindjen e Mesme dhe përfundon në vendet Baltike. Valët e terrorizmit e të emigracionit nga Jugu, agresioni rus ndaj Ukrainës dhe sjellja e saj agresive në rajonin e Baltikut janë vetëm disa nga karakteristikat e këtij harku pasigurie.



Krahas rreziqeve dhe kërcënimeve që burojnë nga ky hark i madh, Shqipëria gjendet brenda një harku tjetër më të vogël, të cilin unë po e quaj vetëm sa për sot *“harku i paqartësisë strategjike”*, i cili fillon në FYROM, kalon nëpër Kosovë, Serbi dhe përfundon në Bosnje Hercegovinë. Përgjatë këtij harkut të vogël ndeshet paqartësi e dukshme strategjike, destabilitet si dhe përpjekje të faktorëve të tretë për ta shtuar amullinë strategjike dhe për të minuar aspiratat e integritit evropian popujve të rajonit. Tektonikat e fundit europiane, flukset migratore, tendencat radikale në Evropë, Brexit dhe shumë faktorë të tjerë vetëm sa i kanë nxitur më tej aktorët e interesuar për një Ballkan të destabilizuar dhe jo evropian.



Shqipëria është e interesuar për t'u marrë me problematikën që lidhet me të dy harqet e mësipërme.

Sa i përket harkut të madh, Shqipëria është angazhuar plotësisht në të gjitha masat që NATO ka ndërmarrë në këtë kontekst.

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të këtij angazhimi është pjesëmarrja e gjerë në kuadër të masave të sigurisë dhe të përshtatjes që janë pjesë e Planit të Masave dhe të Gatishmërisë së NATO-s, të miratuar në Samitin e Uellsit në vitin 2014.

Krahas operacioneve tashmë të njohura si në Afganistan, Kosovë, Bosnje, etj., Shqipëria ka shtuar ndjeshëm nivelin e pjesëmarrjes me trupa në stërvitjet e përbashkëta të NATO-s në rajone të ndryshme të Aleancës, është bërë pjesë e misionit të prezencës së përparuar të NATO-s në Lindje (Riga-Letoni, me 18 vetë), ka dërguar një njësi të Forcës Detare (22 vetë) në kuadër të operacionit “Sea Guardian” në Detin Egje etj.

Po ashtu, vendi ynë është u është bashkuar sanksioneve perëndimore kundër sjelljes agresive të Rusisë, ka rritur ndjeshëm kontributin në kuadër të Aleancës kundër të ashtuquajturit Shteti Islamik etj...

Nëse sfidat e mëdha dhe të përbashkëta përballohen në kuadër të një plani të përbashkët të NATO-s, i cili bazohet në Traktatin e Atlantikut dhe në parimin e “pandashmërisë së sigurisë”, ekziston edhe një kategori tjetër sfidash, ndaj të cilave angazhimi i veçantë kombëtar është kërkesë primare, ndërkohë që NATO luan një rol mbështetës.

Më lart përmenda harkun e vogël, “harkun e paqartësisë strategjike”, i cili përbën një sfidë të konsiderueshme për rajonin tonë dhe për vetë Shqipërinë.

Në një kohë kur pjesa adriatike e ish-Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia dhe Mali i Zi) janë bërë pjesë e NATO-s dhe pjesërisht edhe e BE-së, pjesa tjetër ajo “kontinentalja” Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Bosnje Hercegovina janë ende në një gjendje të paqartë strategjike.

Në të gjitha forumet ndërkombëtare, Shqipëria ka shprehur dhe mbrojtur qëndrimin se integrimi i kësaj pjese të Evropës Juglindore në NATO dhe BE është rruga e vetme për ta shtrirë paqen sigurinë dhe prosperitetin në këtë oborr të pasmë të Evropës.

Interesi i Shqipërisë për integrimin evropian të këtyre vendeve është i dorës së parë, edhe për faktin e pranisë së gjerë të popullsisë shqiptare në këto vende.

Me gjithë sinjalet e qarta e të përsëritura të NATO-s drejt një partneriteti me Serbinë, ky vend ende mbetet në një pozitë të dyzuar mes Aleancës Atlantike dhe Rusisë, duke e mbajtur aktive një vatër paqartësie strategjike në fushën e sigurisë, për aq kohë sa raportet mes NATO-s dhe Rusisë mbeten larg normalitetit.

Bosnjë Hercegovina dhe Maqedonia, të prekura nga brishtësia politike, tensionet etnike dhe ndikimi i faktorëve të tretë kundër integritetit euroatlantik, kanë mbetur prej disa vitesh në një gjendje stanjacioni në raport me afrimin ndaj NATO-s dhe BE-së.

Nëse në Serbi, Maqedoni dhe Bosnje Hercegovinë proceset integruese kanë ngecur kryesisht për mungesë të vullnetit politik në këto vende, në Kosovë ndodh e kundërta. Vullneti i qartë politik dhe mbështetja e gjerë publike ndaj integritetit nuk ka gjetur rezonancën e mjaftueshme mes vendeve anëtare të NATO-s apo dhe të BE-së.

Politika e jashtme dhe e sigurisë së Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë dhe përpjekje të shumta integritetit të të gjithë rajonit, me besimin se vetëm përfshirja euroatlantike është formula për të vendosur paqen dhe prosperitetin në këtë rajon që prej shekujsh mbetet në pikëprerjen e interesave të fuqive të jashtme.

Unë mendoj se është e vështirë gjetja e ndonjë formule apo qasjeje të përbashkët euroatlantike ndaj problematikave të ndërlikuara të rajonit. Në vend të një *panacea* do të ishte më e dobishme një qasje e diferencuar.

Në Serbi duhen adresuar sentimentet e vjetra nacionaliste, në Bosnjë duhen trajtuar plagët e rënda të një konflikti të përgjakur, Maqedonia duhet të kthejë heterogjenitetin etnik dhe fetar në motor për integrim, ndërkohë që Kosova duhet që si të tillë të përdorë homogjenitetin e saj, sigurisht pa harruar thirrjen e kushtetutës së vet për shtetin multi-etnik.

Përveç sfidave konvencionale globale apo rajonale, Shqipëria i konsideron si posaçërisht të rëndësishme sfidat e reja, si ekstremizmi i dhunshëm, terrorizmi, lufta hibride dhe ajo kibernetike.

Ekstremizmi i dhunshëm është një fenomen që ka njohur një përmasë shqetësuese në rajon, kryesisht gjatë dekadës së fundit. Vetëm në konfliktin në Siri dhe Irak janë përfshirë rreth 950 luftëtarë të huaj nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.²

Ky numër shqetësues është rezultat i një procesi të gjatë radikalizimi dhe ekstremizmi që është zhvilluar në rajon kryesisht pas viteve 90-të të shekullit të kaluar.

Në përgjigje të këtij kërcënimi, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.³ Ekstremizmi i dhunshëm konsiderohet si një kërcënim serioz për sigurinë dhe për zhvillimin e vendit. Për përballimin e tij, strategjia parashikon një angazhim të gjerë institucional dhe shoqëror, i cili synon zbatimin e një sërë masash në fushën e arsimimit dhe edukimit, të besimeve fetare, të mbështetjes dhe përkujdesjes sociale, të policimit komunitar etj..

Qëllimi i këtyre masave është krijimi i një mjedisi jo pranues për të gjitha llojet e ideologjive radikale dhe ekstreme, imunizimi i shoqërisë ndaj tyre, mbështetja e personave të rrezikuar nga ekstremizmi si dhe

² Between salvation and terror: radicalization and the foreign fighter phenomenon in the Western Balkans, Edited by Vlado Azinović, Sarajevo 2017, faqe 10.

³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 18.11.2015 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit".

Gjendet në:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf

kundërvënia aktive ndaj përpjekjeve për të mbjellë ekstremizëm dhe përçarje në shoqërinë shqiptare.

Rishikimi i legjislacionit dhe masat e tjera të marra kanë rezultuar edhe në disa goditje të suksesshme ndaj individëve apo grupeve të përfshira në veprimtari ekstremiste dhe terroriste. Dënimi i një rrjeti të rrezikshëm ekstremistësh, që rekrutnin luftëtarë të huaj për konfliktin në Siri dhe Irak në maj të vitit 2016, ishte një tjetër rezultat i qasjes së re ndaj këtij fenomeni.

Në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm Shqipëria planifikon një përpjekje të shtuar edhe në kontekstin rajonal, për shkak të rolit të veçantë që ajo mund të luajë në këtë kontekst. Ndërtimi i një qendre rajonale kundër ekstremizmit të dhunshëm mbetet një mundësi e hapur.

Terrorizmi

Si një vend i lirë dhe demokratik, anëtar në NATO dhe që aspirojnë integritetin në BE, Shqipëria është një vend i ekspozuar ndaj përpjekjeve të organizatave dhe grupeve terroriste për të goditur. Shfaqjet e ekstremizmit të dhunshëm gjatë viteve të fundit vetëm sa e kanë bërë më të qartë rrezikun terrorist për vendin tonë.

Angazhimi serioz i strukturave të sigurisë ka bërë të mundur parandalimin e disa rasteve ku vendi mund të ishte goditur nga terrorizmi. Rasti më i njohur është parandalimi i një sulmi të koordinuar terrorist që kishte si objektiv ndeshjen e futbollit mes Shqipërisë dhe Izraelit, e cila u zhvillua në Elbasan më 12 nëntor 2016.

Shqipëria i është bashkuar koalicionit global kundër ISIL (*Global Coalition to Counter the Islamic State of Iraq and the Levant (ISIL)*) dhe në kuadër të tij ka dhënë kontribute të rëndësishme. Me shumë rëndësi ka qenë mbështetja logjistike, kryesisht me armatim dhe municion për forcat e koalicionit.

Suksesi në përpjekjet e ardhshme për përballimin e terrorizmit varet shumë edhe nga epërsia në inteligjencë. Në fushën e inteligjencës vendet e vogla si Shqipëria kanë mundësi për të dhënë kontribute thelbësore, të

cilat nuk janë domosdoshmërisht funksione lineare të përmasave të ekonomisë, të burimeve të tjera a po të dispozitivëve ushtarakë të vendit. Në këtë fushë vendet e vogla kanë mundësi të japin shumë. Shqipëria e ka bërë me sukses këtë gjë në të kaluarën dhe planifikon që ta bëjë edhe me më shumë sukses në të ardhmen.

Lufta hibride

E paralajmëruar shumë kohë më përpara, lufta hibride mori trajtë konkrete gjatë agresionit rus kundër Krimesë dhe në konfliktin në Ukrainën Lindore.⁴

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë e ka njohur rrezikun potencial që mund të vijë nga përdorimi i metodave të kësaj lufte kundër vendeve tona fqinje apo dhe kundër vetë Shqipërisë.

Ndonëse për NATO-n ky rrezik është i njohur dhe i parashikuar, përgjegjësia për marrjen e masave përkatëse mbetet kryesisht një detyrim kombëtar, ndërkohë që NATO-s i mbetet një rol mbështetës.⁵

Evidenca tregon që përpjekje për të krijuar mundësi për aplikimin e formave të luftës hibride janë ndërmarrë dhe ndërmerren edhe në rajonin tonë nga aktorë që ndjekin agjenda të caktuara.

Përballimi i kësaj lufte përbën një sfidë krejt të veçantë, e cila kërkon jo vetëm ndryshime rrënjësore politike, strategjike dhe doktrinarë, por edhe një krijimin e kapaciteteve të reja, që përgjithësisht nuk kanë ekzistuar më parë.

⁴ Shih për më tepër: M. Galeotti, "The 'Gerasimov Doctrine' and Russian Nonlinear Warfare," July 6, 2014. Gjetet në:
<https://inmoscoësshadoës.eordpress.com/2014/07/06/the-gerasimov-doctrine-and-russian-non-linear-war/>

⁵ Shih për më tepër: Warsaw Summit Communiqué Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Warsaw 8-9 July 2016, Paragrafi 72.
Gjetet në:
http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_133169.htm

Në këtë fushë të re kërkohet që shumëçka të bëhet rishtazi. Sidomos me rëndësi jetike është krijimi i kapaciteve të reja operacionale, të cilat do të shënojnë kalimin nga kapacitetet konvencionale tek ato hibride.

Lufta kibernetike

Ashtu si lufta hibride edhe ajo kibernetike paraqet një sfidë të re dhe shumë të rëndësishme, ku shumëçka duhet krijuar nga e para. Edhe në këtë fushë, krahas masave që merren në kuadër të Aleancës, shtetet anëtare janë të detyruara të ndërmarrin vetë një sërë masash mbrojtëse.

Shqipëria është një vend veçanërisht i ekspozuar ndaj rreziqeve që lidhen me hapësirën kibernetike dhe për rrjedhojë, edhe nevoja për krijimin e kapaciteteve të nevojshme në këtë fushë është shumë e madhe.

Si një vend me një ritëm shumë të lartë të penetrimit të internetit e të rrjeteve sociale si dhe me një tendencë të lartë për shërbimet online, vendi ynë ka nevojë për një “shqisë” të re në fushën e sigurisë kibernetike dhe të kapaciteteve të mbrojtjes.

Miratimi së fundmi i ligjit për Sigurinë Kibernetike shpreh në thelb këtë nevojë dhe krijon hapësirat për adresimin e saj në të ardhmen.⁶

Buxheti i Mbrojtjes

Ashtu si dhe vendet e tjera të NATO-s, në Samitin e Uellsit të vitit 2014, Shqipëria ka marrë angazhimin për rritjen progresive të buxhetit të mbrojtjes me synimin që në vitin 2024 ai të arrijë nivelin 2% të PBB.

Plotësimi i këtij angazhimi konsiderohet jo thjesht e vetëm si plotësimi i një angazhimi në kuadër të NATO-s, por edhe si një ndërmarrje e rëndësishme për modernizmin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit në përgjigje të sfidave të reja ndaj sigurisë kombëtare.

Megjithatë, plotësimi i këtij objektivi në rastin e Shqipërisë paraqet një sfidë shumë serioze. Nëse në vendet e Bashkimit European buxheti i

⁶ http://www.akce.gov.al/wp-content/uploads/2016/04/Ligji%20Per_Sigurine_Kibernetike_Nr_2_Date_26.1.2017.pdf

përgjithshëm i shtetit është sa rreth 46,6% të PBB⁷, në Shqipëri Buxheti i Shtetit është sa rreth 27% e PBB.

Sikundër shihet, shteti shqiptar shpenzon më pak se një të tretën e PBB, ndërkohë që vendet e BE shpenzojnë rreth gjysmën e tij. Në këtë këndvështrim, shpenzimi i 2% të PBB për mbrojtjen në terma krahasimorë është një objektiv shumë ambicioz, i cili është rikonfirmuar edhe në samitin e fundit të NATO-s në Bruksel në maj të këtij viti.

Plotësimi i këtij objektiv synohet të realizohet në kuadër të një qasjeje moderne dhe inovative ndaj sektorit të mbrojtjes. Kjo qasje synon të rrisë dobinë e Forcave të Armatosura ndaj shoqërisë në tërësi, edhe përtej rolit që ato luajnë në operacionet e mirëfillta ushtarake.

Krijimi i kapaciteteve ushtarake me mundësi përdorimi edhe në dobi të sektorëve të tjerë të jetës së vendit si transporti ajror dhe detar, emergjencat civile, shërbimet gjeografike, meteorologjike, hidrografike etj., konsiderohen si fusha ku përdorimi i buxhetit do të plotësojë njëkohësisht si nevoja të FA ashtu dhe të sektorëve të tjerë njëkohësisht.

Përfundime

Edhe pse një vend i ri anëtar në NATO dhe me burime shumë të kufizuara, Shqipëria ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në kuadër të Konceptit Strategjik të Aleancës.

Roli i Shqipërisë për përmirësimin e klimës së përgjithshme në rajon, për stabilitetin dhe për integrimin euroatlantik të tij është me rëndësi të dorës së parë.

Shqipëria sheh mundësi të mëdha për kontribut të spikatur veçanërisht në kuadër të masave të NATO-s kundër ekstremizmit, terrorizmit dhe të luftës hibride, edhe për arsye se në këto fusha ekzistojnë mundësi të shumta për rol të vlefshëm edhe për vendet e vogla.

Shqipëria ka plane për rritjen deri në 2% të PBB të shpenzimeve të mbrojtjes në kundërt të një qasjeje të re, e cila synon zgjerimin e përdorimit të dyfishtë të disa kapaciteteve ushtarake, në përpjekje për të

7

http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/shoë.do?dataset=gov_10a_main&lang=en

ruajtur balancat buxhetore, edhe pse shpenzimet publike të vendit janë shumë herë më pak se mesatarja evropiane.

Fjalimi i z. Koreshi u fokusua në kontributet e Shqipërisë në NATO. Ai filloi duke deklaruar se në të vërtetë fokusi është në luftën hibride dhe jo atë konvencionale, prandaj NATO po përpiqet të rishikojë funksionet e veta. Kontributi shqiptar, pohoi ai, vlerësohet nga NATO, jo vetëm për madhësinë e kontributit të saj, por edhe për angazhimin dhe gatishmërinë e tij. Kontributi shqiptar shihet në kontekstin ballkanik, ku ka ndikime të ndryshme nga Lindja dhe Jugu.

Vendi ynë ofron kontribute në Lindje (kohët e fundit në Letoni), por edhe në anët e tjera si Afganistan, Irak, një kontribut modest por cilësor me një anije ushtarake në Detin Egje, kështu që ne kemi një shtrirje në të dyja anët. Për ta adresuar saktë, z. Koreshi argumentoi se ne duhet të kemi një konsensus mbi rolin e NATO-s. Lidhur me ideologjinë shqiptare në NATO, zoti Koreshi tha se ne kemi një qasje të “dyerve të hapura”, kemi përkrahur integrimin e Malit të Zi dhe përsëri ne besojmë se procesi i anëtarësimit është i paplotë. Ai shtoi se problemet me Turqinë, por edhe ato midis Greqisë dhe Maqedonisë, dhe rasti i Kosovës, kanë pasoja të ndryshme. Ne kemi kërkuar që Kosova të jetë në syrin e NATO-s, tha z. Koreshi dhe shtoi se ne kemi nevojë për një Aleancë praktike sesa një Aleancë parimesh. Z. Koreshi përfundoi fjalimin e tij duke thënë se ka një qasje më të strukturuar të NATO-s në rajon, megjithatë, sipas tij, ajo duhet të zhvillohet më tej sa i përket aftësive mbrojtëse dhe për ne norma 2% nuk duhet të shihet si një shifër matematikore, por si një qasje që një vend ka ndaj Aleancës, megjithëse ne nuk kemi arritur normën 2%, ne renditemi në mes të tabelës së kontribuuesve të NATO-s.

Z. Hasani vuri në dukje se strategjia në të cilën ne bazohemi është ajo që merr në konsideratë ekzistencën e një zone gri midis Maqedonisë, Kosovës, Serbisë dhe Bosnjës, e cila ndikohet nga tre “R” të mëdha (Rusi, Radikalë dhe Refugjatë). Ai theksoi dëshirën e një fqinji të NATO-s për të pasur qasje në Detin Adriatik, si dhe për të pasur ndikim në vendet e Ballkanit.

Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, argumentoi ai, ka një hendek i cili është shfaqur dhe aktualisht është i mbushur me radikalizmin islamik. Bazuar në këto, Ministria e Mbrojtjes ka ndërmarrë hapat e mundshëm, tha z.

Hasani duke vendosur trupa në Afganistan që nga viti 2002, duke dyfishuar trupat e dislokuara në Afganistan në vitin 2016, duke dyfishuar trupat e dislokuara në KFOR. Ai shtoi se ne jemi të pranishëm në veri që prej Samitit të Uellsit dhe ne jemi pjesë e prezencës së forcës së përparuar. Angazhimi ynë për luftimin e terrorizmit është evident dhe në përputhje me nenin 5 për menaxhimin e krizave.

Një anije ushtarake shqiptare është në Detin Egje dhe ne jemi gjithashtu të angazhuar në Koalicionin Global kundër DAESH. Së fundmi, ne po krijojmë Qendrën e Ekselencës për studimin e luftëtarëve të huaj. Sa i përket buxhetit, ai argumentoi se norma 2% nuk është e mjaftueshme, edhe pse disa anëtarë janë krenarë për arritjen e tij, ka pasur një debat mbi deklaratën e Samitit të Uellsit ku thuhet se një anëtar duhet të lëvizë drejt 2%, kështu që disa shtetet argumentojnë se kjo nuk do të thotë ta kesh atë. Z. Hasani përfundoi fjalimin e tij duke thënë se në Aleancë ka kontribute, para dhe aftësi. Që nga viti 2015, 20-21% e personelit ushtarak shqiptar janë të angazhuar në misione ushtarake, trajnime, ushtrime dhe se kjo duhet të shihet si tepër e rëndësishme për një vend si Shqipëria.

SESIONI III – Paqartësitë rajonale dhe ndikimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor

Moderator: Besfort Lamallari, Hulumtues i Pavarur

Panelistë: Prof. Dr. Luan Hajdaraga – ish Ministër i Mbrojtjes, Prof. Dr. Fatos Tarifa – ish Ambasador i Shqipërisë në SHBA dhe Rektori i Universitetit të New York Tiranë, Arben Çejku – ish Ambasador i Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë

Prof. Dr. Hajdaraga argumentoi se një pikë fokusimi për sigurinë duhet të jetë Rusia, pasi sot ne shohim një tërheqje të NATO-s, dhe Rusia ka rikuperuar influencën e saj në Gjeorgji, Moldavi, Armeni, deri në vendet Baltike, a kemi një “perde të re të hekurt”?

Vendet e baltikut, tha zoti Hajdaraga, kanë mbështetjen e NATO-s, Rumania nuk është shumë e qëndrueshme, Bullgaria ka zgjedhur

udhëheqësin që kërkon përmirësimin e marrëdhënieve me Rusinë, dhe Turqia ngelet problematike. Duke folur për rajonin e Ballkanit Perëndimor, Z. Hajdaraga shpjegoi se ky rajon ndodhet në zonën gri dhe ka një problem me elementin e sigurisë, ai shtoi se problemet etnike po ndodhin në çdo shtet, përveç Shqipërisë. Ndërsa lidhur me Serbinë ai përmendi se Presidenti Vuçiç do ta ketë të vështirë të gjejë një ekuilibër mes forcave pro-BE-së dhe atyre pro-ruse.

Rusia mori pjesë indirekte në përpjekjen e grushtit të shtetit në Malin e Zi dhe ka një prani të fortë atje, argumentoi zotin Hajdaraga, ai vazhdoi më tej me Bosnjën, ku tha se aty është Republika Srpska, lideri i së cilës është pro-Rusisë dhe planifikon të veprojë në të njëjtën mënyrë si në Krime. Edhe në Maqedoni, udhëheqësit pro-rusë mbështeten nga Kremli. Si një përgjigje për këtë, argumenton ai, BE mund të ofrojë elementë sigurie edhe në Ballkan. Që nga axhenda e Selanikut e vitit 2003, asnjë shtet i Ballkanit Perëndimor nuk ka bërë progres të mjaftueshëm përveç Kroacisë. Procesi i integritetit në BE duhet të përshpejtohet, pasi këto shtete mund të ndihen të lodhura nga pritja dhe fillojnë të kërkojnë alternativa të tjera. Gjermania ka ndihmuar procesin e integritetit përmes Procesit të Berlinit. Ai pretendoi se ka një dilemë Merkel kundër Juncker për përshpejtimin ose ngadalësimin e procesit të integritetit.

Në këtë mjedis të turbullt, Rusia do të kërkonte përfitime të mundshme. Ka parti politike në shtetet e Ballkanit Perëndimor të cilat financohen nga Rusia, prandaj është me rëndësi të thuhet se ekziston një kërcënim potencial rus. Sipas z. Hajdaraga, vendet e Ballkanit Perëndimor do të dalin nga kjo situatë sapo të bashkohen me njëri-tjetrin dhe udhëheqësit e tyre të binden se nuk ka rrugë tjetër për sigurimin e sigurisë përveç BE-së. Z. Hajdaraga personalisht, nuk mendon se ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë rus për Shqipërinë për shkak të arsyeve të mëposhtme: a) nuk kemi lidhje kulturore me Rusinë, nuk ka elemente nostalgjike për Rusinë në Shqipëri, 2) nuk ka investime ruse në Shqipëri dhe c) asnjë parti politike shqiptare nuk ka në programin e saj përmirësimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Rusia nuk është shumë e interesuar për Shqipërinë, dhe nga ana tjetër, Shqipëria nuk ka qenë e gatshme për ofertat ruse.

Dr. Tarifa argumentoi se së pari duhet të përmendim se Ballkani nuk ka vetëm gjashtë shtete, dhe nëse shohim në përgjithësi, duhet të pranojmë se në rajon është bërë shumë progres. Duke folur për përparimin e këtij rajoni, Dr. Tarifa argumentoi se Sllovenia ishte vendi i parë i ish-Jugosllavisë që u bashkua me BE-në, dhe është gjithashtu anëtare e NATO-s, Bullgaria dhe Rumania edhe pse me një proces më të ngadalshëm iu bashkuan NATO-s në vitin 2004 dhe BE-së në vitin 2007 dhe megjithatë ato ende kanë defiçite demokratike, Rumania shihet shpesh si Polonia e Ballkanit, Kroacia ishte vendi i katërt ballkanik që u bashkua me BE-në dhe vendi i dytë i ish Jugosllavisë që u bashkua me NATO-n. Serbia është “vëllai armik” i Kroacisë, por epoka pas Milosheviçit po lëviz drejt demokratizimit, dhe me shumë mundësi do të jetë anëtar i 28-të i BE-së.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet serbe me NATO-n janë më komplekse. Shumica e popullit serb janë pro-rusë, argumenton Dr. Tarifa duke shtuar se një problem tjetër për Serbinë është refuzimi i saj për të njohur Kosovën. Lidhur me Malin e Zi, ai argumentoi se ky vend ka bërë shumë mirë drejt integritimit në BE. Në Bosnje, marrëveshjet e paqes të Dejtonit në vitin 1995 kanë pasur rezultate të suksesshme. Maqedonia ishte e vetmja republikë që u bë e pavarur paqësisht, megjithatë, problemi i emrit me Greqinë është i rëndësishëm; ishte kjo arsyeja pse Maqedonia nuk mund të bashkohej me NATO-n në vitin 2009. Ekziston edhe dhuna ndëretnike. Në të ardhmen Maqedonia mund të bëhet Belgjika e Ballkanit. Shqipëria u bashkua me NATO-n në vitin 2009, zgjedhjet e fundit ishin më të mirat në 26 vjet demokraci. Kosova ka përpjekje institucionale për të funksionuar si një demokraci. Jeta e saj politike është e një trendi të ndryshëm. Ka gjithashtu një problem me radikalizmin e të rinjve.

Pjesa e dytë e fjalimit të tij ka të bëjë me vlerësimin e stabilitetit, ku ai u tregua mjaft optimist, pasi përparimi në rajon është pozitiv dhe i qëndrueshëm, megjithatë ai theksoi se Ballkani nuk është ashtu siç duam të jetë, megjithatë është në rrugën e duhur. Në Ballkan, ne kemi qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, katër vende anëtare të BE, gjashtë anëtarë të NATO-s dhe një frymë bashkëpunimi mes këtyre vendeve, tha Dr. Tarifa. Gjatë fjalëve përmbyllëse, ai argumentoi se ne e kuptojmë se të gjitha problemet aktuale nuk do të zgjidhen së shpejti, BP nuk duhet

të jetë jashtë rrjedhës së BE-së, për më tepër ai duhet të mbetet prioriteti kryesor dhe barra e së kaluarës nuk është më e rëndë se premtimet e së ardhmes, këto vende ende nuk janë mision i përfunduar.

Panelisti i fundit, Z. Arben Çejku ndau perspektivën e tij mbi ndikimin e paqartësive rajonale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai argumentoi se nga historia botërore dhe ajo ballkanike kemi mësuar se Siguria, Paqja dhe Stabiliteti nuk janë status që jepet një herë e përgjithmonë dhe mbetet i pandryshueshëm. Nga ky leksion, brenda të cilit ka dhjetëra histori dramatike të kombeve e shteteve të ndryshme, buron nevoja aktuale e vlerësimit të të gjithë elementëve aktualë dhe perspektivë të paqes dhe sigurisë në rajonin tonë, në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

Në planin vertikal, kjo pjesë e Evropës që jetonte nën diktaturën komuniste (diku më të ashpër e diku më liberale), me përmbysjen e strukturës së vjetër të sigurisë, kaloi nga një sistem izolacionist dhe diktatorial, në një stad të ri të organizimit demokratik dhe euro-integruar. P.sh, kalimi i Shqipërisë nga diktatura në demokraci, u pasua me ndryshimin e strukturës dhe konceptit të saj të sigurisë; u kalua nga një monostrukturë sigurie (vetëizolimi dhe investimi galopant për mbrojtjen) në një koncept sigurie më të gjerë dhe të ndërlidhur – përfshirja në Nismën e Partneritetit për Paqe në kuadër të NATO-s. Vende të tjera, kryesisht të ish-Jugosllavisë, patën një rrugëtim më dramatik derisa kanë mbërritur në stadin e një sigurie rajonale dhe evropiane të integruar në kuadrin e NATO-s dhe nismave të saj.

Në rrafshin horizontal, kjo përmbysje e strukturës së vjetër të sigurisë në rajon, shkaktoi një ndryshim radikal të hartës së rajonit tonë, në raport me atë që ishte rreth 30 vjet më parë. Një numër i madh shtetesh të reja, nuk është vetëm një tregues sasior, por mbi të gjitha përmbajtësor. Pas çdo shteti të ri të Ballkanit Perëndimor, ka një histori unike. Të gjithë këto së bashku, përbëjnë një sagë të jashtëzakonshme të historisë moderne të rajonit tonë.

Kjo hartë e re shtetesh, nënkupton përmbajtjen e fakteve të dhimbshme të përmbysjes dhe krijimit të ekuilibrave të rinj të sigurisë, paqes dhe stabilitetit. Përmbysja e ekuilibrave të brendshëm të sigurisë, të stabilitetit dhe të paqes, u pasua me lëvizje të vullshme dhe të dhunshme, me konflikte ndër-etnike dhe pjesërisht fetare (Bosnja-Hercegovina), spastrime etnike, masakra ndaj civilëve, djegie dhe

shkatërrim të institucioneve të kulturës dhe religjionit si dhe rikthim tek koncepte dhe retorika të luftërave të mëhershme ballkanike.

Pra, shembja e sistemeve të vjetra të sigurisë, nuk kaloi pa dhimbje dhe pa gjak, sidomos brenda kufijve të ish-Jugosllavisë.

Nëse në Shqipëri, Bullgari, Rumani, Hungari etj, kalimi vertikal nga forma moniste dhe komuniste e organizimit të shtetit në sistem pluralist dhe demokraci u krye nëpërmjet lëvizjesh civile dhe demonstratash, ky hap drejt demokracisë, në pjesën tjetër të rajonit, pra, (Ish-Jugosllavi) degradoi në konflikte civile dhe etnike. Në fillim të viteve '90 askush nuk e parashikonte dot se në këtë pjesë të rajonit tonë do të kishim shpërthimin e konflikteve ndër-etnike, zinxhiri i të cilave u përmbyll me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit në gusht 2001. Nga Marrëveshja e Dejtonit e nëntorit 1995 deri në atë të Ohrit, u zhvilluan një seri tragjesh, por falë ndërhyrjes amerikane dhe NATO-s më pas në Kosovë, kjo pjesë e rajonit fitoi paqen.

Çdo alternativë tjetër, përpos atyre që u nënshkruan ne Dejton, në Rambuje dhe në Ohër, do të ishte një ofertë shkatërruese për rajonin tonë. Qysh atëherë ka pasur tendenca për ndërhyrje të faktorëve të tjerë në zgjidhjen e konflikteve në mënyrën e tyre. Në Bosnje ishin të ashtuquajturat brigada vullnetare dhe xhihadiste që vinin nga vendet arabe gjoja në ndihmë të “vëllezërve myslimanë boshnjakë” dhe për disa kohë tentuan t'i japin konfliktit përmasat e një ballafaqimi fetar apo të një lufte të shenjtë. Por SHBA, BE dhe NATO arritën ta shuajnë këtë konflikt dhe sot, pavarësisht se nuk ka progres të mjaftueshëm në funksionimin unitar të federatës serbo-boshnjake, gjithsesi, paqja ka qenë funksionale.

Rusia donte të ndërhynte në Kosovë dhe në Maqedoni, por ajo nuk e arriti dot. Mirëpo ajo është rikthyer sot, duke u përpjekur të jetë prezente në tensionet e brendshme që hera herës vihen re në rajonin tonë. Z. Çejku deklaroi se me këtë kishte parasysh zhvillimet regresive në Maqedoni siç ishte incidenti në Kumanovë apo trazirat politike në Shkup.

Sot, tha ai, ne jemi në fazën kur në rajonin tonë është vendosur paqja, dhe stabiliteti me dialogun udhëheqin zgjidhjen e të gjitha pasojave të konflikteve që sapo u përmendën. Në planin e sigurisë, ka zhvillime akoma më pozitive, pas anëtarësimit të Malit të Zi në NATO. Me

anëtarësimin e kësaj republike në NATO, është përmbyllur siguria e vijës detare të Adriatikut dhe njëkohësisht është vendosur një portë e madhe përballë presionit rus në Ballkan.

Mirëpo, pavarësisht historive të suksesit që çdo shtet ballkanik mund të tregojë sot, qëndrojnë akoma faktorë dhe elementë që e rrezikojnë atë çfarë është arritur në drejtim të demokracisë, sigurisë dhe paqes në rajonin tonë. Aspirata për ndërtimin e shoqërive demokratike dhe për integrim euro-atlantik, ka ndihmuar në krijimin e një hapësirë të gjerë bashkëpunimi mes shteteve tona, përfshi edhe ato në rrafshin e sigurisë, por kjo ende nuk mjafton përballë sfidave që kemi ne si rajon.

Rajoni ynë, pra Ballkanit Perëndimor, është gjithnjë i rrethuar nga valë presioni dhe rryma interesash të jashtme që kërcënojnë stabilitetin tonë afatgjatë. Këtu mund të përmenden disa, siç janë;

- Deformimet e demokracisë së brendshme në vendet në tranzicion,
- Rritja e radikalizmit fetar dhe ndikimi i shteteve islamike nga Lindja e Mesme,
- Efektet e krizës së brendshme politike në Turqi dhe tendenca e saj për promovimin e erdoganizmit si model politik për shtetet e tjera në rajonin e arab apo edhe në Ballkan. Tendencia është për zgjidhje të problemeve të brendshme bazuar në traditën e demokracive tradicionale të vendeve (siç promovon edhe Rusia) duke lënë jashtë influencat perëndimore.
- Tensionet e hapura dhe të fshehta në brezin e sigurisë së NATO-s që nis nga Baltiku deri në Qipro, ku pika më e nxehtë duket Polonia.
- Ngecja e dialogut në çështje të mbartura nga e kaluara e afërt, siç është status quo-ja e problemit të emrit mes Greqisë e Maqedonisë, zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara mes Beogradit e Prishtinës, demarkacioni i Kosovës me Malin e Zi etj.
- Rritja e buxhetit të organizatave kriminale rajonale, kryesisht rrjetit të trafikut të drogës dhe prodhimit të saj. Kultivimi i

hashashit në Shqipëri është një rekord tepër negativ me rrezikshmëri për sigurinë.

- Rikthimi i retorikave nacionaliste në momente dëshpërimi nga elitat problematike në disa vende të rajonit.
- Përpjekjet e Rusisë për depërtim në rajonin e Ballkanit Perëndimor me të gjitha format dhe mjetet, duke përfshirë edhe investimet dhe tregtinë.
- Shtimi i investimeve strategjike kineze në disa vende të Ballkanit, përfshi Shqipërinë.

Deformimi i demokracisë nëpërmjet tolerancës që i bëhet korrupsionit, paligjshmërisë, pandëshkueshmërisë, krimit të organizuar, trafikëve të drogës dhe llojeve të tjera, krijimit të monopoleve, krijimit të kulturës së mospërfaqësimit, drejtësisë së politizuar, nepotizmit dhe politizimit të administratës publike, mungesës së investimeve publike dhe shtimi i papunësisë, dëmtimi i sistemit arsimor dhe goditja e sistemit të konkurrueshmërisë, marginalizimi i zonave rurale dhe urbane; këto dhe të tjera, kanë krijuar një perceptim të gabuar shoqëror mbi vlerat e demokracisë. Ky është dëmi më i madh që udhëheqës politikë të korruptuar, lidershipe të papërgjegjshme, forca politike pa vizion, i kanë bërë dhe po i bëjnë jo vetëm demokracisë në vendet e tyre, por po cenojnë edhe sigurinë e rajonit. Është dobësia e institucioneve të këtyre shteteve që krijon hapësira të mjaftueshme për depërtimin e rrymave të interesave të tjera përtej rajonale, qofshin ato nga Rusia apo nga lindja e mesme dhe e largët.

Elitat e korruptuara dhe ato që synojnë ta kthejnë demokracinë në monopol të interesave partiake dhe personale, kanë shkaktuar probleme madhore jo thjesht për funksionimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, por edhe për sigurinë e tyre të brendshme, me efekt në sigurinë e rajonit. Z. Çejku solli shembullin e Maqedonisë, ku pas një kalvari të gjatë problemesh të brendshme me zgjedhjet, në fund, arriti të rikthehet në normalitet demokratik.

Pak javë më parë, ne e kemi parë dhunën në rrugët dhe brenda parlamentit të Maqedonisë, tha ai, duke shtuar se ky konfrontim politik, kjo krizë partiake dhe politike, për pak desh u kthye në një krizë ndër-etnike dhe konflikt ndëretnik. Oligarkët e rinj të tranzicionit në Ballkan,

përfshi edhe ato të Maqedonisë, shpesh vënë interesat e tyre para interesave të vendit, dhe, për një mandat më shumë, për një karrige më shumë, vëmë re se ata flirtojnë me segmente dhe rryma jodemokratike jashtë rajonit tonë, larg hartës euro-atlantike.

Shoqëritë tona duhet të jenë gjithnjë vigjilente, sepse herë pas here mund të ketë aventurierë që provokojnë stabilitetin për hir të pushtetit. Nuk ka qenë pa faj edhe BE, kur në disa raste, për hir të stabilitetit, ka bërë kompromis me standardin e demokracisë në vendet tona, duke filluar me pranimin e zgjedhjeve problematike dhe duke vazhduar me bashkëpunimin me lidershipe të korrupsuara dhe me lidhje kriminale. Sot, kur reforma e drejtësisë është bërë kryefjalë e rajonit tonë, siguria jonë ka marrë një element shtesë.

Tek deformimet dhe dobësitë që shfaqin demokracitë e vendeve tona, gjen argumentet e saj propaganda e rrjeteve të radikalizmit fetar, por edhe ato të propagandës ruse. IDM, psh ka bërë studime mbi shkaqet e radikalizmit fetar në Shqipëri dhe është vënë re se në zonat rurale dhe suburbane, ka pasur më shumë terren për radikalizëm sesa në qytete. Aty ku dora e shtetit ka qenë larg, aty ka ardhur dora e një kujdesi tjetër. Ndaj Z. Çejku theksoi se një nga garancitë e sigurisë sonë rajonale është vazhdimi i reformave demokratike dhe procesit të integritit euro-atlantik. Unë mendoj se rajoni ynë nuk rrezikon ndonjë sulm nga jashtë, në formën klasike që njihen ndërhyrjet, por më shumë ai rrezikohet nga krizat tona të brendshme.

KRIZA E EMIGRANTËVE: KATALIZATOR PËR ZGJERIMIN E BE-SË?

Natasha Wunsch dhe Nikola Dimitrov

Përmbledhje ekzekutive

Kur çenohet kufiri i jashtëm i BE-së dhe zona Shengen, kufijtë e shteteve të Ballkanit Perëndimor shndërrohen në evropianë. Kur këto shtete mbeten pas fqinjëve të tyre evropianë në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe standardeve demokratike, qytetarët e tyre emigrojnë. Fatkeqësisht, reagimi politik për të dyja dimensionet e krizës së emigrantëve në Ballkan deri më tani është përqendruar kryesisht në kontrollin dhe parandalimin.

Edhe më e rëndë, ka pasur shenja të kompromisit për stabilitetin mbi demokracinë, për të pasur liderë të fortë që mund të përballeshin me krizën e emigrantëve. Përkundrazi, rikthimi i procesit të zgjerimit, duke përdorur mjetet ekzistuese dhe ndikimin e BE-së në mënyrë efektive, do të rriste kapacitetet e vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u përballur me goditjet e jashtme si dhe do të bëheshin më tërheqës edhe për vetë qytetarët e tyre. Megjithatë, një ndryshim i tillë në qasje kërkon zëvendësimin e mënyrës së tanishme të pilotit automatik në një një shofer politik për procesin e anëtarësimit.

Hyrje

Për një moment të shkurtër, kriza e refugjatëve e ktheu përsëri Ballkanin Perëndimor në hartën politike të Evropës, duke nënvizuar rëndësinë strategjike të rajonit për stabilitetin dhe sigurinë e BE-së. Agjencia Evropiane e kufirit FRONTEX regjistroi rreth 800,000 kalime të parregullta në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2015, nga vetëm 43,000

në vitin 2014.⁸ Pas mbylljes së rrugës ballkanike më 8 mars 2016, numri i të ardhurve ka rënë në mënyrë drastike. Vendimi i Austrisë për të kufizuar numrin e emigrantëve që hynë në territorin e saj, në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të tjera të vendosura përgjatë rrugës së tranzitit, rezultoi me mbylljen e kufirit të Maqedonisë me Greqinë. Që kur u ndërmor ky hap, UNHCR nuk ka regjistruar qoftë edhe një ardhje të vetme në Maqedoni, Kroaci, ose Slloveni, dhe vetëm dhjetra për çdo ditë në Serbi nëpërmjet kufirit tokësor me Bullgarinë.

Ndonëse shqetësimet fillestare u përqendruan në potencialin shkatërrues të bllokimit të emigrantëve në anën e kufirit grek, marrëveshja BE-Turqi që hyri në fuqi më 20 mars, e zhvendosi si barrën kryesore në krizën e emigrantëve dhe vëmendjen politike ndaj Turqisë. Nga ky moment, edhe politikanët e opinionistët janë fokusuar tek fakti nëse vendimi “për t’i dhënë fund emigracionit të parregullt nga Turqia në BE” do të ndalonte përfundimisht emigracionin përmes detit Egje.⁹

Ndërkohë, vetë rajoni i Ballkanit Perëndimor doli në plan të dytë. Duke e parë krizën e vazhdueshme të emigrantëve përmes një kuadri më të gjerë të politikës së zgjerimit të BE-së, ky dokument politikash shfrytëzon kufizimin aktual të refugjatëve si një rast për të reflektuar mbi zhvillimet gjatë vitit të kaluar dhe mësimet për angazhimin e BE-së me vendet kandidate (potenciale) të saj. Ky dokument fokusohet në veçanti në Ballkanin Perëndimor, i cili për një moment të shkurtër u gjend në qendër të vëmendjes të krizës së refugjatëve dhe nuk nxiti më tej mendimin strategjik se si të stabilizohen përfundimisht vendet e rajonit, të sigurojnë transformimin e tyre të qëndrueshëm demokratik dhe të ndihmojnë në zhvillimin e tyre ekonomik.

Ky dokument politikash trajton dy dimensionet e krizës së emigracionit në Ballkan, duke argumentuar se në të dyja rastet, përgjigja e BE-së është

⁸ Frontex, “Western Balkan Route,” e disponueshme tek <http://frontex.europa.eu/trendsand-routes/western-balkan-route/>.

⁹ EU-Turkey statement, 18 Mars 2016, e disponueshme tek <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2016/03/18-eu-turkey-statement/>. For an excellent analysis, see Kerem Oktem, “Zombie politics: Europe, Turkey and the disposable human”, openDemocracy, 19 Mars 2016, e disponueshme tek <https://www.opendemocracy.net/kerem-oktem/zombie-politics-europe-turkey-and-disposable-human>.

përqendruar në luftimin e simptomave, në vend që të zhvillojë zgjidhje më afatgjata. Përveç kësaj, perceptimi i nevojës për udhëheqës të fortë që të përballen me situatën ka rritur prirjen për të zgjedhur interesat gjeopolitike dhe stabilitetin në vend të vlerave themelore Evropiane. Kjo pikëpamje kërcënon të ulë besueshmërinë e BE-së si një fuqi normative, ndërsa bën pak për të zgjidhur shkaqet themelore të krizës së emigrantëve. Në vend të kësaj, ajo që nevojitet është një ri-hapje strategjike e politikës së zgjerimit të BE-së që zëvendëson mënyrën aktuale të pilotit automatik me një angazhim vendimtar politik për transformimin e suksesshëm dhe perspektivat e prekshme të anëtarësimit për rajonin e Ballkanit.

Një krizë e jashtme: Ballkani si rrugë tranzite

Rritja e papritur e hyrjeve të emigrantëve drejt BE-së nëpërmjet Detit Egje dhe Greqisë i dha një rëndësi të papritur rajonit të Ballkanit Perëndimor. Sipas zyrës së Eurostat, 28 shtetet anëtare të BE morën një total prej 1,255,000 aplikime për azil të parakohshëm gjatë vitit 2015.¹⁰ UNHCR regjistroi 856,000 mbërritje nga deti në Greqi gjatë kësaj periudhe, një rritje katërfishë që nga viti 2014, të cilat kishin qëndruar në 219,000.¹¹ Popullimi i papritur i rrugës ballkanike nënvizoi vendndodhjen shpesh të shpërfillur të rajonit në zemër të BE-së, meqë qindra mijëra refugjatë paradoksalisht kaluan një vend të BE-së dhe Shengenit - Greqinë - për të kaluar përmes dy vendeve që nuk janë pjesë e BE-së - Maqedonia dhe Serbia - për të arritur përfundimisht në një vend tjetër të Shengenit në veri. Në një rrotullim ironie, dështimi i sistemit të Dublinit, me Greqinë e paaftë për të menaxhuar hyrjet masive të refugjatëve dhe BE-në e paaftë për rivendosjen e tyre, bëri që BE-ja të bëhet një eksportues neto i destabilitetit në rajonin e Ballkanit¹².

¹⁰ Shifrat e detajuara të disponueshme tek: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Asylum_statistics

¹¹ UNHCR, "Refugees/Migrants Emergency Response: Mediterranean", e disponueshme tek: <http://data.unhcr.org/mediterranean/country.php?id=83>.

¹² Francisco de Borja Lasheras with Vessela Tcherneva and Fredrik Wesslau, "Return to Instability: How Migration and Great Power Politics Threaten the Western Balkans", European Council on Foreign Relations, Mars 2016, available at http://www.ecfr.eu/page/-/ECFR_163_RETURN_TO_INSTABILITY.pdf.

Rruga fillestare e tranzitit kaloi nëpër Maqedoni, Serbi dhe pastaj në Hungari, por ndërtimi nga Budapesti i një gardhi në kufirin e saj me Serbinë (dhe më vonë me Kroacinë) i drejtoi emigrantët drejt Kroacisë dhe Sllovenisë nga mesi i shtatorit 2015. Kjo fillimisht shkaktoi një acarim të marrëdhënieve dypalëshe midis Beogradit dhe Budapestit, dhe pastaj midis Beogradit dhe Zagrebit, me Kroacinë dhe Serbinë duke ndërmarrë një seri masash ndëshkimore të ndërsjellta pas mbërritjes së 44,000 emigrantëve në tokën kroate në një javë të vetme. Megjithatë, presioni gjerman për fat të mirë lejoi një zgjidhje të shpejtë të kësaj çështjeje dhe kalimi transit i deri në 9,000 emigrantëve në ditë u zhvillua në një mënyrë çuditërisht të rregullt.¹³

Për më tepër, organizatat e shoqërisë civile në të gjithë rajonin nuk vonuan të kompensojnë mungesën e akomodimit dhe shërbimeve nga ana e shtetit - duke ngritur strehime të përkohshme, dhe duke ofruar ushqime, rroba dhe këshilla ligjore për emigrantët që kalonin nëpër vendet e tyre. Megjithatë, pritja mjaft pozitive dhe efiçente e emigrantëve ishte e lidhur fort me kohëzgjatjen e shkurtër të pranisë së tyre. Kërcënimi së emigrantët mund të mbeten “të bllokuar” përgjatë rrugës së Ballkanit, në momentin që vendet në veri vendosën të mbyllnin kufijtë e tyre, thellonin ngurrimin për të pranuar lehtësira më të përhershme dhe më të mëdha të cilat si përfundim çuan në një kufizim fillestar të hyrjes që nga mesi i nëntorit 2015, dhe u lejuan vetëm ata që vinin nga Siria, Afganistani dhe Iraku.

Përfshirja e BE-së në dimensionin e jashtëm të krizës së emigrantëve në Ballkanin Perëndimor – dhe më tej – është fokusuar në kontrollimin e tyre. Një samit i posaçëm në tetor 2015 i cili mbledhi së bashku shtetet e interesuara të BE-së dhe shtetet e Ballkanit¹⁴ që ndodheshin përgjatë rrugës së tranzitit, rezultoi në miratimin e një plani prej 17 pikësh që përcaktonte një sërë masash konkrete për t’i dhënë fund asaj që u bë e

¹³ Senada Šelo Šabić and Sonja Borić, “At the Gate of Europe: A Report on Refugees on the Western Balkan Route”, Friedrich Ebert Foundation, Mars 2016, e disponueshme tek <http://www.irmo.hr/en/publications/the-study-at-the-gate-of-europe-a-report-on-refugees-on-the-western-balkan-route/>.

¹⁴ Presidenti i Komisionit Juncker mbledhi udhëheqësit e Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Rumanisë, Serbisë dhe Sllovenisë.

njohur si një “politikë e valëzimit”, duke përfshirë një shkëmbim të përmirësuar të informacionit, regjistrimin adekuat të emigrantëve dhe krijimin e kapaciteteve pritëse të përkohshme për 100,000 emigrantë përgjatë rrugës së Ballkanit, duke përfshirë Greqinë.

Megjithatë, është bërë pak për të trajtuar sistemet kryesisht jofunksionale të azilit në vendet e Ballkanit, një çështje që ka të ngjarë të kthehet në një problem për aq kohë që një numër më i madh refugjatësh janë të detyruar të kërkojnë azil atje duke pasur parasysh se rruga drejt Perëndimit është bllokuar. Për më tepër, përpjekjet shitesë të vendosura nga BE-ja për të ndihmuar dhe koordinuar reagimin e saj ndaj krizës me vendet e Ballkanit Perëndimor, siç është Rrjeti i Analizës së Rrezikut të Ballkanit Perëndimor, marrëveshjet e përfunduara të punës së FRONTEX¹⁵ me vendet në rajon dhe mbështetja financiare e Komisionit Evropian, nuk përmbushin kërkesat.

Masat e ndërmarra nuk mund të kompensojnë pamundësinë për të vendosur FRONTEX-in në rajon dhe të përdorin marrëveshje të tjera ekzistuese të sigurisë të rezervuara për shtetet anëtare të BE-së.¹⁶ Duke theksuar “absurditetin se Ballkani Perëndimor nuk është pjesë e BE-së”¹⁷, kriza e refugjatëve e tregon qartë rëndësinë strategjike dhe urgjencën për të marrë seriozisht zgjerimin e BE.

Një krizë e brendshme: Ballkani si rajoni i origjinës

Përveç sfidave që vijnë nga Ballkani i cili u bë një rrugë e rëndësishme tranziti, ekziston edhe një dimension i brendshëm i krizës së emigrantëve në këtë rajon. Pas rritjes së butë të aplikimeve kryesisht të pajustificuara të azilit nga rajoni pas futjes progresive të liberalizimit të vizave me Ballkanin Perëndimor që nga viti 2009, numrat u rritën në vitin 2015, ndërsa shtetasit e Ballkanit Perëndimor “u bashkëngjitën” me valën e

¹⁵ Shiko më shumë tek: <http://frontex.europa.eu/partners/third-countries/>

¹⁶ Vendet e Ballkanit Perëndimor janë jashtë sistemit të EURODAC, databaza e BE-së për identifikimin e azilkërkuesve dhe kaluesit e parregullt të kufijve.

¹⁷ Florian Bieber, “The refugee crisis underlines the absurdity of Western Balkans states being outside of the EU”, London School of Economics blog, 5 shtator 2015, e disponueshme tek: <http://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2015/09/05/notesfrom-the-western-balkans-summit-in-vienna-small-steps-and-not-so-great-expectations/>.

refugjatëve që kalonin përmes rajonit. Numrat më të mëdhenj vijnë nga Shqipëria dhe Kosova¹⁸: nga 16,000 azilkërkuesit shqiptarë në vitin 2014, numri i tyre arriti në gati 66,000 në vitin 2015. Aplikimet nga Kosova nga përafërsisht 17,000 që ishin në vitin 2013, shkuan në 34,000 në vitin 2014 dhe 66,000 në vitin 2015. Këto numra i vendosin të dy vendet midis pesë vendeve të para të origjinës së azilkërkuesve në BE për vitin 2015, pas Sirisë, Afganistanit dhe Irakut¹⁹. Në Gjermani, aplikantët shqiptarë dhe kosovarë në vitin 2015 ishin të dytë mbas Sirisë.²⁰

Përsëri, reagimi i BE-së dhe shteteve anëtare të saj kërkoi të trajtojë simptomat në vend të shkaqeve të kësaj rritjeje të papritur. Faji fillestar iu faturua Ballkanit Perëndimor, i cili filloi të profilizojë qytetarët e tyre pas largimit, duke penguar që disa kategori të qytetarëve të largohen drejt Evropës Perëndimore. Megjithatë, ishte harmonizimi gradual i listës së vendeve të sigurta dhe shpejtësia e procesit të vendimit të azilit që çoi në rënien e kërkesave që vinin nga rajoni.²¹

Shkalla e njohjes së azilit për qytetarët e Ballkanit ishte tashmë shumë e ulët, dhe në Gjermani në vitin 2015 luhatej diku te 0.3% në krahasim me 96% për sirianët. Përveç kësaj, disa vende zvogëluan stimujt për kërkesat

¹⁸ Kosova është vendi i vetëm i rajonit të cilit nuk i është dhënë liberalizimi i vizave për zonën Shengen. Ky hap u propozua në maj 2016 nga Komisioni Evropian por ngelet për t'u miratuar nga Këshilli.

¹⁹ Eurostat, "Countries of origin of (non-EU) asylum seekers in the EU-28 Member States", e disponueshme tek http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Countries_of_origin_of_%28non-EU%29_asylum_seekers_in_the_EU-28_Member_States,_2014_and_2015_%28thousands_of_first_time_applicants%29_YB16.png.

²⁰ Shifra të hollësishme për vitin 2015 të disponueshme nga Ministria Federale për Emigratimin dhe Refugjatët, <https://zeitschrift-ip.dgap.org/de/ip-die-zeitschrift/archiv/jahrgang-2016/januar-februar/doppelt-unter-druck>.

²¹ European Stability Initiative, "Saving visa-free travel", 1 janar 2013, e disponueshme tek: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_132.pdf. Additionally, for a fascinating story on migrants from Montenegro see European Stability Initiative, "Montenegro: Germany's Balkan stipends – Asylum and the Rozaje exodus", 19 janar 2015, e disponueshme tek: <http://www.esiweb.org/pdf/ESI-Montenegro%20essay%20-%20Germany%20Balkan%20stipends%20-%2019%20Jan%202015.pdf>.

për azil, me një numër të aplikantëve që ranë ndjeshëm në Gjermani, pas ndryshimit nga mbështetja financiare në një sistem të kuponit.²²

Përsëri, rikthimi i shpejtë i emigrantëve të Ballkanit drejt qendrave të largimit nuk mundi t'i luftonte shkaqet e eksodit të tyre: jo vetëm që kushtet socio-ekonomike në rajon janë të vështira, me shkallë të lartë të papunësisë që shkakton kryesisht emigrim të motivuar ekonomikisht,²³ por edhe diskriminimi ndaj romëve si një nga grupet kryesore të aplikantëve për azil është shumë i përhapur dhe kryesisht është injoruar nga qeveritë rajonale.²⁴

A janë emigrantët që vijnë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor duke lënë shtëpitë e tyre në kërkim të një jete më të begatë dhe të qëndrueshme në Evropën Perëndimore për shkak të mungesës së dijes rreth bazave të azilit, premtimeve të gabuara nga kompanitë e transportit të nxitura nga fitimi ose faktorët tërheqës të strehimit pa pagesë, shkollave dhe kujdesit shëndetësor, shkaqet që kaq shumë njerëz kanë qenë të gatshëm të kalojnë nëpër të gjitha problemet për disa muaj të jetës së denjë me shërbimet bazë të ofruara, sido që të jetë, kjo duhet të jetë një thirrje që qeveritë e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian të zgjohen.

Eksodi masiv i popullsisë vendase, sidomos popullsia më e marginalizuar, është një tregues i fortë i mungesës në rritje të shpresës përballë papunësisë të lartë, rritjes së varfërisë dhe rritjes së pabarazisë në një rajon që ende përpiket të arrijë nivelin e PBB-së të vitit 1989, kur Jugosllavia filloi të shpërbëhej.²⁵ Zhgënjimi në rritje me elitat politike që

²² Natasha Wunsch, "Doppelt unter Druck: Der Westbalkan als Transitroute und Herkunftsregion", Internationale Politik, Janar/Shkurt 2016, e disponueshme tek: <https://zeitschrift-ip.dgap.org/de/ip-die-zeitschrift/archiv/jahrgang-2016/januar-februar/doppelt-unter-druck>.

²³ Felix Henkel and Bert Hoppe, "Flucht und Migration: Debattenbeiträge aus den Ländern des Westbalkans", Friedrich Ebert Foundation, Shtator 2015, e disponueshme tek <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/11638-20150930.pdf>.

²⁴ Dane Taleski, "The Balkans' Other Migrant Crisis", Freedom House, Maj 2016, e disponueshme tek <https://freedomhouse.org/report/special-reports/balkans-other-migrant-crisis#.V0dhOL4Y35M>.

²⁵ Dušan Reljić, "Western Balkans Conference in Vienna: Gloomy Prospects for EU Accession Candidates", the German Institute for International and Security Affairs, 21 gusht 2015, e disponueshme tek <http://www.swp-berlin.org/en/nc/>

flasin për demokracinë, por praktikojnë kapjen e shtetit dhe klientelizmin, së bashku me premtimin gjithnjë e më të mjegullt të anëtarësimit në BE, është një nxitje tjetër e fortë për t'u dorëzuar dhe larguar. Përsëri, një përdorim më i vendosur i mjeteve të disponueshme nën politikën e zgjerimit mund të ndihmojë në adresimin e disa prej nxitësve kryesorë të emigracionit dhe të ofrojë alternativa ndaj atyre që i kthejnë shpinën vendeve të tyre të origjinës.

Përtej kontrollit: përdorimi i mjeteve të politikës së zgjerimit

Duke qenë se ka pasur nevojë për partnerë të qëndrueshëm në përgjithësi, dhe për të luftuar pasojat e krizës së refugjatëve në veçanti, BE-ja ka qenë shumë e gatshme për të mos i kushtuar rëndësi hapave jo-demokratike midis vendeve kandidate.²⁶ Raporti i Vendeve në Tranzit të Freedom House në vitin 2016 tregon se demokracia në Ballkanin Perëndimor është ulur në mënyrë të vazhdueshme që prej gjashtë vjetësh, dhe është mesatarisht në nivelet e vitit 2004.²⁷ Tendencë e BE-së për të bërë një sy të verbër ndaj tendencave autoritare shqetësuese ka qenë veçanërisht e dukshme në rastet e Maqedonisë²⁸ dhe Serbisë²⁹.

Pas vizitës së tij të fundit në Shkup në janar 2016, komisioneri Johannes Hahn theksoi se “pavarësisht nga të gjitha bisedimet rreth zgjedhjeve të reja, nuk duhet të harrojmë se ka një krizë serioze të emigracionit në Evropë (...) ka të bëjë edhe me perspektivën evropiane, euro-atlantike,

publications/point-of-view/western-balkans-conference-in-vienna-gloomy-prospects-for-eu-accession-candidates/print/1.html.

²⁶ Srdjan Cvijic and Goran Buldioski, “Beyond the Migration route in the Western Balkans”, Nëntor 2015, e disponueshme tek <http://www.esharp.eu/debates/external-action/beyond-the-migration-route-in-the-western-balkans>

²⁷ E disponueshme tek <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/nations-transit-2016>.

²⁸ Për më shumë rreth Maqedonisë, shiko Nikola Dimitrov, Ivana Jordanovska and Dane Taleski, Policy Brief “Ending the Crisis in Macedonia: Who Is in the Driver’s Seat?”, BiEPAG, Prill 2016, e disponueshme tek <http://balkanfund.org/wp-content/uploads/2016/04/Ending-the-Crisis-in-Macedonia-Who-is-in-the-driving-seat-web.pdf>.

²⁹ Srdjan Cvijic, “Serbia election: EU grasping at straws”, EuObserver, 27 prill 2016, e disponueshme tek <https://euobserver.com/opinion/133226>.

ku unë besoj se një qeveri e fortë dhe vendimtare, e cila mund të marrë vendime, është e rëndësishme.”³⁰ Në mënyrë të ngjashme, represioni i lirisë së medias në Serbi³¹ nuk është kundërshtuar mjaftueshëm nga BE, me rizgjedhjen e fundit të kryeministrit serb Vuçiç, i cili akuzohet se i mban mediat vendase nën kontroll³², sërish u përshëndet si një fitore për reformat dhe procesin e aksesimit të vendit.

Mungesa e qëndrimit kategorik të BE-së, në kontekstin e krizës së emigrantëve, ka lejuar që Vuçiç të pohojë se mënyra se si vendi i tij i ka trajtuar refugjatët “na bën më evropian se disa shtete anëtare”³³ po ashtu dhe presidenti maqedonas Ivanov me krenari mburrej se vendi i tij “po mbron Evropën nga vetja”³⁴ pas mbylljes së kufirit maqedonas.

Në vend që të mbështetet në udhëheqës të fortë për të përballuar krizën e emigrantëve, BE duhet të përdorë fuqinë e fortë që ka në Ballkanin Perëndimor - dhe mjetet e politikës së zgjerimit të BE - për të trajtuar më me forcë dimensionet e brendshme dhe të jashtme të krizës.³⁵

Një riaktivizim i mundshëm i rrugës së tranzitit në Ballkan në të ardhmen do ta bëjë më të lehtë për ta trajtuar, nëse ekzistojnë mekanizma funksionalë për koordinimin ndërmjet anëtarëve të BE-së dhe atyre jo-anëtare të BE-së, si dhe kapacitetet adekuate të regjistrimit dhe pranimit

³⁰ Video e deklaratës e disponueshme tek <https://youtu.be/JKLb56-P6rs>.

³¹ Freedom House, “Freedom of the Press 2016”, e disponueshme tek <https://freedomhouse.org/report/freedom-press/freedom-press-2016?gclid=CJTaaqVgs0CFZcy0wodWeoGCw>.

³² Rodić, Aleksandar. “Srbijo, izvini”, Kurir, e disponueshme tek <http://www.kurir.rs/vesti/drustvo/aleksandar-rodic-srbijo-izvini-clanak-2008557>.

³³ Filip Avramovic, Igor Jovanovic, “Serbia will take in some migrants, Vucic says”, BalkanInsight, 2 shtator 2015, e disponueshme tek <http://www.balkaninsight.com/en/article/serbia-to-receive-certain-number-of-migrants-pm-says-09-01-2015>.

³⁴ Gjorge Ivanov, Presidenti i Maqedonisë. “Macedonia is defending Europe from itself” comment, The Telegraph. 6 mars, 2016. E disponueshme tek: <http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/macedonia/12185464/Macedonia-is-defending-Europe-from-itself.html>.

³⁵ Për një argument më të fortë në këtë drejtim shiko Joschka Fischer, “Europe’s Migration Paralysis”, Project Syndicate, 24 gusht 2015, e disponueshme tek <https://www.project-syndicate.org/commentary/eu-migration-crisis-by-joschka-fischer-2015-08?barrier=true>

në terren. Kur bëhet fjalë për emigrimin nga rajoni, deklarimi i vendeve në rajon si vende të sigurta të origjinës mund të ulë përkohësisht rrjedhën, por mbështetja që ata të bëhen vende ku njerëzit mund të jetojnë një jetë të denjë - nëpërmjet një procesi të besueshëm të pranimi, investimeve për të hapur vende pune dhe modernizimi i përgjithshëm ekonomik - është gjithçka që nevojitet për të pasur një ndryshim të qëndrueshëm.

BE-ja duhet ta përdorë krizën e emigracionit për të rritur angazhimin e saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Qetësia që erdhi mbas marrëveshjes BE-Turqi duhet të shërbejë si një shkas për një reflektim më të thellë se si të ankorohet Ballkani në mënyrë të qëndrueshme në Evropë, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht.

Rekomandime

Zhvillimi i mekanizmit të koordinimit ndërmjet be dhe shteteve që nuk janë pjesë e be për t'u përballur me situatat e krizës.

Përgjigja e hershme ndaj rritjes së numrit të emigrantëve që kalonin përmes Ballkanit Perëndimor nënvizoi mungesën e kanaleve efektive të komunikimit dhe koordinimit brenda rajonit, si midis vendeve të BE-së po ashtu edhe në lidhje me vendet jashtë BE-së në përgjithësi. Një mekanizëm i tillë koordinimi që mund të nxitet me shpejtësi për të sinkronizuar përgjigjet dhe shkëmbimin e informacionit duhet të futet urgjentisht.

Mbajtja e performancës demokratike dhe zbatimi i plotë i kriterëve të Kopenhagën it në zemër të procesit të hyrjes në BE.

Në terma afatgjate, ruajtja e stabilitetit në kurriz të demokracisë dhe sundimit të ligjit nuk është një strategji e qëndrueshme. Të qenit i verbër ndaj tendencave autoritare në Ballkan jo vetëm që kërcënon të minojë masën e transformimit demokratik të arritur gjatë gjithë procesit të pranimi në BE deri më tani, por gjithashtu rrezikon të përkeqësohet më tej gjendja për popullsitë në terren, duke krijuar stimuj të mëtejshëm për emigrimin drejt Evropës Perëndimore.

Hapja e kapitujve 23 dhe 24 për të gjithë vendet candidate.

“Qasja e re” e BE-së vendosi një përparësi në përmirësimet në sundimin e ligjit në qendër të negociatave për anëtarësim. Hapja e kapitujve përkatës të legjislacionit me të gjitha vendet e pranuar do të përcaktojë kërkesat në këto fusha në mënyrë të qartë dhe me forcë dhe do t’u japin aktorëve të brendshëm të shoqërisë civile një pikë referimi të vlefshme për t’i mbajtur qeveritë e tyre të përgjegjshme për reforma të besueshme dhe të qëndrueshme që do të përfitojnë qytetarët dhe për të rritur apelin e popullatave lokale për anëtarësim në BE.³⁶

Krijimi i alternativave ndaj emigracionit të paligjshëm në Evropën Perëndimore.

Kur njerëzit largohen prej një grupi terrorist që merr kontrollin e fshatit ose qytetit të tyre, gjërat e tyre mund të plaçkiten - një burim tjetër i pasurisë për terroristët që rrëmbejnë territorin. Megjithatë, ata mund të përfitojnë edhe në një mënyrë tjetër: kur njerëzit largohen nga zonat e sulmeve terroriste ose zonat e konfliktit, ikja e tyre shpesh është e rrezikshme dhe e vështirë; ata duhet të kërkojnë ndihmën e lehtësuesve, në shumicën e rasteve të kontrabandistëve kriminalë, që të kalojnë ose të anashkalojnë barrikadat në zonat e konfliktit dhe të kalojnë në kufijtë ndërkombëtarë. Duke vendosur barriera, grupet terroriste shpesh kontrollojnë drejtpërdrejtë dhe taksojnë ata që dëshirojnë të largohen ose detyrojnë kontrabandistët të ndajnë fitimet me ta.

Në rastin e Libisë, shteti islamik kontrollon një shtrirje prej gati 260 kilometrash të gadishullit mesdhetar rreth Sirtes. Ka prova që tregojnë se kontrabandistët e njerëzve duhet të ndajnë fitimet e tyre me organizatat

terroriste, duke përfshirë edhe Shtetin Islamik.⁸⁵ Të ardhurat që vijnë nga kontrabanda dhe trafikimi i njerëzve thuhet se janë të dytat, mbas të ardhurave që mund të vijnë nga kontrabanda e drogës.⁸⁶ Më shumë se nëntë nga dhjetë emigrantë që duan të hyjnë në Bashkimin Evropian në mënyrë të parregullt nga Afrika e Veriut apo Turqia Perëndimore përdorin lehtësuesit - zakonisht kontrabandistë kriminelë. Sipas një raporti të fundit të Europol, trafikuesit e emigrantëve në Bengazi, Misra dhe Tripoli të Libisë, Izmir dhe Stamboll të Turqisë, Amman në Jordani, Kajro në Egjipt, Casablanca në Marok, Algjier dhe Oran në Algjeri, si dhe pikat të tjera, kriminelët kanë përfituar, duke sjellë azilkërkues dhe emigrantë ekonomikë në Evropë, midis 3 dhe 6 miliardë dollarë përfitime të jashtëligjshme.⁸⁷ Në raportin e tij mbi operacionet e kontrabandës, Europol shprehu shqetësimin se “organizatat terroriste mbështeten në kontrabandimin e emigrantëve si burim financimi”, pa dhënë detaje.⁸⁸ Edhe një përqindje e vogël e përfitimeve kriminale nga kontrabanda e njerëzve do të ishte një shpërblim për një organizatë terroriste nëse shikojmë disa shifra:

Në vitin 2014, 219.000 njerëz kaluan Mesdheun për të arritur Evropën nëpërmjet Libisë: në vitin 2015 ishin rreth 322.000 njerëz në tetë muajt e parë. Më shumë se 2.500 humbën jetën në det, pasi ata udhëtonin në

⁸⁵ V. Walt, “ISIS Makes a Fortune From Smuggling People Says Report”, *TIME*, 13 mars 2016, <http://www.globalinitiative.net/wpfb-file/libya-criminal-economies-in-the-trans-sahara-may-2015-pdf/>.

⁸⁶ W. Von Bernd, “Die Europäische Grenzschutzagentur Frontex – Wallmeister der Festung Europas oder Garant für die Sicherheit der Außengrenzen?”, *Die Kriminalpolizei*, June 2015, <http://www.kriminalpolizei.de/ausgaben/2015/juni/detailansicht-juni/artikel/die-europaeische-grenzschutzagentur-frontex-wallmeister-der-festung-europas-oder-garant-fuer-die.html>.

⁸⁷ S. D. Kavanaugh, “Europe’s Migrant Smugglers Banked \$ 6.6 Billion in 2015: By the Numbers”, *Vocativ*, 24 shkurt 2016, <http://www.vocativ.com/news/289050/europes-migrant-smugglers-banked-6-6-billion-in-2015-by-the-numbers/>; Europol, *Migrant Smuggling in the EU* (The Hague: Europol, shkurt 2016), https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/migrant_smuggling__europol_report_2016.pdf.

⁸⁸ Europol, *Migrant Smuggling in the EU* (The Hague: Europol, shkurt 2016), fq.12.

varka të pasigurta të elementëve kriminalë.⁸⁹ Një kontrabandist reklamoi në faqen e tij të medias sociale se shpenzimet e udhëtimit në det nga Libia në Itali ishte 1.000 dollarë për një person të rritur. Për një paketë që përfshinte edhe një fluturim nga Turqia në Libi, ajo arrinte në 3,700 dollarë amerikanë, dhe udhëtimi i fëmijëve kushtonte 500 \$.⁹⁰ Duke supozuar se kontrabandistët e njerëzve në Libi duhej të ndanin përfitimin e tyre me terroristët në bregun e Libisë nga ku shumë anije ikën dhe duke supozuar se një e treta duhet t'u paguhet terroristëve, që do të kishin lënë organizatën terroriste me më shumë se 100 milionë dollarë vetëm për vitin 2015 - një vlerësim konservativ. Ky lloj i parave bën një rrugëtim të gjatë për të rekrutuar anëtarë të rinj për ISIS dhe për të paguar armë, eksplozivë, dokumente udhëtimi të rreme, shtëpi të sigurt, ryshfete dhe çdo gjë tjetër që nevojitet për të financuar terrorizmin. Aktualisht 800.000 emigrantë më shumë raportohet se presin në Libi për një kalim drejt Italisë, pasi rruga përmes Turqisë dhe Greqisë është bërë më e vështirë.⁹¹

Ndërsa fakti që njerëzit “votojnë” me këmbët e tyre kundër qëndrimit në territoret e kontrolluara nga Shteti Islamik, duhet të jetë njëfarë dështimi për ata që pretendojnë të krijojnë një shoqëri të drejtë, të bazuar në shariat në Kalifatin e ringjallur, megjithatë, eksodi masiv nga distopia terroriste mund të shndërrohet në një burim shtesë të ardhurash të cilat mund të shfrytëzohen për të forcuar ekonominë e Shtetit terrorist Islamik. Në të njëjtën kohë Shteti Islamik përpiqet të përfshihet në kontrollin e dëmeve duke treguar videot e refugjatëve të dëshpëruar që mbyten duke portretizuar jetën në “Kalifat” si harmonike dhe të rregullt.⁹²

Përmbledhje: taktikat terroriste i bëjnë njerëzit të kenë frikë për jetët e tyre, gjë që tenton të shkaktojë shmangie dhe emigrim. Nga ana tjetër,

⁸⁹ The Soufan Group, “The Refugees of a World at War”, 1 September 2015, <http://soufangroup.com/tsg-intelbrief-the-refugees-of-a-world-at-war/>.

⁹⁰ Europol, *Migrant smuggling in the EU*, fq. 10.

⁹¹ Vlerësimi i lartë është bërë nga Ministri i Mbrojtjes së Francës, Jean-Yves Le Drian; cit. J. Bergman, “Europe’s Migration Crisis: No End in Sight”, *Gatestone Institute*, 2 maj 2016, <http://www.gatestoneinstitute.org/7916/europe-migration-crisis>.

⁹² S. Mullins, “Terrorism and Mass Migration”, *Per Concordiam* 7, nr. 1 (prill 2016), fq. 26-27, http://www.marshallcenter.org/mcpublicweb/MCDocs/files/College/F_Publications/perConcordiam/pC_V7N1_en.pdf.

nëse një emigrim i tillë taksohet, atëhere mundësohet një financim më i madh i terrorizmit. Këto gjetje surprizuese të cituara më sipër janë mbështetur nga fakte të forta të një analizë sasiore të Institutit për Ekonominë dhe Paqen. Drejtuesi i IEP, Steve Killelea, gjatë prezantimit të Indeksit Global të Terrorizmit të këtij instituti për vitin 2015 vuri në dukje se: “Dhjetë nga 11 vendet më të prekura nga terrorizmi kanë gjithashtu normat më të larta të refugjatëve dhe zhvendosjen e brendshme. Kjo nxjerr në pah lidhjen e fortë ndërmjet krizës aktuale të refugjatëve, terrorizmit dhe konfliktit.”⁹³

Lufta (Civile) si Shkaktari Kryesor i Terrorizmit dhe Emigrimit?

Gjatë periudhës 1946-2016 kanë ndodhur 259 konflikte të armatosura.⁹⁴ Luftërat e dekolonizimit dhe luftërat ndërshtetërore kanë pësuar rënie. Megjithatë, kemi një përhapje të luftërave të brendshme civile të cilat shpesh shoqërohen nga ndërhyrje të huaja. Ndërkohë që numri i konflikteve të armatosura ka rënë prej më shumë se një dekade duke filluar nga viti 1992, prirja drejt rënies e pas Luftës së Ftohtë ndaloi në vitin 2003. Që prej atij viti ne kemi parë në çdo vit pasues midis 30 dhe 50 konflikte në vazhdim. Pyetësi i Konfliktit të Armatosur në vitin 2015 liston 37 konflikte të larta, të mesme dhe të ulëta me 167,000 fatalitete - gjysma e të cilave në Lindjen e Mesme dhe një e treta e tyre në Siri. Një vit më parë, kishte pasur 42 konflikte aktive me 180,000 fatalitete.⁹⁵

Konflikti në Siri, më fatali që prej fundit të Luftës së Ftohtë, ka prodhuar më shumë se gjysmën (53 përqind) të viktimave të luftës në mbarë botën, i ndjekur nga Iraku (12 përqind) dhe Afganistani (12 përqind). Në vitin 2014, rreth 80 përqind e viktimave të betejave prej 104,000 ndodhën në

⁹³ S. Killelea, Executive Chairman of IEP, www.visionofhumanity.org.

⁹⁴ Figure from Uppsala Conflict Data Program, www.pcr.uu.se/research/ucdp/datasets.

⁹⁵ International Institute for Strategic Studies, *Armed Conflict Survey* (New York: Routledge, 2016), Vëll. 1, numri 1, fq. 78; M. von Hein, “Armed Conflict Survey: In 2015, Syria accounted for one-third of global conflict deaths”, *Deutsche Welle*, 6 maj 2016, www.dw.com/armed-conflict-surveyin-2015-syria-accounted-for-one-third-of-global-conflict-deaths/a-19237568.

këto tre vende.⁹⁶ Të tre luftërat - Afganistan, Irak dhe Siri - janë shoqëruar nga terrorizmi dhe zhvendosjet e mëdha të popullsisë. Midis viteve 1978, kur Bashkimi Sovjetik pushtoi Afganistanin dhe tërheqjes së tij në vitin 1989, 6.2 milionë afganë u kthyen në refugjatë në Pakistan dhe Iran; shumica prej tyre ndodhen ende aty edhe pse kanë kaluar gjithë këto vite.⁹⁷ Katër vjet pas pushtimit amerikan të Irakut në vitin 2003, dy milionë irakianë ishin kthyer në refugjatë dhe 1.7 milion u zhvendosën brenda vendit deri në shkurt të vitit 2007.⁹⁸ Në rastin e Sirisë, prej shtatorit të vitit 2015, vendi kishte 4,1 milion refugjatë jashtë vendit dhe 6,5 milion të zhvendosur brenda vendit ndërsa 1,1 milion sirianë ishin plagosur nga lufta dhe terrorizmi dhe më shumë se 250,000 ishin vrarë.⁹⁹

Ndërhyrjet e jashtme shpesh i bëjnë situatat e këqija edhe më keq, e zgjasin konfliktin dhe çojnë në përdorimin e taktikave asimetrike nga grupet e rezistencës – terrorizmi është një prej tyre. Të zbulosh akte terrorizmi në mes të luftës është shpesh e vështirë pasi mbledhja e informacionit të pavarur është pothuajse e pamundur dhe veprimtaria e propagandës është tejet e përhapur. Veprimet legjitime të luftës dhe krimet e luftës ndodhin mes njëra tjetrës. Krimet e luftës përfshijnë, ndër të tjera, sulme të qëllimshme ndaj jo luftëtarëve (p.sh. të burgosurit e luftës) dhe civilët e paarmatosur ose në vendet ku civilët janë të njohur ose që mund të strehohen.

Krimet e luftës, në shumë raste i ngjajnë akteve të terrorizmit - aq shumë sa që një përpjekje për të përkufizuar terrorizmin sugjeroi që të shtrihet përkufizimi i krimeve të luftës dhe të përcaktojë një akt terrorizmi thjesht si “ekuivalenti i krimeve të luftës në kohë paqeje” – duke i ndërprerë në

⁹⁶ S. Gates, H. M. Nygard, H. Strand and H. Urdal (PRIO), “Trends in Armed Conflict 1946-2014”, *Peace Research Institute Oslo*, 2016, <http://www.isn.ethz.ch/Digital-Library/Articles/Detail/?lng=en&ord61=alphaNavi&id=196081>.

⁹⁷ “Afghan refugees” in Wikipedia, https://en.wikipedia.org/wiki/Afghan_refugees; UNHCR, “Afghanistan 10 Years After Soviet Pull-out”, *UNHCR briefing note*, 12 shkurt 1999, <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/search?page=search&docid=3ae6b81cf0&query=Return%20to%20Afghanistan>.

⁹⁸ Numrat nga UNHCR siç cithet në https://en.wikipedia.org/wiki/Refugees_of_Iraq.

⁹⁹ A. Cordesman and A. H. Human, *Cost of War in the Middle East: A Graphic Overview*, (Washington, DC: Center for Strategic & International Studies, shkurt 2016 - Working Draft), fq. 46, 58.

këtë mënyrë debatet e pafundme të përkufizimit (përderisa ka një shkallë më të madhe konsensusi në të drejtën humanitare ndërkombëtare se çfarë përbën një krim por jo çfarë përbën terrorizëm).¹⁰⁰

Shumë luftëra të brendshme avancojnë në faza të ndryshme nga incidente të vogla në forma më masive të dhunës. Nëse ata që janë përgjegjës për to nuk janë kapur apo neutralizuar në një fazë të hershme, aktet individuale të izoluara të terrorizmit shpesh janë një hap drejt fushatave terroriste. Nëse janë të suksesshme, një ose më shumë fushata të tilla mund të çojnë në një situatë ku një organizatë terroriste mund të fillojë “çlirimin” e pjesëve të një vendi. Nga zona të tilla të çliruara, bandat e armatosura mund të angazhohen në operacione “gjuaj dhe vrapo”, pusi apo taktika të tjera guerile. Në fund të fundit, qëllimi është që të përparojë nga terrorizmi jo vetëm për luftën guerile rurale (zakonisht me terrorizëm urban të njëkohshëm në anën tjetër), por për të krijuar një ushtri pak a shumë konvencionale me të cilën të merret pushteti shtetëror. Shumica e grupeve terroriste nuk arrijnë kurrë në fazën II në strategjinë graduale të Luftës Popullore (ose Luftës së Zgjatur) të Maos dhe shumë pak arrijnë të krijojnë një ushtri konvencionale të fazës III.¹⁰¹

Gjithashtu, duhet të përfshihet edhe roli i ndërhyrjeve të huaja: ai ose mund të punojë në favor të grupit terrorist që aspirojnë (siç bëri me reagimin nacionalist në Somali pas ndërhyrjes etiopiane të vitit 2006) ose mund të çojë në dorëzimin (e përkohshëm) (si në Afganistan ku al-Kaeda dhe talebanët u detyruan të largohen drejt Pakistanit pas operacionit Liria e Qëndrueshme gjatë viteve 2001-2002).

Konkurrenca mund të çojë në debate, debatet në grindje, grindjet serioze në polarizim dhe konflikt, dhe avancimi i konfliktit në përdorim të dhunës politike, e cila mund të sjellë forma asimetrike të luftës përfshirë terrorizmin dhe në fund, luftë në shkallë të përgjithshme. Shumë forma të zhvillimit të konfliktit mund të bashkekzistojnë në të njëjtën kohë dhe kjo aplikohet edhe në rastet e terrorizmit në mes të, ose anës luftës, ndonjëherë të kryer jashtë teatrit kryesor të konfliktit. Kjo është në linjë

¹⁰⁰ A. P. Schmid, “The Definition of Terrorism. A Study in Compliance with CTL 9/91/2207 for the UN Crime Prevention and Criminal Justice Branch” (Leiden: COMT, dhjetor 1992), fq. 8-12.

¹⁰¹ M. Tse-Tung (përkthyer nga S. B. Griffith), *On Guerrilla Warfare* (New York: Praeger, 1961), fq.20-21.

me një gjetje tjetër statistikore nga Instituti për Ekonominë dhe Paqen (IEP):

“Aktiviteti terrorist historikisht ndodh brenda kombeve që përfshijnë gjithashtu konflikt të brendshëm të armatosur. IEP... zbuloi se 55 përqind e të gjitha sulmeve terroriste ndodhën në vende që ndodhen në mes të një konflikti të brendshëm të armatosur. Përveç kësaj, 33 përqind kanë ndodhur në vendet që përfshijnë ose përfshihen në një konflikt ndërshtetëror”.¹⁰²

Në konflikte të tilla, numri i personave të zhvendosur jashtë është ndonjëherë më i ulët dhe ndonjëherë më i lartë se i të zhvendosurve brenda vendit. Për shembull, në vitet 1994/95, 20 konfliktet më intensive të identifikuar në një projekt monitorimi të PIOOM-it tregojnë të paktën 634,000 jetë të humbura (në formë kumulative, pasi prej fillimit të këtyre konflikteve kishte shtatë milionë fatalitete), më shumë se nëntë milionë refugjatë dhe gati njëzet milion persona të zhvendosur brenda vendit.

Nga ana tjetër, në mesin e viteve 1990, 55 konflikte me intensitet më të ulët dhe grindje serioze prodhuan rreth 2.6 milion fatalitete të tjera, ku gjashtë milionë persona u zhvendosën brenda vendit dhe nëntë milionë u kthyen në refugjatë (ose njerëz në situata të refugjatëve)¹⁰³ duke ndryshuar raportet e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë vendit.

Evropa përjetoi pasojat e një konflikti të tillë në vitet 1990 kur filloi të shpërbëhej Jugosllavia. Në atë kohë hyri në fjalor shprehja “spastrim etnik”. Ajo i referohet terrorizimit të sektorëve të popullsisë, zakonisht një pakice, me qëllim që t’i bëjë ata të largohen nga toka e etërve të tyre në mënyrë që të krijohet homogjenitet më i madh kombëtar. Vamik Volkan, në librin e tij *Blood Lines. From Ethnic Pride to Ethnic Terrorism*, e përkufizon këtë të fundit duke iu referuar:

“Situata në të cilat udhëheqësit terroristë kanë lidhje të tepërta me identitetin e grupit të tyre të madh dhe kërkojnë ta rrisin atë përmes dhunës së përhapur dhe ta përjetësojnë

¹⁰² Institute for Economics and Peace, *Global Terrorism Index 2015. Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (New York: IEP, 2015), fq. 71.

¹⁰³ “PIOOM databank”, *PIOOM Newsletter & Progress Report*, (Leiden: C.O.M.T.,1995).

atë në kushte të përmirësuara politike, siç është një formë e autonomisë apo shtetësisë për grupin. Terroristët etnikë i legjitimojnë veprimet e tyre duke iu referuar grupit dominues etnik apo grupit tjetër si një forcë pushtuese, kundërshtarë, kolonizuese ose e huaj “.¹⁰⁴

Lufta e Bosnjes gjatë viteve 1992-1995 prodhoi më shumë se 100,000 persona të vdekur ose të zhdukur, ndërsa dy milionë njerëz u zhvendosën brenda vendit ose u kthyen në refugjatë jashtë vendit.¹⁰⁵ Krimet e luftës u kryen nga të gjitha palët, por shumica e tyre u kryen nga ana e forcave të Boshnjakëve Serbë (nga Republika Srpska) të cilët ishin pak a shumë të mbështetur haptazi nga regjimi serb në Beograd.¹⁰⁶

Evropa Perëndimore nuk ka parë flukse të tilla të mëdha refugjatësh, siç është rasti i konfliktit sirian, që nga luftërat e Ballkanit. Ndërsa situata ishte shumë e keqe në Siri deri në vjeshtën e vitit 2015, ndërhyrja masive e forcave ajrore ruse midis fundit të shtatorit 2015 dhe mesit të marsit 2016 në anën e regjimit të Asadit e përkeqësoi edhe më tej situatën. Bombarduesit rusë u angazhuan në shpërthime ajrore të rënda, por jo shumë të sakta (disa nga bombat e tyre ishin “bomba inteligjente”), të cilat prodhuan zhvendosje masive shtesë. Sipas Roy Gutman, korrespondenti i Lindjes së Mesme që fitoi çmimin Pulitzer, fushata ajrore ruse, me më shumë se 8,000 mburoja që nga 30 shtatori 2015, - në 90 % të rasteve ishin të drejtura kundër forcave që nuk kishin lidhje me ISIS – kështu shpërngulën disa qindra mijëra njerëz. Sipas një vlerësimi konservativ të UNHCR-së 75,000 persona u larguan për shkak të bombardimeve ajrore vetëm në shkurt të vitit 2016.¹⁰⁷

Lidhja midis konflikteve të dhunshme dhe luftërave (civile) nga njëra anë dhe terrorizmit nga ana tjetër është e mirë-vendosur. Sipas Institutit për Ekonomi dhe Paqe, 88 përqind e të gjitha sulmeve terroriste kanë

¹⁰⁴ V. Volkan, *Blood Lines. From Ethnic Pride to Ethnic Terrorism*, (Colorado: Boulder, 1997), fq. 157.

¹⁰⁵ Wikipedia, https://en.wikipedia.org/wiki/Yugoslav_Wars.

¹⁰⁶ “Ethnic Cleansing” and Atrocities in Bosnia”, (Langley: CIA, 1995), http://fas.org/irp/cia/product/bosnia_handout.html.

¹⁰⁷ R. Gutman, “Turkey gives up on Obama, bristles over Syria deal”, *Politico*, 25 shkurt 2016, <http://www.politico.eu/article/turkey-gives-up-on-obama-syria-deal-cease-fire-war-islamic-state/>.

ndodhur në vendet që kanë përjetuar ose janë përfshirë në konflikte të dhunshme, ndërsa 11 përqind e sulmeve terroriste kanë ndodhur në vende që në atë kohë nuk ishin përfshirë në konflikt. Më pak se 0.6 përqind e të gjitha sulmeve terroriste ndodhën në vende pa ndonjë konflikt të vazhdueshëm dhe as ndonjë formë të terrorit politik (duke përdorur shkallën e Gibney-t).¹⁰⁸

Lidhja ndërmjet terrorizmit të lidhur me konfliktin dhe emigrimit të refugjatëve është gjithashtu bindëse, duke pasur parasysh nivelet e refugjatëve të vendeve të shkatërruara nga luftërat civile, me ose pa ndërhyrje të huaja. Pesë vendet me numrin më të madh të fataliteteve terroriste – të cilat së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e të gjitha fataliteteve të lidhura me terrorizmin në vitin 2014 - ishin Afganistani, Iraku, Nigeria, Pakistani dhe Siria. Këto shtete pësuan 78 për qind të të gjitha fataliteteve terroriste dhe 57 për qind të të gjitha sulmeve që u regjistruan në vitin 2014.¹⁰⁹

Tabela 13: Të gjithë refugjatët dhe njerëzit në situata-si-refugjatët për mes-vitin 2015, sipas UNHCR dhe numrit kumulativ të Incidenteve Terroriste

	Refugjatë	Incidente Terroriste 1970-2014
Afganistan	2,632,534	7,765
Kolumbi	346,125	8,049
Irak	377,747	16,448
Nigeri	120,303	2,286
Pakistan	262,136	11,804
Somali	1,105,618	2,557
Siri	4,194,554	1,390

¹⁰⁸ Institute for Economics and Peace, *Global Terrorism Index 2015. Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (New York: IEP, 2015), fq. 71, http://www.visionofhumanity.org/sites/default/files/2015%20Global%20Terrorism%20Index%20Report_1.pdf.

¹⁰⁹ Institute for Economics and Peace, *Global Terrorism Index 2015. Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (New York: IEP, 2015), fq. 4

Burimi: US Central Intelligence Agency. The World Fact Book. Langley: CIA, 2016, Country Comparison: Net Migration Rate, www.cia.gov/library/publications/resources/the-word-factbook/rankorder/2212rank.html

Dëshmia *prima facie* për lidhjet midis luftës (civile), terrorizmit dhe prodhimit të refugjatëve duket e fortë. Sidoqoftë, ajo duhet të përpunohet në mënyrë më të detajuar përmes analizës kronologjike të procesit në secilin rast - gjë që do të kërkonte, ndër të tjera, krijimin e të dhënave kumulative edhe për rezervat dhe flukset e refugjatëve, të cilat janë përtej këtij studimi eksplorues.

Kampet e Refugjatëve dhe Diasporat si Shkaktarë (dhe shënjestra) të Terrorizmit?

(i) Roli i Kampeve të Refugjatëve

Kampe refugjatësh ka në më shumë se 125 shtete, dhe nëse dikush do dëshironte të mendonte se ato janë struktura të përkohshme, është dëshpërues fakti se kohëzgjatja mesatare e një shtate refugjatësh është shtatëmbëdhjetë vjet.¹¹⁰ Dikush tjetër do dëshironte të mendonte se kampet e refugjatëve janë vende të sigurt ku ata që arratisen nga dhuna dhe kërcënimi i vazhdueshëm i persekutimit mund të rimarrin veten, të presin përfundimin e armiqësive dhe të planifikojnë se si do vazhdojnë jetën mbas rikthimit. Fatkeqësisht, nuk funksionon kështu: kampet e refugjatëve kanë tendencën për të qenë vende të pasigurta pasi janë zakonisht nën vëzhgim.

Kampet e refugjatëve shpesh janë sinonim i mjerimit dhe mungesës së perspektivës për ata që duhet të presin atje për një ndryshim më të mirë. Ashtu si burgjet, ato mund të bëhen baza për terrorizëm. Pak më shumë se gjysma e popullsisë së refugjatëve në botë janë më të rinj se 18 vjeç.¹¹¹

¹¹⁰ M. Fleming, *How to help refugees rebuild their world*, TED Talk, 2014, https://www.ted.com/talks/melissa_fleming_let_s_help_refugees_thrive_not_just_survive.

¹¹¹ M. van der Velde, "World Refugee Situation 2014 according to UNHCR" *Mobility and Migration Choices: Thresholds to Crossing Borders* (Ashgate Publishing Ltd., 2015)

Të rinjtë janë më të prirur për t'u bashkuar me grupet terroriste sesa të moshuarit.¹¹² Vendbanimi i hapur në këto kampe ofron mundësi rekrutimi për terroristët dhe luftëtarët guerilë.

Brian M. Jenkins, një analist shumë i respektuar i terrorizmit, ngriti pyetjen në një blog të kohëve të fundit, nëse konflikti sirian do të prodhojë një brez të ri terroristësh, në analogji me konfliktin palestinez.¹¹³ Sigurisht, në kampet e refugjatëve rreth Sirisë ndodhin shumë gjëra që përbëjnë një burim të madh shqetësimesh. Për këtë arsye, është e udhës të shohim përsëri përvojën palestineze.

Shembulli klasik i mënyrës se si kampet e refugjatëve mund të bëhen baza për aktivitete terroriste ofrohet nga fati i palestinezëve, shumë prej të cilëve u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre kur u krijua Izraeli. Rreth 700,000 palestinezë u arratisën pasi Izraeli mori kontrollin e tokës së tyre midis pranverës 1948 dhe pranverës 1949.

Në vitin 1947, grupet terroriste hebreje si bandat Irgun dhe Stern kishin sulmuar ushtarë britanikë dhe civilë palestinezë, të cilët përfundimisht do të çonin në eksodin e qindra mijëra palestinezëve.¹¹⁴ Situata e palestinezëve çoi në ndërhyrjet e shteteve arabe për të prishur formimin e shtetit izraelit të 14 majit 1948, por kjo nuk rezultoi e suksesshme. Një seri luftërash u ndoqën në vitin 1956, 1967, 1973, 1982 dhe më tej. Në veçanti, lufta gjashtëditore e vitit 1967, shkaktoi një largim tjetër masiv të palestinezëve prej 200,000 deri në 325,000 njerëz.¹¹⁵

Ndonëse shumica e popullatës së refugjatëve tkurret pas njëfarë kohe, në rastin e palestinezëve ka ende rreth 1,5 milion refugjatë dhe pasardhësit e tyre në kampet në Jordani, Liban dhe Siri, pasi këto shtete fqinje refuzuan t'i integronin plotësisht ata për arsye politike.¹¹⁶ Pasi

¹¹² Institute for Economics & Peace, *Global Terrorism Index 2015. Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (New York: IEP, 2015), fq. 59

¹¹³ B. M. Jenkins, "Will Today's Refugees Become the 'New Palestinians'?", *The RAND Blog*, tetor 2015.

¹¹⁴ A. Frangi, *PLO und Palästina. Vergangenheit und Gegenwart* (Frankfurt: Fischer-Verlag, 1982), fq. 123.

¹¹⁵ B. M. Jenkins, "Will Today's Refugees Become the 'New Palestinians'?", op. cit.

¹¹⁶ M. Yahya, "Refugees and the Making of an Arab Regional Disorder", *Carnegie Middle East Center*, [http://carnegiemec.org/2015/11/09/refugees-and-making-of-arab-regional-disorder/ilb0.](http://carnegiemec.org/2015/11/09/refugees-and-making-of-arab-regional-disorder/ilb0;); A. Frangi, *PLO und Palästina. Vergangenheit und*

palestinezëve iu bë e qartë se mbas luftës gjashtëditore në vitin 1967, shtetet arabe nuk ishin më të gatshme por dhe të paafta për të rimarrë tokën e tyre për ta, disa grupe palestineze iu drejtuan operacioneve komando që në përgjithësi morën formën e sulmeve terroriste në vendbanimet izraelite.¹¹⁷

Megjithatë, konfrontimi më i përgjakshëm ishte me një nga vendet pritëse të refugjatëve palestinezë. Në Jordani, ku gjysma e popullsisë përbëhej nga palestinezë në mërgim, formacione të armatosura palestineze sfiduan monarkinë Hashemite dhe kërkuan përmbysjen e saj. Pas një serie përleshjesh midis shtatorit 1970 dhe korrikut 1971, palestinezët *fedayeen* u mposhtën bindshëm dhe 30,000 palestinezë, kryesisht civilë në kampet prej tendash, humbën jetën.¹¹⁸ Nga kjo humbje u krijua një krah edhe më ekstrem i rezistencës palestineze – Shtatori i Zi. Viktima e parë e tij ishte Kryeministri jordanez Wasfi Tall: ai u vra nga një celulë palestineze në Kajro, më 28 nëntor 1971.¹¹⁹

Shumica e militantëve të rezistencës së armatosur palestineze kishin lëvizur më pas në Liban nga ku filluan sulmet terroriste ndërkohë që destabilizonin Libanin. Nga mesi i viteve 1970, prania e tyre shtetbrenda-shtetit çoi në luftën e parë civile libaneze (1975/76) e cila do të zgjaste 18 muaj dhe do të kushtonte 60,000 jetë njerëzish. Kampet e refugjatëve palestinezë e kishin larguar kontrollin e vendeve pritëse (Jordania dhe Libani) në masë të madhe dhe elementët ekstremistë që përfshiheshin në terrorizëm kërcënuan Izraelin, shkaktuan represion dhe luftëra civile në Jordani dhe Liban, po ashtu shkaktuan disa ndërhyrje izraelite si dhe një ndërhyrje siriane. Militantët palestinezë u angazhuan gjithashtu në terrorizmin ndërkombëtar në Evropë dhe më gjerë.¹²⁰

Sot Libani përjeton sërish pasojat e një konflikti, ngjashëm me përvojën e Jordanisë pas vitit 1948. Popullsia e refugjatëve sirianë të Libanit tani

Gegenwart (1982), fq.123 fq.126 & fq. 146; B. M. Jenkins, "Will Today's Refugees Become the 'New Palestinians'?", *The RAND Blog*.

¹¹⁷ A. Frangi, *PLO und Palästina. Vergangenheit und Gegenwart* (1982), fq.123.

¹¹⁸ A. Frangi, *PLO und Palästina. Vergangenheit und Gegenwart* (1982), fq. 163.

¹¹⁹ *Ibid.*, fq.167.

¹²⁰ *Ibid.*; J.Blanchard. "Officials warn 20,000 ISIS jihadists 'have infiltrated Syrian refugee camps' *Mirror*, 19 nëntor 2015, <http://www.mirror.co.uk/news/uk-news/officials-warn-20000-isis-jihadis-6443516>

arrin pothuajse një të katërtën e popullsisë së përgjithshme të vendit dhe po përballet përsëri me destabilizimin nga kampet e refugjatëve. Në fund të vitit 2015, Elias Bou Saab, ministri i arsimit të Libanit, pretendoi se të paktën 20,000 xhihadistë ishin infiltruar në kampet e refugjatëve në vendin e tij.¹²¹

Në vitin 2015 në kampet e Libanit ishin 1.1 milion sirianë, dhe në kampet e Jordanisë ishin afërsisht 619.000 Sirianë, ku më shumë se gjysma e tyre ishin nën 18 vjeç.¹²² Një punonjës i ndihmës në një kamp refugjatësh të OKB-së në Jordani theksoi se:

Bandat myslimane vijnë si refugjatë, por ata kanë axhendat e tyre. Ata janë si mafia. Ka edhe njerëz që vriten brenda kampeve...(…) kampet janë të rrezikshëm sepse ata kanë milici irakiane dhe siriane të ISIS. Është vend tjetër për bandat...(…) ata vrasin brenda kampeve, dhe ata blejnë dhe shesin gra madje edhe vajza.¹²³

Histori të ngjashme rreth milicive të armatosura kalojnë nga Turqia. Kjo është deklarata që një i dëmtuar nga ISIS, Abu Jamal, i tregoi dy hulumtuesve rreth një kampi turk refugjatësh:

Abu Jamal vlerësoi se kampi i refugjatëve në Akçakale kishte rreth tridhjetë mijë refugjatë, kryesisht arabë. Ai tha se në betejën e Kobanit u konstatua se shumë nga anëtarët e vrarë të ISIS në fakt mbanin ID-të e Kampit të Akçakale në trupin e tyre. Ai vazhdoi duke thënë se ka rreth njëzet grupe në kampin

¹²¹ H. Roberts, "ISIS threatens to send 500,000 migrants to Europe as a 'psychological weapon' in chilling echo of Gaddafi's prophecy that the Mediterranean 'will become a sea of chaos'" *The Daily Mail* <http://www.dailymail.co.uk/news/article-2958517/The-Mediterranean-sea-chaos-Gaddafi-s-chilling-prophecy-interview-ISIS-threatens-send-500-000-migrants-Europe-psychological-weapon-bombed.html>

¹²² M. Yahya, "Refugees and the Making of an Arab Regional Disorder", *Carnegie Middle East Center*, <http://carnegie-mec.org/2015/11/09/refugees-and-making-of-arab-regional-disorder/ilb0>.

¹²³ N. Gutteridge, "Heading for Britain: ISIS sends Assassins into UN refugee camps to murder Christians", *Express*, 24 tetor 2015, www.express.co.uk/news/world/614249/ISIS-sends-ASSASSINS-UN-refugee-camps-could-come-Britain.

Akçakale ku secili grup ka xhaminë e vet dhe imamin e vet arab ose ndonjë predikues jozyrtar. Jamal deklaroi se disa prej tyre rekrutojnë njerëz për ISIS-in brenda kampit. Si rezultat, djemtë e rinj largohen nga kampet për t'u bashkuar me ISIS. "Këta sheikë predikojnë se xhihadi është *farz ayn* [një përgjegjësi e detyrueshme individuale] për çdo njeri sirian sipas Islamit, përderisa Siria është në luftë," tha Abu Jamal. Po ashtu ai insistoi ... se rekrutuesit e ISIS ushtrojnë presion dhe i kërcënojnë njerëzit që të bashkohen me ta pa dijeninë e autoriteteve të kampit. "Ata të sigurojnë se nëse vdes në betejë, ata do të kujdesen për familjen tuaj. Nëse nuk dëshironi të bashkoheni me ISIS, atëherë ju duhet të ikni nga kampi. Ata nuk do t'ju lenë vetëm. "(...) Informatorët tanë na treguan disa histori ku djemve të rinj u flitej për t'u bashkuar me ISIS dhe më pas ata largoheshin nga familjet e tyre. Të gjithë ata përfunduan të vdekur – duke kryer misione vetëvrasëse.¹²⁴

Provat anekdotike i lidhin gjithashtu edhe kampet e tjera të refugjatëve me rekrutimin terrorist, p.sh. në Kenia ku gjetën strehim afërsisht gjysmë milion refugjatë somalezë. Disa prej tyre bëhen objektiva për t'u rekrutuar në përpjekjet e forcave kundërshtare në luftën civile. Në rastin e sulmit terrorist në qendrën tregtare Westgate të Nairobit më 21 shtator 2013, sipas raporteve të shtypit një nga autorët ishte një refugjat nga kampi i Kakumës. Një i dyshuar tjetër në atë sulm duket se bëri një telefonatë me dikë në Dadaab, i cili është kampi më i madh i refugjatëve somalezë në Kenia.¹²⁵ Në atë sulm vdiqën 67 vetë, ndërsa 175 u plagosën nga katër terroristët. Militantët nga al-Shabaab, si dhe disa nga ata që kundërshtojnë al-Shabaab, rekrutojnë në kampe si Dadaab, nganjëherë nën pretendime të rreme, duke u premtuar të rinjve naivë premtime të cilat nuk i mbajnë. Siç tha studiuesja e Human Rights Watch, Letta Tayler: "Djemtë dhe burrat që janë në këto kampe rrezikuan jetën e tyre për të ikur. Tani atyre i kërkohet që të kthehen përsëri aty (...) Rekrutimi

¹²⁴ A. Speckhard and A. Yayla, "Defectors from ISIS: Why They Joined, What They Saw, Why They Left", *Perspectives on Terrorism*, Vëll. IX, numri 6 (2015), fq.109, www.terrorismanalysts.com.

¹²⁵ Barbara Sude et al., "Lessening the Risk of Refugee Radicalization", *RAND Perspective*, 2015, fq.3, <http://www.rand.org/pubs/perspectives/PE166.html>,

i luftëtarëve në kampet e refugjatëve minon edhe qëllimin e tyre thelbësor, që të shërbejë si një vend strehimi nga konflikti “.¹²⁶

Jo vetëm grupet e armatosura jo-shtetërore por edhe qeveritë njihen për përdorimin e kampeve të refugjatëve për rekrutimin e luftëtarëve.

Në një sondazh të radikalizmit të refugjatëve, Barbare Sude dhe kolegët e saj theksuan në vitin 2015:

Vendi pritës, ndonjëherë me bashkëpunimin e organizatave ndërkombëtare të ndihmës, mund edhe të inkurajojë në mënyrë direkte ose indirekte radikalizmin duke lejuar fraksione grupesh militante të marrin pjesë zyrtarisht në përpjekje humanitare duke mbështetur grupe të veçanta dhe/ose ndërmarrjen e veprimeve ushtarake në vendin e origjinës së refugjatëve(...) rreziku i radikalizmit mund të jetë më i madh nëse vendi pritës është i paafte ose nuk ka dëshirë të mbështesë kampet dhe zonat rrethuese. Është më keq nëse grupet e militantëve marrin nën zotërim sigurinë e kampeve dhe/ose janë në gjendje të kalojnë në vendin e origjinës për aktivitete të armatosura.¹²⁷

Situata të tilla të radikalizmit dhe rekrutimit në kampet e refugjatëve nuk janë të rralla (shiko Tabela 14).

Tabela 14: Radikalizmi në Kampet e Refugjatëve – Rastet e Zgjedhura

- 1) Refugjatët palestinezë në Lindjen e Mesme, veçanërisht në Liban, 1967-1993: grupe të radikalizuara morën nën kontroll kampet e Libanit; ndërmorën sulme ndërkufitare;
- 2) Refugjatët afganë në Pakistan dhe Iran, 1978-1988: fillimisht radikalizim i vogël, i ndjekur nga rekrutimi i drejtpërdrejtë në grupet militante;
- 3) Refugjatët afganë në Pakistan dhe Iran gjatë viteve 1990: rekrutimi radikal rritet dhe eksportohet;
- 4) Refugjatët somalezë në Kenia, vitet 1990-2000: grupe radikale aktive brenda kampeve në periudha të ndryshme;

¹²⁶ M. Basu, “Right group urges Kenya to stop military recruitment of refugees”, *CNN*, 6 nëntor 2009;
<http://edition.cnn.com/2009/WORLD/africa/10/25/intl.kenya.refugee.recruitment/index.html?iref=24hours>.

¹²⁷ Ibid, fq. 5.

- 5) Refugjatët nga Ruanda në RDK, vitet 1990-2000: grupet e radikalizuara kontrollojnë kampet; ndërmarrin sulme ndërkufitare; dhuna shpërndahe në rajon

Burimi: Përshtatur nga: Barbara Sude, David Stebbins, dhe Sarah Weiland. Lessening the Risk of Refugee Radicalization. RAND Perspective, 2015, fq.3.,
<http://www.rand.org/pubs/perspectives/PE166.html>; accessed 28 January 2016.

Radikalizimi ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimi për grupet terroriste bëhet më i mundshëm kur kampet e refugjatëve janë në kontakt të drejtpërdrejtë me luftëtarët nga një konflikt i vazhdueshëm. Tundimi për t'u bashkuar me luftën në vend që të presin në dëshpërim është e vërtetë për shumë të rinj, veçanërisht kur refugjatët nuk mund të arsimohen ose punësohen dhe qendrojnë të izoluar në kampe për vite me radhë.¹²⁸

Kur në vitet 1980 miliona afganë u larguan nga okupimi sovjetik i Afganistanit, shumë përfunduan në kampet e refugjatëve në Pakistan. Disa prej këtyre kampeve u bënë baza rekrutimi për muxhahidinët. Ata gjithashtu ofruan mundësi rekrutimi për shtetet e huaja dhe agjencitë e inteligjencës të cilat kërkonin të instrumentalizonin refugjatët për qëllimet e tyre. Në kampet pakistaneze si kampi Jaloza pranë Peshawar, meshkujt e rinj u rekrutuan nga intelijenca pakistaneze dhe CIA amerikane.¹²⁹ Në vitin 1989, pasi trupat sovjetike u larguan nga Afganistani dhe vendosën në vendin e tyre qeverinë kukull me në krye Mohammad Najibullah, zyrtarët e inteligjencës amerikane dhe pakistaneze rekrutuan të rinj nga kampet afgane të refugjatëve në Pakistan dhe j'u ofruan këta luftëtarë kryekomandantëve si Gulbuddin Hekmatyar kundër regjimit Najibullah. Siç e quajti më vonë diplomati amerikan McWilliams: “ Në fund ata përfunduan duke zbrazur kampet e

¹²⁸ F. Martin-Rayó, “Countering Radicalisation in Refugee Camps” in K. Koser and A. E. Cunningham *Migration, Violent Extremism and Terrorism: Myths and Realities*, fq. 84. in Institute for Economics & Peace, *Global Terrorism Index 2015. Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (2015),

¹²⁹ K. Koser and A. E. Cunningham *Migration, Violent Extremism and Terrorism: Myths and Realities*, fq. 84. in Institute for Economics & Peace, *Global Terrorism Index 2015. Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (2015).

refugjatëve ... Kjo ishte përpjekja e fundit për të hedhur këta gjashtëmbëdhjetë vjeçarë në luftë në mënyrë që të vazhdonin këtë gjë. Ajo nuk funksionoi “. ¹³⁰ Në vend të warlords, Afganistani mori talebanët në vitin 1996. Deri në mes të vitit 2015 Hekmatyar i këshilloi mbështetësit e tij për të mbështetur” Shtetin Islamik “. ¹³¹

Shteti Islamik jo vetëm që u përpoq të ngrinte një provincë të re në Khorasan (emri i vjetër për Afganistanin e madh) por gjithashtu u përpoq të depërtojë në kampet palestineze të refugjatëve në Siri. Një nga këto është kampi i refugjatëve Yarmouk, i cili është vetëm disa kilometra larg Damaskut.

Në vitin 2015, ISIS u përpoq të merrte përsipër kampet, ndoshta duke shpresuar që të fitonte përkrahës të gatshëm në mesin e 18,000 banorëve të kampit (që përfshinte, përveç palestinezëve, edhe sirianë të zhvendosur). Kur regjimi sirian kundërsulmoi ISIS-in, përdori popullsinë e refugjatëve, duke përfshirë 3,500 fëmijë , si mburoja njerëzore. ¹³² Regjimi i Asadit ka sulmuar gjithashtu kampet e refugjatëve në Siri. Në një nga këto sulme më 5 maj 2016, 28 persona, duke përfshirë gra dhe fëmijë u vranë në një sulm ajror ndërsa 50 të tjerë u plagosën në kampin Kamouna, 10 kilometra nga kufiri turk. ¹³³

Këto nuk janë rastet e vetme ku janë sulmuar kampet e refugjatëve. Në më shumë se gjashtë vjet terrorizëm dhe luftë jokonvencionale, Boko Harami detyroi më shumë se 2.600.000 të largohen nga shtëpitë e tyre. ¹³⁴

¹³⁰ A. Cockburn, “A Special Relationship. The United States is teaming up with Al Qaeda again”, *Harper’s Magazine*, numri janar 2016, <http://harpers.org/archive/2016/01/a-special-relationship/2/>.

¹³¹ T. .Khan, “Enemy of enemy: Hekmatyar support for IS stuns observers”, *The Express Tribune*, 7 korrik 2015, <http://tribune.com.pk/story/916168/enemy-of-enemy-hekmatyar-support-for-is-stuns-observers/>.

¹³² K. Koser and A. E. Cunningham *Migration, Violent Extremism and Terrorism: Myths and Realities*, fq. 84. in Institute for Economics & Peace, *Global Terrorism Index 2015.Measuring and Understanding the Impact of Terrorism* (2015).

¹³³ “Syria conflict: “Air strike on refugee camp ‘could be war crime’”, *BBC*, www.bbc.com/news/world-middle-east-362118997.

¹³⁴ “Surviving Nigeria’s Boko Haram”, *BBC* <http://www.bbc.com/news/world-africa-35241610>;

Megjithatë, ky nuk ishte fundi: Boko Harami madje kreu persekutime në kampet e refugjatëve. Më 9 shkurt 2016, dy vajza të reja me bomba vetëvrasëse vranë 58 vetë dhe lënduan rëndë 78 të tjerë në kampin e refugjatëve Dikwa, një kamp që strehonte më shumë se 53,000 njerëz, të vendosur 85 km në verilindje të Maiduguri, kryeqyteti i shtetit federal të Borno në veri të Nigerisë. Autorja e tretë me bomba vetëvrasëse, ndryshoi mendje në momentin e fundit, dhe shpjegoi se nuk donte të shihte prindërit e saj (që ishin refugjatë në kamp) të vriteshin.¹³⁵

Për vendet që marrin një numër të madh refugjatësh rritet rreziku i sulmeve terroriste nga “refugjatët luftëtarë”, dhe në anën tjetër nga vigjilentët ksenofobë vendas që shënjestrojnë popullsinë e refugjatëve. Një analizë ndërshtetërore e të dhënave sipas periudhave kohore të 154 shteteve që mbulon periudhën 1970-2007 zbuloi se vendet me më shumë refugjatë kanë më shumë gjasa të përjetojnë terrorizmin vendas dhe ndërkombëtar.¹³⁶ Një studim tjetër zbuloi se “flukset e refugjatëve rrisin dukshëm gjasat dhe kryerjen e sulmeve terroriste mbishtetërore që ndodhin në vendin pritës, edhe kur kontrollojnë për variabla të tjera.”¹³⁷

Roli i Diasporave

Ndërsa kampet e refugjatëve janë zakonisht zona të mbyllura larg qendrave të popullsisë të vendeve pritëse, disa prej atyre që largohen nga vendi i tyre për arsye politike jetojnë ligjërisht në vendet pritëse dhe

“Buhari says MTN fuelled Boko Haram insurgency”, *Joy online*, <http://www.myjoyonline.com/world/2016/March-9th/buhari-says-mtn-fuelled-boko-haram-insurgency.php>.

¹³⁵ B. Akinsola. “Captured Boko Haram Female Suicide Bomber: Why I Didn’t Want to Detonate My Own Explosives”, *Naija 247 News*, <http://counteredreport.co.uk/news/captured-boko-haram-female-suicide-bomber-why-i-didnt-want-to-detonate-my-own-explosives>. ; A. Soy, “How I almost became a Boko Haram suicide bomber” BBC, <http://www.bbc.co.uk/news/world-africa-35864054>.

¹³⁶ S.-W. Choi and I. Salehyan. “No Good Deed Goes Unpunished: Refugees, Humanitarian Aid, and Terrorism”, *Conflict Management and Peace Science*, Vëll. 30, Nr.1, 2016, fq.53.

¹³⁷ R. L. Reinoud, “Refugee Warriors or War Refugees? Iraqi Refugees’ Predicament in Syria, Jordan and Lebanon”, *Mediterranean Politics*, Vol. 14, numri 3, 2009, fq.343.

formojnë diaspora, kryesisht në zonat urbane. Atyre u bashkangjiten bashkatdhetarët që vijnë në Perëndim si anëtarë të familjes (p.sh. përmes martesave që mundësojnë emigrimin në Perëndim), si studentë apo në ndonjë kapacitet tjetër.

Kur largohen nga vendi i tyre i origjinës, emigrantët rrallëherë janë në gjendje të lënë pas të kaluarën. Antipatitë që sollën konfliktin në vendin e origjinës shpesh vazhdojnë në vendin e ri pritës - konfliktet janë bërë të lëvizshëm. Për shembull, shumë indianë dhe pakistanezë kanë sjellë konfliktin ndërmjet vendeve të tyre të origjinës me vete në Mbretërinë e Bashkuar. Kur fuqia koloniale britanike u largua nga India në 1947/48, ajo kishte rregulluar një ndarje që zhvendosi më shumë se 15 milionë njerëz dhe çoi në masakrat e një-dy milionë indianëve dhe pakistanezëve¹³⁸, duke lënë plagë traumatike tek njerëzit e të dyja anëve. Shumë pakistanezë dhe indianë, madje edhe ata jashtë vendit, ende e trajtojnë njëri-tjetrin pothuajse si armiq.¹³⁹

Kur represioni shtetëror e jo lufta i ka nxitur njerëzit jashtë vendit, refugjatët shpesh përpiqen të mobilizojnë palë të treta kundër armikut të tyre në shtëpi, p.sh. duke kërkuar mbështetjen e qeverisë pritëse, partive politike apo sektorëve të shoqërisë civile si aleatë (p.sh. lobi kuban anti-Kastro në Florida). Ndonjëherë emigrantët ekonomikë dhe refugjatët politikë nga të dy anët e një konflikti në shtëpi janë të pranishëm në vendin pritës dhe vazhdojnë konfliktin e tyre. Për shembull, kjo ka ndodhur në Gjermani midis turqve dhe kurdëve.

Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (PKK) ka përdorur Gjermaninë për ngritjen e fondeve dhe për rekrutimin e aktivistëve të rinj të cilët janë dërguar si luftëtarë në rajonin malor në Irakun e veriut, si dhe në Turqinë lindore. Në të njëjtën kohë, militantët kurdë kanë organizuar vazhdimisht sulme në Gjermani, si kundër ambasadave turke dhe kundër shtetasve gjermanë.¹⁴⁰

¹³⁸ W. Dalrymple, "The Great Divide", *The New Yorker*, 29 qershor 2015
<http://www.newyorker.com/magazine/2015/06/29/the-great-divide-books-dalrymple>.

¹³⁹ Personal observation, based on conversations with Indians and Pakistanis.

¹⁴⁰ H.-P. Raddatz, *Die türkische Gefahr? Risiken und Chancen* (München: Hernig, 2007), fq. 138.

Në diaspora ka edhe studentë të sapoardhur nga vendi i origjinës të cilët shpesh angazhohen në aktivizëm politik. Ata mund të jenë radikalizuar në vendin pritës, si rezultat i vizitave të xhamive selefiste ose pas takimeve me veteranët afganë. I tillë ishte rasti i grupit të Hamburgut që formoi bërthamën e ekipit të sulmit të al-Kaedës më 11 shtator 2001. Hamburgu me xhaminë e tij al-Quds nuk ishte qendra e vetme e konspiracioneve nga terroristët në diasporat evropiane. Shumë xhihadistë u rritën në Londër, aq shumë sa që kryeqyteti britanik u quajt “Londonistan”. Cituar nga historia e *Terrorizmit Islamik në Evropë* të Petter Nesser:

Londra ishte në qendër të nënkulturës së xhihadit në Evropë. Nga kryeqyteti britanik një masë kritike e predikuesve radikalë që kishin kaluar kohë në Af-Pak [Afganistan-Pakistan], Bosnjë dhe zona të tjera të konfliktit, vepruan si udhëheqës dhe rekrutues brenda një skene në rritje të xhihadit. Këta militantë veteranë vepruan gjithashtu si guida fetare për grupe të huaja të armatosura. Zyrtarët francezë të sigurisë shpikën emrin “Londonistan” pjesërisht për shkak të shumë xhihadistëve në Londër dhe pjesërisht për shkak se qyteti u bë një stacion tranzit për rekrutët që shkonin në kampet e trajnimit në Afganistan. “Londonistani” u bë zhargon për tendencën e autoriteteve britanike për të bërë një sy të verbër ndaj ekstremizmit dhe për të ofruar strehë për terroristët. (...) Megjithatë, ndërkohë që rëndësia e Londrës nuk mund të ekzagjerohet, rrjetet xhihadiste u shfaqën gjithashtu në të gjithë Britaninë dhe pjesën tjetër të Evropës.¹⁴¹

Këto rrjete vazhdojnë deri në ditët e sotme dhe disa prej tyre janë forcuar siç janë rritur në madhësi edhe diasporat myslimane në Perëndim (p.sh. Molenbeek, një lagje e Brukselit). Ndërsa gjenerata e parë e emigrantëve myslimanë në Evropë - në shumë raste emigrantët e punës - ishte kryesisht konservatore dhe shpesh apolitike, fëmijët e tyre - gjenerata e dytë - shpesh e gjeti veten të paaftë për t'u integruar në shoqërinë pritëse. Megjithatë, këta fëmijë të baballarëve myslimanë nga Afrika e Veriut dhe Lindja e Mesme gjithashtu e kanë të vështirë të identifikohen me

¹⁴¹ P. Nesser, *Islamist Terrorism in Europe. A History*, (Londër: Hurst, 2015), fq.37.

pikëpamjet tradicionale të baballarëve të tyre.¹⁴² Mijëra prej tyre u radikalizuan dhe filluan të identifikoheshin me xhihadistët në Afganistan, Çeçeni, Irak, Somali dhe Siri. Këto konflikte shpesh prekën një akord reagues me myslimanë të rinj rebelë, dhe me të konvertuarit rishtazi në Islam, veçanërisht kur vendi pritës dhe qeveria autoritare e atdheut të etërve të tyre ishin në kushte të mira me njëri-tjetrin, siç ishte (dhe është) për shembull, çështja me Britaninë e Madhe dhe Arabinë Saudite.¹⁴³

Mediat me baza satelitore dhe mediat sociale me baza në internet i lejojnë myslimanët e rinj në Perëndim të lidhen me ata që luftojnë kundër regjimeve shtypëse në botën myslimane.¹⁴⁴ Ndërsa ndërhyrja amerikane në Afganistan në prag të sulmeve të 11 shtatorit i tërhoqi disa prej tyre në xhihadizëm militant, pushtimi i pajustificuar i Irakut në vitin 2003 bindi shumë të tjerë se vetë islami ishte nën sulm dhe duhej të mbrohej brenda dhe jashtë vendit.

Pranvera Arabe e vitit 2011 e ngriti më shumë vetëdijen politike dhe kur protestat masive popullore në Egjipt, Siri dhe gjetkë në botën arabe u shtypën brutalisht, shumë njerëz u bindën se ndryshimi i padhunshëm nuk ishte i mundur. Situatat e ndezura të mizorive të regjimit të Asadit forcuan bindjen e shumë myslimanëve të rinj në Perëndim se kryengritja sunite duhej të mbështetej me më shumë se sa vetëm fjalë. Ndërkohë që vala e parë e luftëtarëve të huaj arriti në Siri në vitin 2012 dhe 2013, ishte shpallja e një kalifati të ri në mesin e vitit 2014 që solli një rritje të jashtëzakonshme të numrit të atyre që udhëtonin nga diasporat perëndimorë drejt Sirisë (shih Tabela 14 më poshtë).

Luftëtarët e huaj nga diasporat Perëndimore (6.000+) ishin më të shumtë në numër se ata që u larguan nga territoret e Bashkimit Sovjetik (4.700) ose nga Azia Juglindore (900), por ishin më të paktë se ata me origjinë

¹⁴² Një prej autorëve të dyshuar të masakrës së Muzeut Bardo në Tunizi thuhet se ka kaluar nga Libia në Itali i fshehur midis azilkërkuesve të zakonshëm.

¹⁴³ B. Baser, B. Abstract to: Inherited Conflicts: Spaces of contention between second-generation Turkish and Kurdish diasporas in Sweden and Germany [thesis] (Florence: European University Institute, 2012), <http://hdl.handle.net/1814/35197>.

¹⁴⁴ N. Prucha, *Online Territories of Terror – How Jihadist Movements Project Influence on the Internet and Why it Matters Offline*, (Vienna: University of Vienna, 2015), fq. 180.

nga Magrebi (8.000) ose Lindja e Mesme (8.245).¹⁴⁵ Ajo që i mblodhi ata së bashku ishte një ideologji e fuqishme (“Islami është sulmuar dhe është detyrë e çdo myslimani ta mbrojë atë”) dhe ekzistenca e një pike të kristalizimit organizativ (Kalifati i ri), i mbushur me para të plaçkitura nga banka qendrore e Mosulit. Këto ishin arsytet e emigrimit të madh të myslimanëve të rinj në Siri, me luftëtarë të huaj që vinin nga më shumë se 100 vende. Ndërkohë që mbërritja e tyre në Siri dhe në Irak përkeqësoi luftimet, më shumë njerëz filluan të lëvizin në drejtim të kundërt, duke emigruar drejt Evropës për t’u arratisur nga terrorizmi dhe lufta.

Ksenofobia e Vendit Pritës si Shkaktar i Terrorizmit

Në momentin që azilkërkuesit, refugjatët dhe emigrantët e tjerë arrijnë në një vend pritës në numër të madh, bashkë me ta vjen dhe rezistenca lokale ksenofobike. Kjo merr dy drejtime: targetimi i azilkërkuesëve dhe emigrantëve ekonomikë nga njëra anë dhe targetimi i liberalëve dhe socialdemokratëve që i mirëpresin ata nga ana tjetër. Rezistenca ksenofobike ndaj emigrantëve ekonomikë dhe azilkërkuesve në Evropë ka marrë kryesisht formën e sulmeve zjarrvënëse me bomba molotov në qendrat e azilit.

Në Austri, Bullgari, Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Letoni, Maqedoni, Holandë, Poloni, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar kanë ndodhur sulme zjarrvënëse dhe të ngjashme me to përfshirë shufra hekuri, sëpata dhe thika.¹⁴⁶ Suedia e cila vetëm në vitin 2015 ka marrë më shumë se 160,000 azilkërkues (duke përfshirë 35,000 të mitur të pashoqëruar) ka përjetuar rreth 50 sulme kundër azilkërkuesve - më shumë se në katër vitet e mëparshme së bashku.¹⁴⁷

Autoritetet gjermane raportuan për vitin 2015 më shumë se 900 incidente ksenofobike - 30 përqind më shumë se në vitin 2014. Pothuajse 700 vetë

¹⁴⁵ L. Karklis, *The Washington Post*, bazuar në The Soufan Group.

¹⁴⁶ *Migrant smuggling in the EU*, (The Hague: Europol, 2016), fq. 12-13.

¹⁴⁷ C. Wikstrom. “Sweden details Poles over plot to attack asylum centre”, *Al Jazeera*, <http://www.aljazeera.com/news/2016/02/swedendetains-poles-plot-attack-asylum-centre-160210092606548.html> ; *Impact of the refugee crisis on the risk of radicalisation and consequences for prevention policies*, (Vienna: Radicalisation Awareness Network, 2016), fq.18.

u plagosën në incidente të tilla.¹⁴⁸ A mund të konsiderohet kjo dhunë politike e grupeve të djathta dhe ksenofobike si terrorizëm? Termi terrorizëm shpesh rezervohet në diskursin publik vetëm për sulmet xhihadiste islamike. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë arsye të mirëqenë për të mos i quajtur këto sulme si akte terroriste. Robin Schroeder (Universiteti Kiel) ka krahasuar elementet e përkufizimeve më të përdorura të terrorizmit si dhe atë të përdorur nga qeveria gjermane me karakteristikat e disa prej këtyre sulmeve në qendrat e azilit - më shumë se 200 sulme zjarrvënëse në qendrat e refugjatëve për vitin 2015 vetëm në Gjermani¹⁴⁹ - ai konkludoi:

Kur dikush krahason ... elementet kryesore të përkufizimeve shkencore të terrorizmit me ... sulmet aktuale zjarrvënëse në shtëpitë e refugjatëve, arrin në përfundimin e mëposhtëm: qëllimi i sulmeve është politik, zgjedhja e viktimave është e rastësishme dhe qëllimi i sulmeve është shumë i qartë dhe ka për qëllim komunikimin e mesazheve ksenofobike. Mesazhi është drejtuar si një kërcënim për grupin shoqëror të refugjatëve, si një mesazh i dhunshëm i rezistencës ai adreson vendimmarrësit politikë dhe si një thirrje për mobilizim ai synon njerëzit e një mendjeje politikisht në shoqëri. Që kjo thirrje godet një akord të përgjegjshëm është treguar nga numri në rritje i sulmeve zjarrvënëse në shtëpitë e banuara nga refugjatët. Kjo e bën të qartë se nga një perspektivë sociale shkencore kjo vepër mund të quhet si akt terrorist.¹⁵⁰

Mungesa e dhembshurisë në disa sektorë të shoqërive pritëse me ata që kanë shpëtuar nga lufta civile, dështimi i shtetit, represioni shtetëror ose terrorizmi kryengritës në vendet e tyre të origjinës është një çështje

¹⁴⁸ *De Telegraaf*, 11 shkurt 2016. Shifrat provizore për vitin 2015 të siguruar nga Ministria e Brendshme Gjermane.

¹⁴⁹ S. Lenos, *The Refugee and Migrant Crisis and challenges for CVE. Preventing polarization, recruitment and radicalization* (Vienë: Radicalisation Awareness Network, 2016), fq. 3.

¹⁵⁰ R. Schroeder, "Alles, bloss kein Terrorismus", *Sicherheitspolitik-blog*, <http://www.sicherheitspolitik-blog.de/2015/10/26/alles-bloss-kein-terrorismus/#more-73666> [përkthim nga APS]

shqetësuese. Shfrytëzimi i saj i qëllimshëm nga drejtuesit demagogë të krahut të djathtë dhe politikanët populistë i bën gjërat më keq.

Ndonjëherë aktorët e vetëm dhe grupet e krahut të djathtë sulmojnë jo vetëm refugjatët, por edhe ata (zakonisht socialdemokratët dhe liberalët) që janë të gatshëm t'i mirëpresin, e janë të gatshëm t'i ofrojnë strehim. Shembulli më i keq i kësaj ka qenë sulmi i dyfishtë i Anders Behring Breivik, një autor i vetëm, në Norvegji më 22 korrik 2011.

Pas shpërthimit të bombës në rajonin qeveritar të Oslos (i cili vrau tetë vetë), autori i krahut të djathtë vazhdoi në ishullin e Utoya ku vrau 69 të rinj të Lidhjes Rinore të Punëtorëve me armë, ndërsa plagosi 66 të tjerë. Ai deklaroi se qëllimi i tij ishte që nëpërmjet masakrës të shpëtonte Norvegjinë dhe Evropën Perëndimore nga dominimi i myslimanëve dhe se Partia Laburiste duhej të “paguante çmimin” për “braktisjen e Norvegjisë dhe të popullit norvegjez”.¹⁵¹

Në të kaluarën ka pasur luftime edhe midis grupeve të krahut të djathtë dhe grupeve anti-fashiste të krahut të majtë në shtete të ndryshme evropiane. Deri vonë, pak prej tyre ishin motivuar drejtpërsëdrejti nga çështja e emigrimit. Sidoqoftë, pasi përbërja demografike e vendeve pritëse në disa zona urbane ndryshon nën ndikimin e emigrimit të parregullt, polarizimi midis grupeve nacionaliste dhe atyre internacionaliste mund edhe të çojë në veprime terrorizmi “horizontale” midis tyre.

Duke parë disa prej shkaqeve të mundshme të terrorizmit dhe emigrimit, le të shohim tani marrëdhënien e drejtpërdrejtë midis emigrantëve dhe terroristëve.

Emigrantët si Terroristë? Terroristët si Emigrantë?

Organizatat për të drejtat e njeriut na paralajmërojnë se nuk duhet të ngatërrojmë apo asociojmë refugjatët me terroristët, pasi me përjashtim të disa rasteve, edhe ata janë viktima të terrorizmit. Kjo është një pikë e vlefshme dhe përgjithësisht e vërtetë, por siç ndodh rëndom realiteti

¹⁵¹ Cit. Arbeiderpartiet har sveket landet og prisen fikk de betale fredag"check(in Norwegian). Nrk.no.; siç citohet në Lemma "Breivik" në Wikipedia (engl.);aksesuar 6 mars 2016.

është më kompleks. Emigrantët mund të bëhen terroristë (refugjatë luftëtarë) dhe anasjelltas ose të dyja në të njëjtën kohë. Disa shembuj të këtij kompleksiteti:

Emigrimi në Gjurmët e Profetit

Kur Kalifati u shpall në mes të vitit 2014, kreu i Shtetit Islamik, Ebu Bekr el-Bagdadi u kujtoi myslimanëve se Profeti u shpërngul nga Meka në Medinë për shkak të besimit të tij. Fjala arabe për këtë migrim është *hixhret*. Kalifi i ri pohoi se tani ishte detyrë e çdo myslimani të bënte një emigrim të ngjashëm në Kalifatin dhe të ndihmonte në ndërtimin e Shtetit Islamik.¹⁵² Thirrja e tij u dëgjua dhe mijëra luftëtarë të huaj (si dhe mbështetëse femra të Kalifatit) emigruan drejt Sirisë dhe Irakut. Në total, rreth 30,000 luftëtarë të huaj nga më shumë se 100 vende shkuan në Siri që nga viti 2012.¹⁵³ Çuditërisht, një pjesë e madhe e atyre që u shpërngulën drejt Kalifatit kishin dosje penale para se të largoheshin nga Evropa ndonëse disa prej tyre ishin përfshirë në terrorizëm brenda vendit¹⁵⁴. Gjatë viteve të fundit, më shumë se gjashtë mijë të rinj (midis tyre edhe gra) kanë emigruar nga Evropa drejt Sirisë dhe Irakut (shih Tabela 15) për t'u bashkuar me organizatat që janë etiketuar si "terroriste".

¹⁵² A.P. Schmid, "Challenging the Narrative of the "Islamic State", (The Hague: ICCT, 2015), fq. 13: "Thirrja për të kryer hixhret- që do të thotë emigrim dhe tërheqje nga një shoqëri jo-islame drejt një myslimane - është një nga instrumentet më të fuqishme të traditës islame, pasi ajo nënkupton ndjekjen e gjurmëve të Profetit. ISIS e përdor dinakërisht këtë për të joshur myslimanët e rinj të pambrojtur në projektin e ndërtimit të shtetit. Është një parim standard i selefizmit militant se xhihadi është detyrë personale e çdo myslimani". <http://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-the-Islamic-State-June2015.pdf>.

¹⁵³ A. P. Schmid, "Foreign (Terrorist) Fighters with IS: A European Perspective", (The Hague: ICCT, 2015), fq. 25, <http://icct.nl/wp-content/uploads/2015/12/ICCT-Schmid-Foreign-Terrorist-Fighters-with-IS-A-European-Perspective-December2015.pdf>. (Disa shifra janë përditësuar, bazuar në informacionet më të fundit të qeverisë, p.sh. në rastin e Francës.)

¹⁵⁴ Informacioni i marrë nga zyrtarët qeveritarë gjatë një konference ndërkombëtare në prill 2016.

Rreth 1,500 nga më shumë se 6,000 burra dhe gra që kishin shkuar në Siri nga vendet perëndimore, pas një “turneu të detyrës”, u kthyen nga Kalifati. Disa prej tyre ndërkohë janë angazhuar në aktet e terrorizmit në vend. Ata janë emigrantë hixhreti të cilët u kthyen në terroristë ose të paktën u përfshinë në organizata xhihadiste që përfshihen në akte terrorizmi.

Tabela 15: Luftëtarët e huaj nga njëzet vende evropiane të cilët shkuan drejt Sirisë dhe Irakut

Franca:	1.700
Gjermania:	820
Mbretëria e Bashkuar:	760
Belgjika:	470
Bosnja:	330
Holanda:	315
Austria:	300
Suedia:	300
Kosova:	232
Maqedonia:	146
Spanja:	135
Danimarka:	125
Shqipëria:	90
Italia:	87
Norvegjia:	80+
Finlanda:	70
Serbia:	70
Zvicra:	57
Mali i Zi:	38
Irlanda:	30

Total:

6.155

Burimi: Alex P. Schmid. Foreign (Terrorist) Fighters with IS: A European Perspective. The Hague: ICCT, Dhjetor 2015, fq. 25, <http://icct.nl/wp-content/uploads/2015/12/ICCT-Schmid-Foreign-Terrorist-Fighters-with-IS-A-European-Perspective-December2015.pdf>

Ata prej tyre që u kthyen në Evropë jo nga zhgënjimi, por me synimin për të kryer sulme në vendin e tyre të origjinës janë emigrantët e rikthyer të shndërruar në terroristë, duke shërbyer si kolonë e pestë e Shtetit Islamik në Perëndim. Një nga dokumentet strategjike të kapura nga Shteti Islamik e bëri të qartë se rrjedhat e refugjatëve drejt Evropës duhej të përdoshin për të infiltruar terroristë.¹⁵⁵ Refugjatët e vërtetë që largohen nga Siria e nuk bëhen pjesë e Shtetit Islamik cilësohen si “të pafë” nga udhëheqësit e ISIS.

Emigrimi nga një Teatër Konflikti Xhihadist drejt një tjetri me Xhihadistë Profesionalistë

Rritja e xhihadizmit global në 30 vitet e fundit ka çuar në një situatë ku disa xhihadistë lëvizin nga një konflikt në tjetrin, p.sh. nga Afganistani në Bosnje dhe nga atje në Çeçeni dhe më tej në Siri. Ata janë terroristë endacakë, pjesërisht sepse vendi i tyre i origjinës do t'i arrestonte nëse ata ktheheshin në shtëpi dhe pjesërisht sepse xhihadi është bërë për ta një mënyrë jetese.¹⁵⁶ Numri i këtyre emigrantëve mund të rritet pasi emrat e mijëra xhihadistëve të Shtetit Islamik janë bërë publike në mars 2016 nga një rrjedhje informacioni e një xhihadisti të zhgënjyer, duke bërë të mundur arrestimin e tyre nëse ata kthehen në vendin e tyre. Ata nuk kanë vend tjetër për të shkuar, përveçse kur shtetet u japin atyre amnisti.

¹⁵⁵ W. Von Bernd, “Die Europäische Grenzschutzagentur Frontex – Wallmeister der Festung Europas oder Garant für die Sicherheit der Außengrenzen?” *Die Kriminal Polizei* qershor 2015

<http://www.kriminalpolizei.de/ausgaben/2015/juni/detailansicht-juni/artikel/die-europaeische-grenzschutzagentur-frontex-wallmeister-der-festung-europas-oder-garant-fuer-die.html>.

¹⁵⁶ A. P. Schmid and J. Tinnes. “Foreign (Terrorist) Fighters with IS: A European Perspective”, (The Hague: ICCT, 2015), fq. 29. <http://icct.nl/publication/foreign-terrorist-fighters-with-is-a-european-perspective/>

Shumë prej këtyre luftëtarëve të huaj mund të bëhen kështu emigrantë të përhershëm, duke shkuar nga një pikë e nxehtë xhihadiste në tjetrën derisa të vdesin.

Luftëtarët e Huaj Terroristë të Rikthyer

Luftëtarët e huaj janë sipas definicionit emigrantë, por një numër i tyre janë emigrantë të rikthyer që shpesh janë radikalizuar më tej në zonat e konfliktit të xhihadit. Kur kthehen në shtëpi disa prej tyre janë “të heshtur” të cilët herët a vonë përfshihen në komplete. Një analizë e Petter Nesser për 75 komplete të ISIS në Perëndim zbuloi,

Të paktën një e treta e kompleteve në Perëndim përfshiu një luftëtar të huaj – një individ i cili ka shkuar jashtë vendit për t’u trajnuar ose luftuar në një vend të sigurt terrorist. Sidoqoftë, kjo tablo nuk është e plotë, pasi ekstremistët po ndërmarrin vazhdimisht hapa për të fshehur komunikimet e tyre, dhe së fundmi përfshirja e luftëtarëve të huaj u bë e qartë vetëm pas javësh e muajsh investigime. Këta xhihadistë me eksperiencë ishin të dyshuar, bashkëfajtorë, ose nxitës në disa dhjetëra raste të identifikuara. Më shumë se gjysma e këtyre rasteve përfshinë “të rikthyer,” luftëtarë të huaj të cilët u kthyen nga vendet e sigurta të ISIS për të shpallur sulme individuale. Kjo përfshin autorët e Parisit, autorët përgjegjës për vrasjen e turistëve në muzeun dhe resortin e Tunizisë, të dyshuarin e sulmeve në një muze hebre në Bruksel në vitin 2014, dhe më shumë.¹⁵⁷

Rreth 1.500 nga 6.000 luftëtarë të huaj evropianë, sipas raporteve të shtypit janë rikthyer në Evropë.¹⁵⁸ Luftëtarët e huaj që kthehen përdorin

¹⁵⁷ *Terror Gone Viral. Overview of the 75 ISIS-Linked Plots Against the West, 2014 – 2016.* (Washington, DC: Homeland Security Committee, 2016), fq. 8, <http://www.voanews.com/content/jihadists-caught-posing-as-refugees-fuel-alarm/3173533.html> <https://homeland.house.gov/wp-content/uploads/2016/03/Report-Terror-Gone-Viral-1.pdf>.

¹⁵⁸ A.Yuhas, “NATO commander: Isis ‘spreading like cancer’ among refugees”, *The Guardian*, 1 mars 2016, <http://www.theguardian.com/world/2016/mar/01/refugees-isis-nato-commander-terrorists>.

rrugë të ndryshme për të ardhur në shtëpi. Disa përdorin pasaportat e tyre, disa përdorin dokumente të falsifikuara udhëtimi, disa vijnë me dokumente identiteti të vjedhura ndërsa disa udhëtojnë pa dokumente, duke u fshehur në rrjedhën e emigrantëve të parregullt dhe azilkërkuesve që lëvizën drejt Evropës që nga vjeshta e vitit 2015¹⁵⁹.

Numri i tyre është i vogël - deri tani jo më shumë se disa dhjetëra xhihadistë të dyshuar të cilët paraqiten si refugjatë të luftës siriane janë zbuluar midis qindra mijëra njerëzve që ikin nga Siria ose nga kampet e refugjatëve në Turqi dhe Liban. Megjithatë, prania e tyre midis refugjatëve të vërtetë ka ngritur alarmin në komunitetin e inteligjencës por edhe midis politikanëve të krahut të djathtë populist. Megjithatë, disa nga ata që fshihen në rrymën e refugjatëve nuk janë luftëtarë të huaj që kthehen, por xhihadistë të tjerë sirianë apo irakianë.

Disa prej tyre janë regjistruar dhe u janë marrë shenjat e gishtave në kufijtë e Greqisë ose Turqisë ose kanë bërë letrat e qëndrimit në qendrat e refugjatëve në Gjermani. Për shembull, Nabil Fadli, një bombardues vetëvrasës që vrau dhjetë turistë gjermanë në sheshin Sultan Ahmet të Stambollit, më 12 janar 2016, kishte hyrë në Turqi një javë më parë dhe ishte regjistruar si azilkërkues. Abdel Majid Touil, një nga autorët e dyshuar të masakrës së Muzeut Bardo në Tunizi kishte kaluar Mesdheun mes azilkërkuesve të zakonshëm nga Libia drejt Italisë, por ishte kapur (dhe më vonë liruar për shkak të mungesës së provës).¹⁶⁰ Një tunizian i quajtur Walid Salihi (ai ka edhe disa identitete të tjera) që sulmoi një stacion policor në Paris më 7 janar 2016 – në përvjetorin e sulmit të Charlie Hebdo - ishte regjistruar në qendrën e azilit në Recklinghausen në Gjermani. Ai mbante një rrip të rremë eksplozivi, por mbante një hanxhar të vërtetë dhe bërtiste “Allahu Akbar” kur sulmoi. Ai u qëllua para se të bënte ndonjë dëm. Dy nga terroristët që sulmuan Parisin më 13 nëntor 2015 kishin hyrë në Evropë të fshehur midis rrymës së refugjatëve me pasaporta të rreme siriane.¹⁶¹ Nuk e dimë ende se sa

¹⁵⁹ *Migrant smuggling in the EU*, (The Hague: Europol, 2016), fq. 12

¹⁶⁰ Sam Mullins, op. cit., fq.25.

¹⁶¹ *Aktivitäten islamistischer Akteure im Zusammenhang mit der Flüchtlingssituation. Handreichung*, (Berlin: Berling: Verfassungsschutz, 2015), fq.8, <https://www.berlin.de/sen/inneres/verfassungsschutz/publikationen/sonstige/hand>

xhihadistë të tillë shqetësues dhe të rrezikshëm janë midis refugjatëve. Zyra Federale Gjermane e Emigracionit duhej të pranonte në një kohë që identitetet e rreth 400,000 njerëzve në vend nuk ishin të njohura. 130,000 azilkërkues të cilët kishin hyrë në Gjermani u “zhdukën”, dhe disa prej tyre ndoshta u zhvendosën në vende të tjera.¹⁶²

Shteti Islamik përfiton dhe nga xhihadistët që rikthehen dhe azilkërkuesit e rregullt. Sipas Bernard Cazeneuve, Ministri francez i Brendshëm, ISIS ka formuar një “industri” të tërë në fabrikimin e pasaportave të vjedhura në Siri dhe Irak. Siç u tha më lart, dy nga terroristët përgjegjës për masakrat në Paris më 13 nëntor 2015 u raportua se kishin rihyrë në Evropë me pasaporta të rreme siriane. Nuk dihet se sa terroristë të ISIS janë dërguar në Evropë.

Një burim i përfshirë në kontrabandimin e njerëzve, pohoi se ISIS kishte dërguar “rreth 4.000 luftëtarë në Evropë” - një numër i paverifikuar dhe me gjasë shumë i ekzagjeruar.¹⁶³ Sipas ministrit holandez të emigracionit Klaas Dijkhoff, rreth tridhjetë të dyshuar për krime lufte - një e treta prej tyre siriane - janë gjetur në mesin e 59,000 njerëzve që kërkojnë azil politik në Holandë në vitin 2015.¹⁶⁴ Numra të ngjashëm të ulët janë gjetur në fluksin e mëparshëm të refugjatëve. Midis 25,000 ose më shumë azilkërkuesve algjerianë që arritën në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 1980, vetëm 44 prej tyre mendoheshin të ishin përfshirë në terrorizëm. Në rastin e refugjatëve somalezë në Shtetet e Bashkuara, vetëm 36 nga 85,000 u dyshuan për lidhje me terrorizmin.¹⁶⁵ Shifra të tilla prej 0.2 për qind ose më pak tregojnë se frika për “refugjatë terroristë” është kryesisht e pabazë.

reichung-aktivitaeten-islamistischer-akteure-im-zusammenhang-mit-der-fluechtlingsituation.pdf

¹⁶² “Gjermania raporton zhdukjen e 130,000 azilkërkuesve”. *BBC*, 26 shkurt 2016.

¹⁶³ J. Dettmer, “Jihadists Caught Posing as Refugees Fuel Alarm”, *Voice of America*, 2 shkurt 2016, <http://www.voanews.com/content/jihadists-caught-posing-as-refugees-fuel-alarm/3173533.html>.

¹⁶⁴ “Holandezët gjejnë 10 të dyshuar Sirianë për krime lufte midis mijëra emigrantëve”, *Reuters*, 29 shkurt 2016, <http://www.reuters.com/article/us-europe-migrants-netherlands-idUSKCN0W211Y>.

¹⁶⁵ Sam Mullins, op. cit., fq. 26.

Emigrantët Ekonomikë të kthyer në Luftëtarë të huaj Terroristë

Ka edhe një mënyrë tjetër nëpërmjet të cilës emigrantët mund të bëhen luftëtarë (terroristë): Provinca e Shtetit Islamik në Libi ka plot armiq dhe vetëm pak fuqi njerëzore – midis 4.500 dhe 6.000 njerëz, ku vetëm 800 prej tyre nuk janë libanezë. Në mënyrë që të rrisë rradhët e tyre, ISIS-i në Libi ka nisur të rrëmbejë emigrantë ekonomikë të vendeve si Sudani, Eritrea dhe Afrika Perëndimore që shkojnë nga Saharaja drejt Evropës. Një hidraulik nigerian i cili ishte rrëmbyer bashkë me një grup emigrantësh sudanezë dhe ganezë në Benghazi u dërgua nga luftëtarët e ISIS në një kamp shkretëtire ku u detyruan të recitojnë përmendësh pjesë nga Kur'ani. Ata që nuk mundeshin konsideroheshin si të krishterë dhe u pritej koka para syve të myslimanëve të rrëmbyer. Si pasojë, ky burri nigerian dhe myslimanë të tjerë u dërguan në kampe trajnimit dhe pas disa javësh instruksionesh ushtarake ai konsiderohej gati për të luftuar. Ky dëshmitar nigerian arriti të arratisesh dhe të tregonte historinë e tij, por jeton në frikë të vazhdueshme se mund të rrethohet prapë nga Shteti Islamik:

Shumë herë kam shkuar në xhamitë e Libisë për t'ju lutur Allahut që të ma bëjë vdekjen e shpejtë dhe të lehtë. Tani, mendoj që të largohem prej këtu dhe të mundohem t'i tregoj të gjitha ato që pashë në shkretëtirë atë ditë – se si këta njerëz arrijnë të presin kokat e njerëzve të tjerë si të ishin duke prerë perime, si të mos ishte asgjë'... Kur të kem mjaftueshëm të ardhura, do të nisem me varkë drejt Italisë. Tashmë kam mbijetuar mjaftueshëm, ndoshta do mbijetoj edhe kur të kaloj detin.¹⁶⁶

Pasojat e Radikalizimit të Emigrantëve në Terrorizëm

Por është edhe një mënyrë tjetër që emigrantët mund të bëhen terroristë. Nëse nuk janë të integruar plotësisht në shoqëritë pritëse, brenda tyre mund të zhvillohet një ndjenjë pakënaqësie dhe për disa ky lloj zemërimi mund të bëhet aq i fortë sa ata - ose më shumë gjasa, fëmijët e tyre - të

¹⁶⁶ T. Westcott, "IS kidnapping migrants at gunpoint to fight in Libya", *Middle East Eye*, 7 mars 2016, <http://www.middleeasteye.net/news/forging-migrant-army-libya-912479375>.

kthehen kundër shoqërisë pritëse. Kjo ka qenë një nga arsyet pse ai numër aq i madh i luftëtarëve të huaj nga Evropa ishin fëmijët e emigrantëve.

Megjithatë, gjasat afatshkurtra që refugjatët e ardhur kohët e fundit në Evropën Perëndimore të radikalizohen, janë shumë të ulëta. Megjithatë, ekziston rreziku që disa emigrantë të parregullt që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në Bashkimin Evropian mund të rekrutohen nga rrjete kriminale ose terroriste (ose hibride). Zemërimi i tyre personal ndaj një shoqërie që nuk është e gatshme t'i pranojë ata, mund të motivojë disa prej tyre që të angazhohen në aktet e dhunës politike.

Megjithatë shumica dërrmuese e emigrantëve nuk kanë aspak lidhje me terrorizmin. Ka shifra për ta ilustruar këtë. Midis vjeshtës së vitit 2001 dhe fillimit të vitit 2016, Shtetet e Bashkuara pranuan më shumë se 800,000 refugjatë në programin e strehimit. Vetëm pesë persona të cilët u kontrolluan në kuadrin e programit të strehimit janë arrestuar në bazë të akuzave për terrorizëm, sipas Departamentit të Shtetit dhe Institutit të Politikave të Migracionit “.¹⁶⁷ Lidhur me situatën në Evropë, Peter Neumann, Drejtor i ICSR në Londër, ka vërejtur se nga 600,000 irakianë dhe sirianë që mbërritën në Gjermani në vitin 2015 “vetëm 17 janë hetuar për lidhje terroriste”.¹⁶⁸

Për ta përmbledhur: terroristët ndërkombëtarë janë shpesh emigrantë dhe emigrantët (ose fëmijët e tyre) në kampet e refugjatëve dhe në diasporë, ndonjëherë, por shumë rrallë, mund të bëhen terroristë (ose refugjatë luftëtarë) nëse qeveritë dështojnë t'u japin atyre perspektiva më të mira.

Operacionet Kundër-Terroriste si Shkaktarë të Emigrimit të Detyruar?

¹⁶⁷ A. Yuhas, “NATO commander: Isis ‘spreading like cancer’ among refugees”, *The Guardian*, 1 mars 2016, <http://www.theguardian.com/world/2016/mar/01/refugees-isis-nato-commander-terrorists>.

¹⁶⁸ P.R. Neumann, “*The refugees are not the problem*”, *The Security Times*, shkurt 2016, fq. 35, http://times-media.de/download/ST_Feb2016_double_page.pdf.

Terrorizmi është shpesh një strategji provokimi. Ata që angazhohen në të, kërkojnë të provokojnë një mbi-reagim. Sa më pak inteligjencë ka një qeveri për vendndodhjen dhe identitetin e autorëve të veprave të terrorizmit, aq më shumë gjasa ka që forcat e zbatimit të ligjit dhe të sigurisë të përdorin një qasje të ashpër e cila targeton gjithë sektorin e shoqërisë me të cilin janë të lidhur terroristët.

Kjo është shpesh pjesë e llogarive terroristë: shtypja, argumentojnë ata, do të hapë sytë e njerëzve dhe pastaj njerëzit do të shohin se qeveria është “e keqe”, dhe kjo duhet të bëjë që më shumë njerëz t’u bashkohen terroristëve, duke u dhënë atyre mbështetje dhe rekrutë të rinj. Është një llogaritje cinike të provokosh shtypje kundër sektorit kyç që terroristët pretendojnë të mbrojnë - por kjo është mungesë morali dhe strategji dinake e shumë terroristëve kryengritës.¹⁶⁹

Reagimet e provokuara nga shteti kanë kushtuar dhjetëra mijëra jetë dhe kanë shkaktuar qindra mijëra refugjatë. Pas 11 shtatorit 2001, sulmet amerikane ndaj Afganistanit jo vetëm çuan në një eksod të 300 ose më shumë anëtarëve të al-Kaedës në Pakistan, por gjithashtu zhvendosën mijëra të tjerë.

Në territoret fisnore të Waziristanit të Veriut, talebanët, al-Kaeda dhe xhihadistë të tjerë gjetën një strehë të sigurt. Pakistani u përpoq t’i përdorte disa prej tyre për objektivat e politikës së jashtme në Afganistan dhe Kashmir, por në fund u bë vetë shënjestër i tyre. Pas tërheqjes amerikane nga Afganistani dhe pas një numri sulmesh të drejtpërdrejta nga talebanët pakistanezë, ushtria vendosi të vepronte me vendosmëri.

Në vitin 2014, ushtria pakistaneze filloi të kryejë sulme të mëdha kundër vendstrehimeve të talebanëve pakistanezë dhe elementëve të al-Kaedës në Waziristan. Në këtë proces, më shumë se një milion civilë u zhvendosën nga shtëpitë e tyre.¹⁷⁰ Gjëja më e trishtuar për këtë

¹⁶⁹ Për shembull, strategu kryesor i fraksionit të Ushtrisë së Kuqe gjermane, Horst Mahler më vonë pranoi: "Strategjia e bërthamave terroriste synonte të shkaktonte reagim të tepruar të shtetit me shpresën për të ndezur flakët e urrejtjes ndaj shtetit dhe për të kanalizuar rekrutë të rinj të armatosur ". A. P. Schmid, "Terrorizmi Politik. Një Udhëzues Kërkimor për Konceptet, Teoritë, Bazat e të Dhënave dhe Letërsinë ", (Amsterdam: North Holland publ. Company, 1984), fq. 185.

¹⁷⁰ C. Gall, "Pakistan's Hand in the Rise of International Jihad", *New York Times*, 6 shkurt 2016.

zhvendosje të shkaktuar nga operacionet kundër terrorizmit ishte se dikush në organin e sigurisë pakistaneze, që kishte simpati ndaj objektivave të xhihadistëve, kishte informuar paraprakisht udhëheqjen terroriste, kështu që operacioni humbi shumë nga objektivat e tij në shkallë të gjerë, pasi shumë nga militantët e informuar kishin lëvizur tashmë përtej kufirit në Afganistan për të pritur që stuhia e sulmeve të mbaronte.¹⁷¹ Siç ndodh shpesh njerëzit e zakonshëm paguajnë çmimin më të madh.

Në Siri, qeveria e Asadit është përpjekur të justifikojë shtypjen e përgjithshme të sunive nën etiketën e kundërshtimit të terrorizmit, një etiketë që përdoret jo vetëm kundër Shtetit Islamik dhe al-Nusra (grupi i al-Kaedës në Siri), por edhe kundër luftëtarëve të tjerë të moderuar që i rezistojnë regjimit pothuajse gjenocidal.

Qeveria siriane është ndihmuar shumë nga Irani dhe që prej fundit të shtatorit 2015 e tutje edhe nga forcat ajrore ruse, të cilat ndryshe nga ato amerikane përdorin rëndom bomba inteligjente. Si rezultat, numri i viktimave civile të fushatës ruse kundër terrorizmit në Siri janë shumë të larta. Kur në shkurt të vitit 2016, forca ajrore ruse shtoi bombardimet e saj në Aleppo për të mundësuar avancimin e trupave siriane, të paktën 15,000 sirianë ikën nga luftimet në Aleppon e veriut, ku shumë prej tyre u mblodhën në kalimin kufitar të Bab al-Salamit në Turqi ku ata nuk u lejuan të vazhdonin.¹⁷²

Ndërhyrja ruse nga ajri dhe angazhimi më i fortë i Iranit në terren në Siri, e kthyen rrjedhën e ngjarjeve, pasi regjimi i Asadit deri në shtator 2015 kishte humbur më shumë se 80 për qind të territorit të Sirisë. Ky intensifikim i ri i shtypjes bindi qindra mijëra refugjatë sirianë në kampet në Liban dhe Turqi, që ata kishin shpresuar më kot për një fitore të kryengritjes popullore dhe se një kthim në Sirinë e shkatërruar dhe të sunduar nga Assad nuk shihej më si alternativë. Në atë kohë, më shumë se tetëdhjetë për qind e refugjatëve sirianë në kampet e Jordanisë dhe Libanit jetonin poshtë nivelit minimal të varfërisë. Kur donatorët perëndimorë ulën kontributet e tyre në UNCHR në vitin 2015, situata e

¹⁷¹ Ibid.

¹⁷² "Syria war: Refugees mass at Turkey-Syria border." *BBC World Service*, 5 shkurt 2016, <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-35503343>.

këtyre refugjatëve u bë e pashpresë. Kombinimi i këtyre faktorëve: pas ndërhyrjes ruse, i rrëzuan shpresat se Assad-i do të rrëzohet dhe lufta do të përfundonte së shpejti, varfëria në rritje në kampet e refugjatëve si rezultat i zvogëlimit të mëtejshëm të ndihmës për UNHCR-në, bëri që qindra mijëra prej tyre të vendosnin të rrezikonin me udhëtimin e rrezikshëm drejt Evropës pasi kancelarja gjermane Angela Merkel tregoi më 5 shtator 2015 se Gjermania do t'i mirëpriste.

Fatkeqësisht, efektet e mbi-reagimit të shteteve ndaj terrorizmit kryengritës shpesh herë janë më të këqija se dëmet e bëra nga terroristët kryengritës. Mbi-reagimi i Shteteve të Bashkuara me ndërhyrjen e tyre në Irak në vitin 2003 (ku Saddam Hussein akuzohej gabimisht për mbështetjen e Al-Kaedës dhe për zotërimin e armëve të shkatërrimit në masë) vetëm, drejtpërdrejt dhe indirekt, çoi në vdekjen e 137.000 deri në 165.000 civilëve dhe zhvendosjen e brendshme të 1,300,000 njerëzve, ndërsa më shumë se 1,400,000 u kthyen në refugjatë.¹⁷³

Ndërhyrja amerikane në Afganistan dhe sulmet në kufirin me Pakistanin pas sulmit të 11 shtatorit u kushtuan jetën përkatësisht 26,000 dhe 21,500 civilëve, duke mos llogaritur ata që ishin të armatosur dhe të përfshirë drejtpërdrejt në luftime.¹⁷⁴ Popullsia afgane e refugjatëve në Pakistan përbëhet nga 1,500,000 refugjatë të dokumentuar dhe rreth një milion të tjerë pa dokumente, kjo e fundit pjesërisht si pasojë e ndërhyrjes sovjetike në Afganistan në vitin 1978.¹⁷⁵

Kontrolli i Emigrantëve për Luftën ndaj Terrorizmit?

Bashkimi Evropian me 28 shtetet anëtare të saj numëron rreth 510 milionë njerëz, ndërsa zona Shengen përbëhet nga njëzet e gjashtë vende

¹⁷³ J. Tirman, "Iraq: the Human Cost", (Cambridge: Mass. MIT Center for International Studies), <http://web.mit.edu/humancostiraq/>.

¹⁷⁴ *Human Costs of War: Direct War Death in Afghanistan, Iraq, and Pakistan tetor 2001 - prill 2015*, <http://watson.brown.edu/costsofwar/files/cow/imce/figures/2015/SUMMARY%20CHART%20-%20Direct%20War%20Death%20Toll%20to%20April%202015.pdf>.

¹⁷⁵ *Pakistan: Extend Afghan Refugee Status Through 2017* (New York: Human Rights Watch), 2016, <https://www.hrw.org/news/2016/01/16/pakistan-extend-afghan-refugee-status-through-2017>.

me një popullsi të kombinuar prej më shumë se 420 milionë njerëz.¹⁷⁶ Marrëveshja e Shengenit e vitit 1995 i lejon evropianëve të lëvizin lirishëm në një hapësirë politike prej 4,312,099 kilometra katrorë, me një kufi të përbashkët të jashtëm të përbërë nga 42,672 kilometra kufij tokësor dhe 8,826 kilometra bregdet.¹⁷⁷ Sidoqoftë, Frontex, e cila është organizata për kontrollin kufitar evropian, deri vonë kishte vetëm 310 vetë personel dhe një buxhet vjetor prej 114 milion euro.¹⁷⁸

Kontrolli kufitar është ende kryesisht një e drejtë ekskluzive e qeverive kombëtare. Megjithatë, ashtu si një zinxhir ai është aq i fortë sa lidhja e tij më e dobët, kufijtë e Shengenit janë po aq të forta sa ato të anëtarëve të saj mesdhetarë, në veçanti, Italisë dhe Greqisë. Fillimisht të konceptuar për kontrollin e emigracionit të paligjshëm, kontrollet kufitare që nga 9 shtatori janë përdorur gjithnjë e më shumë për të luftuar terrorizmin, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara.

Mbajtja e terroristëve është një objektiv legjitim, por efektiviteti i kontrollit kufitar është i kufizuar nga fakti se shumë terroristë janë “shtëpiakë” ose janë të huaj me leje qëndrimi të ligjshme. Ndonjëherë terrorizmi importohet jo nga të huajt, por nga qytetarët të cilët u (më tej) radikalizohen jashtë vendit. Kjo vendos një kufizim në atë që kontrolli i migracionit mund të bëjë për të ndaluar terrorizmin. Megjithatë, kontrolli i migracionit është përdorur gjithnjë e më shumë si një instrument i rëndësishëm për kontrollin e terrorizmit.

¹⁷⁶ Vendet në Shengen countries përfshijnë 22 anëtarë të BE dhe 4 shtete që nuk janë në BE (Islanda, Norvegjia, Zvicra dhe Lihteshtejni). Gjashtë vendet anëtare të BE jashtë zonës Shengen janë Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Irlanda, Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar. Aktualisht gjashtë shtete kanë futur kontrollet kufitare: Austria, Danimarka, Franca, Gjermania, Norvegjia dhe Suedia. “Schengen: controversial EU free movement deal explained”. *BBC News*, 7 mars 2016, <http://www.bbc.com/news/world-europe-131947233>.

¹⁷⁷ M. Carr, *Fortress Europe. Inside the War Against Migration*, (Londër: Hurst & Co., 2012), fq.28, 30.

¹⁷⁸ W. Von Bernd, “Die Europäische Grenzschutzagentur Frontex – Wallmeister der Festung Europas oder Garant für die Sicherheit der Außengrenzen?” *Die Kriminal Polizei* June 2015 <http://www.kriminalpolizei.de/ausgaben/2015/juni/detailansicht-juni/artikel/die-europaeische-grenzschutzagentur-frontex-wallmeister-der-festung-europas-oder-garant-fuer-die.html...>

Nga ana tjetër, legjislacioni anti-terrorist mund të ndikojë negativisht në migracionin dhe të jetë veçanërisht e dëmshme për refugjatët që kërkojnë azil. Duke shkruar në vitin 2014, Nazli Avdan përfundoi, duke shikuar të dhënat e zonës së Shengenit nga viti 1980 deri në vitin 2007, se “parimet humanitare që mbështesin njohjen e azilit nuk janë dëmtuar nga terrorizmi”.¹⁷⁹ Sot, jo më vonë, politikat e migracionit janë të sekuritizuara në Evropë po ashtu, pasi ata ishin në Shtetet e Bashkuara pas vitit 2001.

Mbajtja e terroristëve jashtë është një objektiv legjitim, por efektiviteti i kontrollit të kufirit është i kufizuar nga fakti se shumë terroristë janë “nënshetas” ose janë të huaj me qëndrim të ligjshëm. Ndonjëherë terrorizmi është importuar jo nga të huajt, por nga qytetarët që radikalizohen jashtë vendit. Ky fakt vendos kufizime në atë që kontrolli i emigracionit mund të bëjë për të ndaluar terrorizmin. Megjithatë, kontrolli i emigracionit është përdorur gjithnjë e më shumë si një instrument i rëndësishëm për kontrollin e terrorizmit. Nga ana tjetër, legjislacioni kundër terrorizmit mund të ndikojë negativisht në migracionin dhe të jetë veçanërisht i dëmshëm për refugjatët që kërkojnë azil.

Në shkrimet e vitit 2014, Nazli Avdan, duke shikuar të dhënat e zonës së Shengenit nga viti 1980 deri në vitin 2007, konkludoi se “parimet humanitare që mbështesin njohjen e azilit nuk janë gërryer nga terrorizmi”.¹⁷⁹ Sot, vite më vonë, politikat e emigrimit janë forcuar në kontekstin e sigurisë edhe në Evropë, siç u bë edhe në Shtetet e Bashkuara pas vitit 2001.

H. Cinoglu dhe N. Atun ngritën pyetjen “pse pavarësisht faktit se nuk ka lidhje organike midis emigracionit ndërkombëtar dhe terrorizmit “, Shtetet e Bashkuara dhe vendet e BE-së po përqendrohen në politikat e emigracionit dhe kontrollit kufitar në luftën kundër terrorizmit?¹⁸⁰ Ata vunë në dukje disa prej disavantazheve:

¹⁷⁹ N. Avdan, “Do asylum recognition rates in Europe respond to transnational terrorism? The migration-security nexus revisited”, *European Union Politics*, Vëll. 15, Nr. 4, dhjetor 2014, fq. 445, <http://eup.sagepub.com/content/15/4/445>.

¹⁸⁰ Ibid. fq. 111.

Krijimi i një lidhjeje artificiale midis emigrantëve dhe terrorizmit krijon ankth dhe zemërim midis shoqërive emigrante dhe rrit ndjenjat armiqësore kundër shtetit. Në situata të tilla, armiqësia kundrejt të huajve (ksenofobia) rritet krahas mundësisë të përplasjes të dy grupeve shoqërore. Krijimi i një ekuilibri midis të drejtave të njeriut dhe sigurisë nuk është një detyrë e lehtë për këto vende të cilat kërkojnë më shumë siguri. Emigrantët zakonisht kanë një pozitë të pafavorshme në shtetet e tyre dhe grupet terroriste mund të abuzojnë me situatën ose politikat kufitare të vendeve.(...) Politikat dhe praktikat strikte të miratuara nën kuadrin e luftimit të terrorizmit ndërkombëtar mund të shkaktojnë një ulje drastike të kontributeve pozitive të emigrimit për vendet pritëse.(...) Shënjestrimi specifik i grupeve të veçanta të emigrantëve dhe të huajve për hir të parandalimit të terrorizmit nuk mund të pajtohet as me teoritë e demokracisë liberale që Perëndimi mbron prej vitesh dhe as me qasjet e predikuara për luftimin e terrorizmit brenda limiteve të respektimit të të drejtave të njeriut.¹⁸¹

Një rrezik shtesë i përdorimit të kontrollit të emigrantëve për të luftuar terrorizmin është se kuadri i zgjeruar të cilin qeveritë përdorin në procesin e kontrollimit të lëvizjeve të emigrantëve do të zgjerohet edhe me kontrollin e qytetarëve të tyre. David Cole, në librin e tij *Enemy Aliens*, ka argumentuar “....është në interesin tonë që të mos tregtojmë të drejtat e emigrantëve me sigurinë e supozuar të qytetarëve pasi të drejtat që ne i mohojmë emigrantëve do t’u mohohen në mënyrë të pashmangshme qytetarëve më vonë dhe sepse standardet e dyfishta minojnë sigurinë duke dobësuar legjitimitetin e luftës ndaj terrorizmit.”¹⁸²

Duke u shtrirë në kufijtë e saj, kontrollet e migracionit dhe kufirit do t’i mbyllin shoqëritë e hapura kozmopolite dhe njerëzit e zakonshëm do të paguajnë një çmim të lartë për krimet e disave. Ka mënyra të tjera me më pak efekte negative për të luftuar terrorizmin. Sulmimi i ideologjisë së terroristëve dhe infrastrukturës së tyre organizative është një rrugë më premtuese sesa kontrolli i të gjithë individëve në lëvizjet e tyre me shpresën për të kapur disa terroristë mes tyre.

¹⁸¹ Ibid. fq.103 and 112.

¹⁸² David Cole. *Enemy Aliens. Double Standards and Constitutional Freedoms in the War on Terrorism*. New York: The New Press, 2003, fq.226.

Përfundime

Që nga vjeshta e vitit 2015, opinioni publik evropian është përzier nga fotot grafike të viktimave të terrorizmit në Paris dhe Bruksel nga njëra anë dhe nga pamjet video të shtigjeve të gjata të emigrantëve që kalojnë nga Ballkan drejt Austrisë, Gjermanisë, Suedisë, si dhe vendeve të tjera evropiane nga ana tjetër. Dy çështje - terrorizmi dhe emigrimi - janë bashkuar në diskursin publik, në mënyrë që të krijohet përshtypja se popullatat terroriste dhe emigrantët përputhen në mënyrë të konsiderueshme dhe që kemi të bëjmë me një problem të vetëm. Për shembull, në vjeshtën e vitit 2015 kur dhjetë mijë njerëz në ditë arritën në Evropën Qendrore nëpërmjet rrugës ballkanike, si Presidenti çek Milos Zeman dhe kryeministri sllovak Robert Fico kishin sugjeruar që terroristët mund të përdorin rrymat e refugjatëve përmes Ballkanit për t'u infiltruar dhe për të ngritur “celulat e heshtura” në vendet pritëse.¹⁸³ Megjithatë, ato shumë pak raste të terroristëve që paraqiten si refugjatë duhet të shihen për atë që ato janë vërtet - përjashtime.

Peter Newmann, drejtuesi i ICSR në Londër kishte të drejtë kur theksoi se

